



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
20 NËNTOR 2008. GODINE

NËNTOR – NOVEMBAR
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ngrohjen qendrore, nr. 03/L-049,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për procedurën jokontesimore, nr.03/L-007,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për avokatinë, nr. 02/L- 040,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin bujqësorë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm,
11. Shqyrtimi i Raportit lidhur më gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007, dhe
12. Njoftimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne plenarne sednice,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti od nejonizujućeg i jonizujućeg zračenja i nuklearnoj bezbednosti,
4. Razmatranje Prepuruke o izmenama Zakona o centralnom grejanju, br. 03/L-049,
5. Razmatranje Preporuke o izmenama Zakona o vanparničnom postupku br.03/L-007,
6. Razmatranje preporuke o izmenama Zakona o advokaturi br.. 02/L- 040,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o poljoprivrednoj inspekciji,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o akreditaciji,
9. Razmatranje Preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi sa predlogom Vlade o imenovanju članova Odbora Penzionog trusta Kosova,
10. Razmatranje Izveštaja Komisije za budžet i finansije o nadzoru nad sprovođenjem Zakona br. 02/L-74 o unutrašnjoj reviziji,
11. Razmatranje Izveštaja o stanju životne sredine za period od 2006-2007.godine, i
12. Izveštavanje Parlamentarne grupe PDK o promeni članova parlamentarne komisije.

A g e n d a:

1. Approval of the minutes from previous session,
2. Time for Parliamentary questions,
3. First reading of the Draft Law on Protection form Non Ionized, Ionized Radiation and Nuclear Security,
4. Review of recommendation for amendment of the Law on Central Heating, nr. 03/L-049,
5. Review of recommendation for amendment of the Law on Non-Contested Procedure,

- nr.03/L-007,
6. Review of recommendation for amendment of the Law on Bar, nr. 02/L-040,
 7. Second reading of the Draft Law on Agriculture Inspection,
 8. Second reading of the Draft Law on amendment and supplementation of the Law on Accreditation,
 9. Review of recommendation of the Committee on Budget and Finance regarding the Government's proposal for appointing members of the Kosovo Pension Trust Board,
 10. Review of the report of the Committee on Budget and Finance for supervision of the implementation of the Law no. 02/L-74 on Internal Audit,
 11. Review of the report regarding the environmental conditions for period of years 2006-2007, and
 12. Notification made by Parliamentary Group of PDK for substitution of members in Parliamentary Committee's.
-

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra, mirëmëngjesi!

Hap punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë 81 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- **Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 6, 7 dhe 10 nëntor 2008.**

Ju njoftoj se procesverbalet dhe transkriptet e këtyre seancave u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në këto procesverbale?

Pasi që nuk kemi të lajmëruar asnjë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 6, 7 dhe 10 nëntor 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- **Koha për pyetje parlamentare**

Para se t'ia fillojmë me procedimin e kësaj pike, ju njoftoj se për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara dhe me qëllim të ruajtjes së aktualitetit të tyre, në seancën e kaluar Kuvendi vendosi të bëjë shmangie nga Rregulla 26 pika 1, duke zgjatur

kohën për pyetje parlamentare nga 50 në 60 minuta, si dhe duke proceduar me nga një pyetje të deputetit që ka shtruar më shumë pyetje.

Pyetjen e parë e fillojmë me deputetin Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin Lutfi Zharkun dhe ministrin Nenad Rashiq. Do të ishte mirë, që deputeti të përcaktohet për njërin.

A është këtu Arsimi? Nuk është.

Atëherë, pyetja e radhës është e deputetit Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

Deputeti Tali, e ka fjalën!

Meqë nuk është i përgatitur deputeti Tali, procedojmë me pyetjen e deputetit Riza Smaka për ministrin Zenun Pajaziti.

Ministri nuk është këtu. Deputet, Riza Smaka, urdhëro, lexoje pyetjen!

RIZA SMAKA: Faleminderit!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar qeveritarë dhe deputetë,

Pyetja i referohet inkasimit të taksës plotësuese për sigurimin e mjeteve motorike. Është fjala për qytetarët tanë të cilët punojnë përkohësisht në botën e jashtme, që automjetet e veta i kanë të siguruara, natyrisht, dhe kur hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës obligohen të paguajnë prapë. Kjo është destimulative, irrituese, e panevojshme dhe nuk përkon me asnjë politikë, prandaj pyetja është kjo. Mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet me normë juridike dhe të evitohet ky deformim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, në radhë kemi pyetjen e deputetes Suzan Novobrdaliu për ministrin Zenun Pajaziti, që nuk është prezent.

Vazhdojmë me pyetjen e deputetes Myrvete Pantina për ministrin Idriz Vehapi. Deputete, e keni fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për shkak të kostos së lartë të prodhimit, që nënkupton çmimet e larta të plehrave, farës së grurit dhe karburanteve, këtë vit sikur edhe viteve tjera, interesimi i fermerëve për prodhimin e grurit është shumë i vogël. Me çmimet aktuale të këtyre faktorëve të prodhimit, fermeri ose duhet të prodhojë grurë, por me humbje ose nuk do të prodhojë fare.

Zoti ministër, meqë gruri është një produkt strategjik, i cili ka konsumim të gjerë tek ne, çka do të ndërmarrë Ministria juaj për ta stimuluar prodhimin e grurit?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuari zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Pantina, faleminderit për pyetjen!

Këtë vit, ju e dini, buxheti ka qenë i planifikuar për vitin 2008 dhe për ta stimuluar mbjelljen e grurit – mbjelljen vjeshtore, duhet pasur parasysh se në Kosovë mbillen rreth 70 mijë hektarë për çdo vit, që është mesatarja, dhe për të subvencionuar mbjelljen duhen miliona euro. Ne nuk kemi pasur mundësi t'i sigurojmë ato mjete me buxhet të planifikuar dhe të fillojmë me shpenzimin e tij, ndërsaq jemi duke u përpjekur që viteve tjera, në të ardhmen, të gjejmë forma dhe mënyra të bëhet subvencionimi i bujqësisë, sepse, dihet edhe gruri edhe prodhimet tjera, të gjitha janë strategjike dhe ne vetëm me pak prodhime i plotësojmë nevojat vendore. Pra, për të dalë nga kjo situatë, duhet patjetër të bëhet subvencionimi i bujqësisë.

Kjo përgjigje, do të vlente edhe për deputetin Arsim Rexhepi që për afërsisht ka parashtruar të njëjtën pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a keni pyetje shtesë? Urdhëroni, Myrvete!

MYRVETE PANTINA: Zoti ministër, në fillim të vitit, kur kemi filluar, domethënë, angazhimin tonë në Kuvend, unë kam pasur një pyetje rreth subvencionimit, në të vërtetë, përkrahjes së bujqësisë dhe atëherë keni thënë se keni projekte, por ka qenë vonë, meqenëse buxheti është hartuar apo planifikuar më herët. Prandaj, po më çudit fakti, sepse për këtë duhet pritur deri në vitin e ardhshëm, edhe pse, do të thotë prej vitit të kaluar keni pasur projekte.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Idriz Vehapi.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Projektet janë, por mjetet nuk kemi mund t'i sigurojmë, sepse edhe rekomandimet janë nga Fondi Monetar që subvencionim direkt momentalisht nuk lejohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Tali, a jeni gati? Mund ta bëni pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kjo pyetje, ndonëse është bërë shumë herët, ka të bëjë me Ndërmarrjen “Ballkani” – Fabrikën e Gomës, e cila është privatizuar në vitin 2004 me spinof special, me kusht që blerësi apo pronari i tij t'i investojë 6 milionë euro brenda dy vjetëve, domethënë deri në vitin 2006, dhe t'i punësojë 375 punëtorë. Asnjërin nga këto kushte nuk i ka përmbushur, ndërsa AKM-ja i kishte dhënë afat edhe një vit. Sipas zyrtarëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Bordi i AKM-së është përgjegjës për zgjatjen e afateve dhe nivelin e përmbushjes së kontratës së “Ballkanit” të Suharekës.

Pyetja ka qenë: Çfarë mund të presin së shpejti punëtorët e “Ballkanit” nga Qeveria”, në origjinal ka qenë “para se ta humbin durimin dhe të hyjnë në protesta e greva” që ajo veç ka ndodhur, por tash Qeveria, mendoj duhet të dalë me një qëndrim ndaj atyre punëtorëve, atje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Edhe pse, pyetja nuk më takon vetëm mua, megjithatë po përgjigjem.

Agjencioni Kosovar i Privatizimit, konsideroj i ka kompetencat e plota dhe Qeveria e Kosovës ka autorizuar anëtarët e Bordit për të vepruar konform procedurave dhe ligjeve. Secilit investitor, i cili nuk i ka plotësuar kushtet me spinofin special, Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka kompetenca për t'ia marrë prapa aksionet, përkatësisht për të

vepruar konform marrëveshjes dhe ligjit në fuqi. Pra, në qoftë se nuk i kanë përmbushur kushtet, qoftë për punësim, qoftë për investime, e sidomos në investime, Agjencioni Kosovar i Privatizimit e ka të drejtën, quhet collection, t'i marrë prapa aksionet, dhe ose ta privatizojë ndërmarrjen ose të bëjë ndonjë formë tjetër të hapjes së mundësive për investime të sektorit privat.

Besoj që kryetari i Bordit, konform procedurave dhe në bashkëpunim me Qeverinë, do t'i marrë të gjitha masat, në mënyrë që të ketë mundësi që punëtorët të kenë të drejtën e vetë konform ligjit dhe investimet të vazhdojnë në këtë fabrikë dhe në fabrikat tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, a ke pyetje shtesë? Urdhëroni! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Siç po shihet, zoti ministër nuk ka qëndrim, po edhe Qeveria nuk paska qëndrim. Dua t'ia rikujtoj zotit ministër se qytetarët e Kosovës kanë votuar për këtë qeveri dhe Agjencioni Kosovar për Privatizim është zgjedhur nga kjo qeveri, andaj për t'i ruajtur interesat e qytetarëve të vet, Qeveria duhet të reagojë dhe të ketë një plan, pa marrë parasysh autonominë e institucionit, të cilin edhe unë e çmoj. Mirëpo, këtu kemi thjeshtë shkelje të ligjit, për çka Qeveria duhet të reagojë, nëse jo për tjetër, atëherë ta dinë se i kanë një 300- 400 votues të vet për zgjedhjet e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, a keni përgjigje? Mirë, faleminderit!

Deputeti, Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin e Ambientit, zotin Mahir Yagcillar. Deputet, mund ta bëni pyetjen!

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje të gjithëve!

Pyetja ime ka të bëjë rreth shqetësimit lidhur me çështjet e ambientit. Në përmishte, në dalje të Ferizajt, në drejtim të Shtimes, është një përmishte, pronë e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që më herët ka qenë nën AKM. Aty ende qëndrojnë materiale të rrezikshme për ambientin. Është fjala për pesticide me afat të skaduar, të cilat vazhdojnë të bëjnë dëme, ndërsa nëse me qëllim ose rastësisht do të digjeshin, atëherë pasojat do të ishin shumë të rënda.

E njëjta pyetje është bërë më 11 prill 2008, por nuk është ndërmarrë asgjë. Po më intereson, çka do të bëhet më tutje që të hiqet ky material i rrezikshëm, sepse ka ...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! E shpenzove kohën. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë, ministra,

I nderuari zoti deputet Xhemajli,

Lidhur me mbetjet e rrezikshme për të cilat ishte bërë pyetja, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, së bashku me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka bërë identifikimin e materieve dhe mbeturinave të rrezikshme, të cilat janë të vendosura në një depo, pronë e Ndërmarrjes Bujqësore "Plantacioni i Pemëve" në Ferizaj.

Mbeturinat janë preparate kimike, që kanë mbetur kaheër, të cilat janë përdorur për trajtimin e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm.

Lidhur me lejimin ose ndalimin për mbajtjen e evidencës, lëshimit në qarkullim, regjistrimin dhe përcaktimin e autoritetit me detyra të veçanta për administrimin e pesticideve në Republikën e Kosovës, sipas neneve 2, 11, 14.8 dhe 15 të Ligjit për pesticidet kompetente ishte Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në bazë të informacioneve të marra nga Kuvendi Komunal, gjithashtu, edhe nga Ministria e Bujqësisë, materiet e tilla gjenden ende në depon e Ndërmarrjes Bujqësore” Plantacioni i Pemëve” në Ferizaj.

Ndërmarrja Bujqësore”Pemishtja” thashë ishte nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sepse e njëjta ende nuk e ka përfunduar në tërësi procesin e privatizimit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për momentin, nuk posedon vend- depo të përshtatshme për ruajtjen e këtyre materieve.

Me qëllim të reduktimit apo eliminimit të rrezikut nga materiet e rrezikshme, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas Planit të Kosovës për veprim në mjedis, ka propozuar projektin e ndërtimit të një objekti për ruajtjen e përkohshme të materieve dhe mbeturinave të rrezikshme. Për këtë projekt nga buxheti i konsoliduar i Kosovës janë lejuar mjete financiare prej 760 mijë eurove, të cilat do të shfrytëzohen në periudhën kohore për tri vjet. Projekti është në fazën e hulumtimit dhe të përcaktimit të lokacionit të përshtatshëm. Për këtë objekt, propozimi dhe përzgjidhja e lokacionit është në proces, kështu që besojmë se me ndërtimin e deponisë për materie të rrezikshme do të zgjidhet edhe për problemin me këso lloj pesticidesh.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, a keni pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Alush Gashi.

RIZA SMAKA: Respekt, Kryetar!

Qeveritarë dhe deputetë,

Pyetja kuvendore i referohet establishtit të Spitalit të Prishtinës. Në shtete, përkatësisht qytete me zhvillim normal, zakonisht shërbimet shëndetësore sekondare ushtrohen në spitale të përgjithshme, përkatësisht të specializuara, ndërsa në klinika dhe në forma organizative të tyre kryhen shërbimet shëndetësore terciare.

Sikundër dihet, në Prishtinë, në kryeqytetin e Republikës, në mungesë të spitalit, shërbimet shëndetësore sekondare ushtrohen në Qendrën Klinike Universitare, në të cilën do të duhej të bëheshin shërbime shëndetësore, mjekësore terciare.

Pyetja është: Çfarë është mundësia dhe koncepti programor në këtë drejtim? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, ti je i gatshëm, si gjithmonë, urdhëro!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit, shumë, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra dhe deputetë,

Ani pse kjo pyetje s’ më ka rënë në dorë, mendoj se është një prej pyetjeve shumë të rëndësishme për kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Kryetari i kryeqytetit, zoti Isa Mustafa, që në fillim të mandatit të tij e ka adresuar këtë çështje në nivel të Ministrisë së Shëndetësisë. Ne kemi zhvilluar takime shumë konstruktive me kryetarin e kryeqytetit. Grupi i ekspertëve i Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës i ka bërë të gjitha përgatitjet që kryetari i komunës - kryetari i kryeqytetit të Prishtinës të shikojë mundësinë e gjetjes së lokacionit për Spitalin e Qytetit, por mbi të gjitha, të shikojë mundësinë e sigurimit të mjeteve për ndërtimin e spitalit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës dhe, sa jam në dijeni, kryetari Mustafa është duke bërë përpjekje maksimale që të gjejë fonde nëpërmjet IPS dhe besoj se në një të ardhme, jo shumë të largët, Prishtina do ta ketë spitalin e qytetit.

Kryeqyteti ynë, me këtë numër të banorëve që ka, me këto ambicie të zhvillimit që i ka dhe në një qark i cili graviton me më se 50% të popullatës së Republikës së Kosovës, është e domosdoshme që ta ketë Spitalin e Qytetit. Ne e mbështesim iniciativën e kryetarit dhe si Ministri e Shëndetësisë kemi bërë propozimin tonë profesional dhe do ta mbështesim në të gjitha fazat.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Do të kisha qenë i satisfikuar sikur të kisha dëgjuar ndonjë datë, ndonjë termin se ky koncept është programuar për t'u bërë. Faleminderit shumë!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

MINISTRI ALUSH GASHI: Sikur ta kisha pasur pyetjen, unë kisha për t'ua dhënë datën se cilën ditë Ministria e Shëndetësisë ia ka ofruar mbështetjen e plotë qytetit të Prishtinës. Sa i përket sigurimit të mjeteve, ne jemi shumë të entuziazmuar me përkushtimin e Konferencës së Donatorëve për Mbështetje të Projekteve dhe mendoj se ky është një projekt i mirë dhe se do të realizohet në një të ardhme të afërme.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Enis Kervan, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!
Pyetjen do ta paraqes në gjuhën turke.

Sayın Bakan

Bakanlığınız tarafından Prizren Belediyesine gönderilen program, formlar, şahsi belgeler, barınma belgesi, doğum belgesi, nikah belgesi ve çeşitli evrakların çoğunda ve özellikle kütük defterlerinde Türk dili ve yazısı yer almayarak, Dillerin Kullanımı Yasası ihlal ediliyor ve çoğu belgelerde halen UNMIK logoları kullanılıyor. Belediye yetkilileri bu hatanın merkezden, yani Bakanlığınız tarafından kaynaklandığını ileri sürüyor.

Bakanlık olarak sizler, sözkonusu Prizren Belediyesi olunca Dillerin Kullanımı Yasasını uygulayıp, bu güne kadar yapılan hataları düzeltmek adına Prizren Belediyesine ait programlarınızda tüm belgelerde, şahsi evraklarda, formlarda, özellikle belediyeye ait kütük defterlerinde Türk dili ve yazısının da resmi dil olarak yer alması ve Kosova Cumhuriyeti logolarına yerleş.....

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti deputet Kervan, të falënderoj për pyetjen. Fillimisht dëshiroj të theksoj se pyetja që ju e keni bërë i adresohet më tepër Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila ka vite që e ka marrë kompetencën e prodhimit të dokumenteve të gjendjes civile por, duke qenë se ju keni bërë një pyetje shumë të rëndësishme, ne kemi hulumtuar dhe e kemi përgatitur përgjigjen për pyetjen tuaj.

Fillimisht, neni 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka përcaktuar gjuhët zyrtare dhe ka përcaktuar se në nivelin komunal gjuha turke, boshnjake dhe rome, do të jenë në përdorim zyrtar në pajtim me ligjin dhe me Kushtetutën.

Ministria e Shërbimeve Publike ka adoptuar dy udhëzime administrative, të cilat kanë të bëjnë me realizimin barazisë së gjuhëve: Udhëzimin administrativ për procedura e njësish për monitorimin e barazisë së gjuhëve në nivel republikan, në nivel qendror dhe Udhëzimin administrativ për sanksionet administrative për shkeljen e Ligjit për gjuhët.

Ministria e Punëve të Brendshme, e cila është kompetente për prodhimin e dokumenteve të gjendjes civile, tani ka përfunduar programin softwerik dhe ka përfunduar aplikacionet elektronike të cilat në komunën e Prizrenit dhe në komunat tjera, ku gjuhët e komuniteteve janë në përdorim zyrtar, do të jenë të dizajnuara dhe të prodhuara edhe në gjuhët e tyre.

Ndërkaq, Ministria e Shërbimeve Publike këto ditë ka përfunduar strategjinë e qeverisjes elektronike ku ka paraparë që prej vitit 2009 të fillojnë të prodhohen 57 aplikacione elektronike për aplikime elektronike dhe të gjitha këto aplikacione do të prodhohen në pajtim me Ligjin për gjuhët dhe plotësisht do të respektojnë obligimin kushtetues për gjuhët e komuniteteve pakicë aty ku ato kanë të drejtë ta përdorin gjuhën në përdorim zyrtar- ato aplikacione do të prodhohen edhe në mënyrë elektronike.

Sa i përket Njësish për Monitorimin e Gjuhëve, ajo merret me monitorimin e gjuhëve në nivel republikan dhe deri tash në këtë njësi nuk kemi pasur asnjë ankesë për shkeljen e ligjit. Ministria e Pushtetit Lokal është kompetente për mbikëqyrjen e realizimit të barazisë së gjuhëve në nivelin lokal, mirëpo deri tash nuk kemi pasur ankesa të veçanta që tregojnë se në nivele lokale po shkelet Ligji për barazinë e gjuhëve.

Megjithatë, ne do të përcjellim këtë çështje dhe ju do të informoheni me kohë. Ne kemi evidentuar këtë kërkesën tuaj dhe këtë mundësi të mosrespektimit të gjuhës turke në komunën e Prizrenit dhe do t'ju informojmë me kohë rreth masave që do t'i ndërmarrin Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Rendit për të mundësuar realizimin e plotë të barazisë së gjuhëve.

KRYETARI: Deputet, keni pyetje shtesë? Urdhëro!

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Është e vërtet se në Prishtinë, në Vushtri, në Gjilan, në Mitrovicë, gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar, por në Prizren, sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve, gjuha turke është gjuhë zyrtare – jo gjuhë në përdorim zyrtar. Kjo duhet të dallohet. Unë ju falënderoj, zoti ministër për mirëkuptim, por unë vetë konkurrova për certifikatën e lindjes në Prizren dhe e mora jo në gjuhën turke. Domethënë, nuk respektohet gjuha turke si duhet në Prizren. Gjuha turke në Prizren është gjuhë zyrtare, e barabartë me gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Pra, duhet t'i dallojmë gjuhët zyrtare nëpër komuna dhe gjuhët në përdorim zyrtar nëpër komuna. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Zoti deputet, thashë edhe më herët dhe po e përsëris, arsyeya e kësaj vonese është pikërisht që Ministria e rendit është duke përfunduar aplikacionin softuerik, i cili do të jetë në mënyrë elektronike. Ne, nëse ka pasur një vonesë, ju kërkojmë mirëkuptim për këtë, sepse shumë shpejt në komunën e Prizrenit e edhe në komunat tjera do të dërgohen aplikacionet në mënyrë elektronike dhe të jeni plotësisht të sigurt se këto aplikacione do të jenë edhe në gjuhën turke, në bazë të obligimit kushtetues.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministren Justina Pula – Shiroka.

(Ndërhyrje - reagim)

Ose për ministrin Nenad Rashiq. Pasi ministri Nenad Rashiq është këtu, mund ta bëni pyetjen deputet!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

Dihet se gjendja sociale e minatorëve të ish-kombinatit “Trepça” është e mjerueshme. Një numër simbolik i tyre punojnë, kurse pjesa dërmuese janë pensionuar para kohe ose janë invalidë të punës, të cilët paguhen nga shteti me shuma minimale, madje nënçmuese në tri kategori, në vlerë prej 30, 50 dhe 80 euro. Sa u mjaftojnë për jetesë këto shuma, është tepër të komentohet. Është fjala për rreth 15 mijë familje.

Si e shohin zgjidhjen Qeveria, gjegjësisht ministrinë kompetente për këtë kategori tejet të respektuar të punëtorëve dhe të shoqërisë kosovare?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër?

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,

Poštovani zamenici premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Gospodine Naser,

Jeste da je to jedan tipičan problem kod nas i ono gde smo ga mi obuhvatili i smatrali da ćemo ga regulisati je unutar Zakona o penzionom i invalidskom osiguranju. Znači, zajedno sa ostalim sverama, sa ostalim aspektima i sopstvenim delovima društva koji su u našem sektoru, mi smo to planirali da zaokružimo u jednom procesu, odnosno u jednom Zakonu o penzionom i invalidskom osiguranju.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, keni pyetje shtesë?

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam, domethënë, një koment të shkurtër. Dihet se Ligji për pensionet dhe invalidët e punës nuk është në rend dite dhe as që është kah punohet intensivisht, do të thotë nuk ka zgjidhje.

Zoti Kryetar, juve ju ka ardhur një letër nga Shoqata e Minatorëve, të Pensionistëve dhe Invalidëve të Republikës së Kosovës, të cilët janë shumë të shqetësuar për gjendjen e tyre dhe të anëtarësisë që përfaqësojnë. Pra, ata i kanë disa kërkesa:

1. T'iu pranohet stazhi i punës prej vitit 1990 deri në 2003, kur Qeveria i ka marrë këto masa për pagesa nënçmuese;
2. Të bëhet pagesa mujore prej vitit 1990 deri me datën 1 qershor 2003 sipas Ligjit për të ardhurat e minatorëve, konform standardeve evropiane;
3. Të rregullohen pensionet sipas standardeve evropiane, sepse plot gojën e kemi Evropë dhe legjislacion me Bashkimin Evropian.
4. Në rast të vdekjes së pensionistit, këtë të drejtë ta gëzojë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit deputet, por ligjet kur të vijnë në Parlament, ne i procedojmë.

I njoftoj dy deputetët që i kemi kaluar, për shkak të mungesës së ministrit të Arsimit, se tani është radha e tyre. Deputetja Donika Kadaj, pyetje për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

DONIKA KADAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

Do të thotë mbyllja e universiteteve private nga ana e juaj është bërë jashtë çdo ligji në fuqi nëpërmjet një vendimi arbitrar, i cili është marr 24 orë pas marrjes së Raportit të Këshillit Britanik, raport ky që ka paraqitur rekomandime për përmirësim në disa fusha të caktuara, por assesi ndërprerje të procesit.

Ky vendim jashtëligjor, që e keni marrë ju u ka sjell vështirësi të mëdha të rinjve, të cilët kanë mbetur në rrugë pa ndonjë alternativë. Pyetja ime është: A keni menduar, a ka menduar Qeveria e Kosovës për fatin e mijëra nxënësve, të cilët pas përfundimit të maturës kanë mbetur të pa inkuadruar në institucionet shkollore dhe kush ka të drejtë t'ia mohojë sot rinisë kosovare që të mos ketë qasje në institucionet shkollore?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuari zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

Deputetë shumë të respektuar,

Më lejoni që t'ju informoj se nuk është fati i mijëra studentëve që kanë mbetur pa u regjistruar, por nëpërmjet statistikave ta përcjelli informatën kështu më të saktë. Gjatë këtij viti provimin e maturës e kanë dhënë 14 mijë studentë, Universiteti i Prishtinës ka pranuar 11 mijë studentë dhe kanë mbetur 3000 studentë, të cilët, vërtet, nuk kanë pasur mundësi që të regjistrohen në Universitetin Publik ose në universitetet private për shkak të procesit të akreditimit, i cili ka pasur rrjedhën e cila ka qenë në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë.

Ligji për arsimin e lartë parasheh që çdo institucion privat duhet të akreditohet pasi që ta marrë licencën dhe kjo, pikërisht, është mbrojtja, e interesit të atyre që të kenë arsim cilësor.

Ka qenë shqetësim i madh i Qeverisë dhe ne e dimë se sa një vendim i tillë ka qenë vërtet i rëndë, mirëpo nëpërmjet këtij vendimi ne kemi bërë përpjekje që ta rregullojmë fatin e 20 mijë studentëve që janë në universitetet private, të cilat diploma nuk janë pranuar deri me tash, të cilat universitete nuk kanë qenë të akredituara dhe në fund të vitit akademik 2008-2009, disa nga këto nëse janë të përkushtuara do të akreditohen dhe, si pasojë e kësaj ekziston mundësia që këta 20 mijë studentë ta kenë një qartësi sa i përket ardhmërisë së tyre dhe pranimi të diplomave të tyre.

Më lejoni t'ju informoj që procesi i akreditimit aktualisht është në fazën e dytë. Të gjithë bartësit privat janë duke punuar që ta ofrojnë raportin e vlerësimit të brendshëm, përderisa Universiteti i Prishtinës e ka ofruar raportin e vlerësimit të brendshëm. Nga janari fillon faza e dytë e cila nënkupton vlerësimin e jashtëm dhe ne presim si Qeveri e Kosovës, që për herë të parë Kosova ta ketë një treg të rregulluar të dijës, i cili treg bazohet në Ligjin për arsimin e lartë, të cilin ligj ky Kuvendi i Kosovës në vitin 2003 e ka miratuar.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

DONIKA KADA: Ministër, në një debat dhe takime të shumta që kishin në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Arsimit, kemi marrë informata që ju nuk keni paraqitur kriteret e vlerësimit të matshme dhe transparente për institucionet përkatëse. Ju, madje as s' keni dërguar një letër të protokolluar ku informoni institucionet përkatëse veç e veç për vendimin, arsyet dhe cilat janë procedurat që ata duhet t'i ndjekin, në mënyrë që, do të thotë, të kenë qasje në akreditim, që shpesh e keni quajtur edhe licencim edhe akreditim dhe keni shtuar një konfuzion te vetë institucionet.

Dhe për fund, ju vet keni qenë ligjërues në shumicën prej këtyre institucioneve dhe nëse cilësia ka qenë aq e dobët dhe këto institucione nuk kanë qenë në nivel, atëherë pse ju me vite të tëra ligjëruat aty dhe, në një formë ftuat të rinjtë kosovarë që të studiojnë në këto universitete?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAJ: Ju faleminderit!

Unë kam qenë ligjërues dhe ju keni qenë studente imja, kështu që besoj që kjo informatë është e kuptueshme për publikun, por më lejoni t'ju informoj që standardet dhe sa i përket bërjes publike të këtyre standardeve, standardet janë të Ligjit të arsimit të lartë të vitit 2003. Pra, unë nuk di si ministër se çfarë duhet të bëjë më publike se sa Ligji i cili është miratuar në vitin 2003.

Përveç kësaj, ekziston Konventa e Bergenit, e cila për çdokënd që e përmend fjalën akreditim është një dokument i domosdoshëm që ta shqyrtojë. Kështu që, unë si ministër i Arsimit kuptohet që nuk e kam një pozitë të lehtë kur qoftë edhe 3000 veta nuk kanë të drejtë, nuk kanë mundësi që ta ushtrojnë të drejtën e tyre në arsim. Unë mendoj që edhe Kuvendi i Kosovës dhe krejt pyetjet parlamentare duhet ta shohin në rrafshin më afatgjatë rëndësinë e një procesi i cili synon që ta ketë thjeshtë një sistem arsimor, i cili është i matshëm me vendet evropiane dhe procesi i akreditimit shërben edhe për disa vende të rajonit nga Kosova si model, veç nëse keni parasysh debatin, i cili ka qenë në Shqipëri pas Raportit të Këshillit Britanik për akreditim.

KRYETARI: Ju faleminderit, zotëri ministër!

Radha ishte për deputetin Zafir Berisha, ai nuk qenka këtu. Radhën e ka deputeti Nait Hasani. Pyetje për ministrin Idriz Vehapi apo për ministrin Mahir Yagcilar. I kisha lutur deputetët që t'i lexojnë, por edhe t'i adresojnë pyetjet! Regjia, ju lutem, fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, Kryetar!

Përshëndetje ministra,

Pyetja ime ka të bëjë për të dy ministrat, për ministrin e Bujqësisë dhe ministrin e Ambientit, pra pyetja është për të dy ministrat, nga të dytë kërkoj përgjigje. Edhe pas miratimit të Ligjit për mbrojtjen e pyjeve në Kosovë, prehen pyjet me te madhe në Malet e Sharit nga njerëz zyrtarë të pushteteve lokale, në bashkëpunim me rojet e pyjeve. Këtë e dëshmojnë këto fotografi ku shihen pamje duke prerë pyje, shihen regjistrimet e tabelave të kamionëve dhe furgonëve. Cilat janë masat ndëshkuese për personat të cilët shkatërrojnë Parkun Nacional në Bjeshkët e Sharrit. Në fotografi mund të shihen pamje të tyre duke prerë pyje, shihen po ashtu tabelat e furgonëve dhe të kamionëve që i bartin drutë e prera.

KRYETARI: Më duket se pyetja më tepër është për ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural. Zoti Vehapi, a ke përgjigje? Urdhëro, ministër Yagcilar!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Së pari, këto pyetje nuk i kam marrë, sigurisht ka ndodhur ndonjë gabim në administratë, po, ju faleminderit! Për këto çështje kompetenca është pak e përzier, sepse ekziston Ligji për pyjet, por, gjithashtu, Ligji për planifikimin hapësinor, edhe nëpërmjet Ligjit të vjetër për Parkun Nacional.

Edhe në mandatin e kaluar, ndoshta, deputetët nga mandati i kaluar edhe nga mandati i parë e dinë, sidomos Komisioni për Bujqësi dhe Pylltari, ekziston neni 6 në Ligjin për pyjet, ku janë të përziera kompetencat.

Ne, në këto ditë kemi mbajtur takime nëpërmjet Agjencionit për Pyjet. Ministria e Bujqësisë, gjithashtu, edhe Komisioni Evropian edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kanë zhvilluar një takim lidhur me këtë çështje. Besojmë që gjatë javëve të ardhshme, ndoshta, pas dy javësh apo tri javësh do ta zhvillojmë prapë një takim të përbashkët, do të bëhet një memorandum për zgjidhjen e këtij problemi, besojmë që me zgjidhjen nga aspekti ligjor do të bëhet edhe një menaxhim edhe një mbrojtje më e mirë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAHIT HASANI: Mua më intereson, kush është përgjegjës për t'i mbrojtur pyjet? Gjykata thotë, nuk kemi mundësi, policia thotë, nuk kemi mundësi, Ministria thotë, nuk kemi mundësi, qytetarët po i presin. Kush?

KRYETARI: Deputet, në pyetjen shtesë përgjigjet ministri i Punëve të Brendshme.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zotërinj zëvendëskryeministra, ministra, të nderuar deputetë,

Zoti Hasani, kjo është një çështje e cila në Qeveri është shtruar disa herë seriozisht. Së bashku me dy ministrat të cilëve u keni drejtuar pyetje kemi qenë, kemi vizituar disa

lokalitete që janë, i kemi targetuar si më problematike ku ka prerje drastike të pyjeve, kemi qenë në komunën e Deçanit dhe kemi marrë masa konkrete për këto çështje.

Dëshiroj të them se ndoshta debati kryesor do të ishte mirë të orientohet në sferën e legjislacionit, kompletimit të legjislacionit për t'i përmbushur nevojat në njëfarë mënyre të një intervenimi më të shpejtë për sa i përket evitimit të kësaj dukurie dhe paraandalimit të prerjes së pyjeve. Dëshiroj të them, po ashtu, që Policia e Kosovës, në disa prej qendrave të saj ka krijuar stoqe, deponi të drunjve të konfiskuar. Ne e kemi alarmuar edhe më herët, sidomos nga vizita që e kemi pasur në Deçan, bashkë me drejtuesit komunal të Deçanit, e kemi evidencuar. Vetëm në fillim, prej fillimit të vitit e deri në kohën kur ne e kemi vizituar Deçanin, Policia ka raportuar mbi 100 raste të evidencuara të evidentimit të personave. Shumica prej tyre janë recidivë, domethënë që kanë përsëritur, që janë marrë me trafikim ose me shitblerje të drurëve dhe asnjë prej tyre nuk është trajtuar nga gjykata. Pra, kemi nevojë për një mbështetje serioze të organeve të drejtësisë për sa i përket lëndëve që janë të paraqitura nga ana e Policisë.

Edhe një herë po them, stacionet e policisë, në shumicën e rasteve janë bërë stoqe të drurëve të konfiskuara nga Policia e Kosovës. Do me thënë ka aktivitete të policisë të shtuara. Mbetet të punohet më tutje në legjislacion dhe kërkohet një mbështetje më të madhe nga ana e organeve të drejtësisë, konkretisht nga ana e gjykatave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Përgjigja ishte në pyetjen shtesë. Ju lutem!

Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti.

Deputete, mund ta lexoni pyetjen!

SYZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, Kryetar!

Përsëritet për të gjithë!

Më datën 6 tetor 2008, një arsimtare e gjimnazit "Sami Frashri" në Prishtinë është sulmuar me thikë nga huliganët, sepse ka denoncuar në polici përdorimin e drogës në këtë shkollë.

Sipas deklaratës së arsimtares, sulmuesit kanë qenë të panjohur, gjë që jep të kuptojmë se kanë qenë shitës të drogës në këtë shkollë.

Zoti ministër, a keni ju të dhëna se në çfarë shkalle përdoret droga nëpër shkollat tona të nivelit të mesëm dhe cilat janë masat tuaja si Ministri për nxjerrjen e drogës nga shkollat tona, përdorimi i së cilës fëmijëve tanë ju kushton me jetë?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit për pyetjen, zonja deputete!

Dëshiroj të them se unë, menjëherë pas rastit, personalisht kam qenë i informuar, kam pasur informatën edhe të policisë për rastin edhe nga vetë interesimi asaj dite nga vetë Ministri i Arsimit.

Kemi shqetësimet tona, në evidencat tona gjendja në këtë fushë është shqetësuese. Përdorimi i drogës është i shtuar në disa qendra urbane, është kryesisht shqetësues në Prishtinë. Tani, masat konkrete që i kemi marrë bashkë me Ministrinë e Arsimit është përgatitja e një strategjie për luftimin e dhunës në shkolla dhe këto ditë e kemi plan aksional pikërisht këtë çështje. Bashkë me Ministrin e Arsimit jemi duke e koordinuar nënshkrimin final të këtij dokumenti dhe do të marrim masa shtesë.

Kam pasur të adresuar, përveç aspektit të dhunës në shkolla, përdorimit të drogës edhe disa fenomene tjera që i kemi tash në evidencat tona dhe bashkë me ministrin e Arsimit po gjejmë mundësitë në çfarë forme do të ishte intervenimi i anës sime, i spektrit policisë. Ju e dini që po mundohemi që ta evitojmë prezencën e uniformës sa të mundemi nëpër shkollat tona. Evidencat po them edhe një herë janë shqetësuese. Pas nënshkrimit të këtij dokumenti të përbashkët, ne do t'i kemi disa aktivitete që na obligon ky dokument.

Dëshiroj t'ju them derisa ne po flasim, një operacion i policisë është duke vazhduar në Prishtinë, nuk ka të bëjë me intervenimin e policisë drejtpërdrejt në shkolla, por me hetimin e rasteve të përdorimit të drogës dhe të dhunës nëpër shkolla. Informatat e policisë që i kam deri tash, d.m.th. janë të bollshme për të bërë disa intervenime. Do të shohim bashkë me Ministrinë e Arsimit për kyçje, po ashtu, edhe të prindërve, sepse evidencat tregojnë se edhe një numër i madh i të rinjve që janë nën moshën e pjekurisë, janë të involvuar në raste të tilla.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete, keni pyetje shtresë?

SUZAN NOVOBRDALIU: Po, Kryetar!
E përmendët strategjinë me Ministrinë e Arsimit, cila është ajo? Pra, nëse ka mundësi të na njoftoni për numrin e rasteve, deri më tani sa janë të ndriçuara?

KRYETARI: E ka fjalën ministri Zenun Pajaziti.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Siç e dini, ne kemi nënshkruar një marrëveshje-memorandum të përbashkët me Ministrinë e Arsimit, me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Detyra ime ka qenë për ta punuar një strategji për luftimin e dhunës nëpër shkolla dhe kjo është detyra të cilën unë po e bëj. Ky është dokumenti në të cilin do t'i precizoj detyrat e mia, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kryesisht të Policisë.

Meqenëse unë pyetjen e pata për mbledhjen e kaluar, sot nuk kisha të evidencuara, nuk i mora statistikën për t'i dhënë për të gjitha rastet. Për rastin konkret që pyetët ju, të dhënat që i kemi ne, domethënë për personin ende nuk kemi pasur dëshmi të mjaftueshme edhe pse ka qenë i përshkruar ai person. Hetimet janë bërë në mënyrë shumë të shpejtë, edhe pse janë marrë në pyetje disa prej personave, megjithatë ende policia nuk e ka dhënë hetimin përfundimtar për identifikimin e personit, i cili ka ushtruar dhunë ndaj një arsimitareje.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministren Justina Pula – Shiroka. Ministria nuk është këtu, pra, a dëshironi ta bëni pyetjen?
Regjia, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryetar, së pari e kam një vërejtje se për të satën herë agjendën e Kuvendit ia përshtatni agjendës së ministrave ose të Kryeministrit. Në qoftë se njëri nga zëvendëskryeministrat ose ministrat janë të përgatitur, unë mirëpres përgjigjen.

KRYETARI: Parashtroni pyetjen, nëse mund të përgjigjen, le të përgjigjen!

GJYLNAZE SYLA: Jo, unë dua ta di se a janë të përgatitur.

Shkalla e papunësisë në Republikën e Kosovës është e lartë. Sipas të dhënave zyrtare, shkalla e papunësisë është 45%. Në anën tjetër, Kosova ka një popullatë të re, e cila është e aftë për punë, prandaj është evidente se papunësia është problem i rëndësishëm që kërkon një zgjidhje të shpejtë. Çfarë po bën Qeveria lidhur me problemin e papunësisë?

KRYETARI: E ka fjalën ministri i Punës.

MINISTRI NEDAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Gospodjo Sylja, verovatno neću moći sve segmente da uklopim u ovaj kratak odgovor, ali reći ću vam na brzinu ono što budem mogao. Pokušavamo na razne načine da pre svega omogućimo našim ljudima jedan pristup određenim partnerima u Evropskoj uniji i u drugim zemljama, kao što su..., reći ću vam da imamo dobre partnerske odnose sa Slovenijom, Norveškom, Saudijskom Arabijom, koja je ponudila isto posao, čak konkretne ponude za posao. To je jedan način zapošljavanja i delimičnog zatvaranja tog problema u ovom momentu.

Naravno, da mi za sve njih moramo da obezbedimo budućnost na Kosovu i to ćemo i uraditi, ali znate da bez ekonomskog razvoja, mi ne možemo. Jednostavno, nema dovoljno vremena za tako nešto. E, kada taj ekonomski razvoj bude u nekom segmentu povišen, onda tako i možemo očekivati da ih možemo zaposliti kroz te određene firme koje dolaze. Recimo, ja sam u stalnim kontaktima, ima određenih kompanija koje su zainteresovane i jeste u malom aspektu. Nekoliko desetina radnika žele posao, ali ipak smo pokrenuli te pocese koji će biti važniji kasnije. Znam da ponekad mladi nemaju strpljenja, ali stvarno mislim da smo na dobrom putu i kao što sam rekao, ne mogu vam sve detalje objasniti ovim putem, ali sigurno da bi bio spreman ukoliko interesuje nekog od poslanika, ili neku određenu grupu poslanika da vam predočimo šta smo do sada uradili.

Što se tiče procenta nezaposlenosti, ja stvarno, biću vrlo iskren, ne verujem da je ta tolika stopa nezaposlenosti, jer databaza, samo da vam kažem, molim vas, databaza koja je uradjena tad, pre 6 ili 7 godina, i ti ljudi koji su tada registrovani, mi ih još uvek vodimo kao nezaposlene, bez ikakvih saznanja dali su oni zaposleni negde ili su negde privremeno zapošleni, pa su otpušteni. Mi samo priključujemo nove nezaposlene, ... samo povećavamo taj broj, razumete. Mi ne smanjujemo taj broj, jer nemamo dovoljnih informacija o onim ljudima koji su zapošljeni. Za to se sada u našem Ministarstvu radi jedna kompleksna i velika databaza koja će biti dostupna svakom centru, znači svaki centar će imati uvid u stanje nezaposlenog, recimo Nenada Rašića, i znaće dali sam ja negde radio ili dali negde radim sada.

Prema tome, stopa nezaposlenosti će takode biti jasno utvrđena kada budemo završili sa databazom. A pored toga...

KRYETARI: Ju falemindierit, ministër!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryetar, a ju pëlqeu që në vend të ministres, ju drejtova me një pyetje tjetër? Kjo, u mësova si të udhëhiqet.

Zoti ministër, sido që të jetë, mua më intereson t'i tregosh publikut sa për qind ka për t'u zvogëluar papunësia në vitin 2009? A mund të na tregosh 0,1 për qind, 1 për qind, 2 për qind, sa ka për t'u zvogëluar?

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Gpspođo Sylja, znate i sami da ne znam ko bi to mogao u ovom momentu sada da proceni, stravrno ne znam. Ja sam malo pre bio na jednom sastanku, koji ću vam reći ovaj detalj, možda biće vrlo nepolitički da to uradim, ali u jednom razgovoru sa ambasadorom Norveške, ja sam recimo u Norveškoj bio pre mesec ipo dana ili mesec dana, tako nešto, i tu stalno smo imali neke konstruktivne razgovore i mislim da sam dočarao na jedan adekvatan način našu socijalnu, političku, ekonomsku i društvenu situaciju, tako da razumevanje na koje sam naišao tamo, je obećavajuće, dao sam jedan od primera, znači dao sam Norvešku kao vrlo strateškog partnera, da tako nazovem.

Pre sat vremena, sat ipo smo se sreli sa ambasadorom Norveške koji je imao izmedju ostalog da mi pokaže dokumenta, jedan memorandum koji bi mi možda, kada bi ga budemo analizirali, trebali da potpišemo.

Indirektno, taj memorandum bi u 2009. godini, omogućio otvaranje granica Norveške prema kosovskom društvu. Znači, ovo je jedna eskkluzivna informacija, ja sam rekao, vrlo je nepolitički sa moje strane što vam to kažem sada, ali to je ono što može u znatnoj meri da smanjuje nezaposlenost, ali da vam kažem ja u kojoj to meri, kojem procentu, bio bih totalno promašeno, ja to ne mogu da predvidim, ali nadam se da će u vrlo znatnoj meri da smanji. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Alush Gashi.

TEUTA HADRI: Ju, zoti ministër, keni dalë para mediave me një ndjenjë të veçantë gëzimi gjatë prerjes së shiritit në Repartin e Lehonave të posa rinovuar dhe jeni zotuar se së shpejti do ta bëni sa më funksional këtë repart. Pse, zoti ministër, deri tani Ministria juaj nuk ka gjetur mjete ende për ta funksionalizuar këtë repart?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Ju e dini më mirë se të gjithë, si profesioniste që një pjesë të mirë të jetës së juaj e keni kaluar në atë klinikë, se në vitin 2004 Agjencioni Kanadez për Zhvillimin Ndërkombëtar ka bërë renovimin e asaj klinike dhe duke iu falënderuar angazhimit të Qeverisë së Luksemburgut, është bërë renovimi i atij reparti.

Sipas procedurave në fuqi në vendin tonë, nevojitet një planifikim për investime kapitale. Çdo shumë e cila kalon, nëse nuk jam gabim vlerën prej 5000 euro, konsiderohet investim kapital të cilin Qeveria dhe Kuvendi e miratojnë një herë në vit. Për vitin 2008 nuk ka qenë e paraparë që të investohet në te.

Duke marrë parasysh urgjencën dhe nevojën si dhe prioritetin për shëndetin e nënës dhe fëmijës, menjëherë pas atij përrurimi kemi lutur donatorë të ndryshëm dhe duke iu falënderuar përkushtimit të qytetarëve kosovarë që jetojnë në Zvicër dhe transportit të mbështetur nga qytetarët kosovarë që jetojnë në Gjermani, ne spitalit menjëherë ia kemi sjellë më se 30 krevate, dhe me buxhetin për vitin 2009, i cili për investime kapitale do të jetë 12.5 milionë, nga 9 milionë, jam i bindur që ai repart do të funksionalizohet dhe

shpresoj se me ngritje të kapaciteteve në planifikim, gjendja do të përmirësohet dukshëm. Ju faleminderit në pyetje dhe përkushtim.

KRYETARI: A keni pyetje shtesë, deputete?

TEUTA HADRI: Reparti i Lehonave i ka 82 shtretër me 40 e sa krevate që janë sjellë si donacione, përsëri nuk i plotësojnë kushtet, pacientët janë nga dy në një krevat. Si do ta zgjidhni problemin?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Fatmirësisht në të gjitha qytetet e vendi tonë dhe në shumicën e qendrave kryesore të Mjekësisë Familjare, janë maternitete. Vija e referimit krijon problem. Më se 40% të lindjeve që vijnë në Qendër Klinike Universitare janë jashtë qytetit të Prishtinës, që do të thotë lindje që duhet të përcillen, të zhvillohen në qytetet e tyre dhe kjo është një prej dobësive që e kam gjetur në sistem dhe një prej çështjeve të cilat do t'i evitojmë, dhe lidhur me këtë në pjesën e dytë të këtij viti, kemi rezultate.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Pyetja e fundit për sot, deputetja Kaqusha Jashari, ka pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Pyetja për ministrin, zotin Nenad Rashiq.

Keni deklaruar se është formuar Grupi punues për përgatitjen e Ligjit për sigurimin pensional e invalidor.

Zoti ministër, a është punuar në këtë drejtim dhe a është proceduar propozimi nga Ministria në Qeveri dhe kur mund ta presim miratimin e këtij projektligji.?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

NENAD RAŠIĆ: Hvala predsedniče,
Gospodjo Jashari,

Kao što ste i sami upoznati i rekli ste da smo mi formirali radnu grupu, koja već neko vreme radi na projektu zakona za invalidsko- penziono osiguranje i ta grupa je pri kraju svog posla. Znači, njima je ostalo verovatno oko mesec dana rada, koji u sebi uključuje i posetu Hrvatskoj, čiji smo zakon mi analizirali i utvrdili smo da neki od segmenata unutar tog zakona su vrlo odgovarajući za zakon koji bi bio implementiran kod nas. Tako da u dogledno vreme će verovatno taj Nacrt zakona biti kompletan. Znači, eventualno do kraja godine će biti sigurno kompletiran i spreman za dalje. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Ke pyetje shtesë, deputete?

KAQUSHA JASHARI: Vetëm desha të them se këtu në këtë Kuvend, zoti ministër ka premtuar një afat, e ai ka qenë nëntori. Prandaj, mendoj se jo vetëm për këtë rast, por edhe për ligjet e tjera, Qeveria duhet të ketë në konsiderim edhe atë që premtojnë këtu. Prandaj, grupi punues ka mundur edhe më shpejtë ta bëjë.

KRYETARI: Faleminderit!

Koha e planifikuar për pyetje parlamentare është harxhuar.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

E falënderojmë ministrin që ka ardhur, por ka ardhur me vonesë. Koha është harxhuar, radhën tjetër.

- Shqyrtimi i parë i Projektligji për mbrojtje nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguri nukleare

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Jagcilar, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR JAGCILAR: Faleminderit, zotëri Kryetar!

I nderuari Kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Të nderuar deputetë,

Baza juridike për nxjerrjen e Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare qëndron në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por gjithashtu Projektligji bazohet në Direktivën e Këshillit Evropian, numër 96/29, Direktivën Evroatom, Direktivën 87/600 dhe në direktivat e tjera të kësaj fushe.

Arsyeja për nxjerrjen e këtij Projektligji është përfshirja dhe plotësimi i Kornizës ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare në Kosovë, si dhe nevoja e harmonizimit të legjislaturës mjedisore në atë të Bashkësisë Evropiane.

Qëllimi i Projektligjit është përmirësimi i Kornizës ligjore nga lëmi i mbrojtjes së mjedisit. Projektligji synon të përcaktojë masat e mbrojtjes, të jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe të mjedisit nga ndikimi i dëmshëm i rrezatimit dhe masat e sigurisë gjatë të gjitha veprimeve lidhur me aktivitetet nukleare, mbeturinat radioaktive dhe mbikëqyrjen gjatë implementimit.

Projektligji, gjithashtu, synon të sigurojë realizimin e normave dhe të konventave ndërkombëtare nga lëmi i rrezatimit jojonizues, jonizues dhe siguria nukleare, të sigurojë krijimin e një midisi të shëndoshë që i përballon ndotjet dhe shpenzimet për mbrojtje nga rrezatimi i cili do të jetë në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Projektligji krijon kompetenca dhe detyrime të autoriteteve publike, të cilat janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të standardeve të tilla dhe t'u japë të drejta dhe detyrime personave dhe ndërmarrjeve që preken nga aktivitetet e tilla ose interesat që promovojnë në mjedis të shëndetshëm në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Ligji për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguri nukleare është përbërë nga 62 nene dhe i trajton çështjet, si në vijim:

Mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues dhe jonizues, ku trajtohet sistemi i masave të mbrojtjes nga rrezatimi jojonizues dhe jonizues. Vlerat kufitare të rrezatimit, të lejuara nga Qeveria e Kosovës.

Hulumtimin sistematik të përmbajtjes së nuklideve në mjedis. Vlerësimin e nivelit të ekspozimit dhe të rrezatimit jojonizues dhe jonizues dhe kushtet për operim të rrezatimit.

Obligimet e personave fizikë dhe juridikë të cilat prodhojnë, bëjnë bartjen dhe shfrytëzojnë burimet e rrezatimit jonizues, si dhe kushtet e parapa për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Dispozitat mbi ndalimin që të punohet në burimet e rrezatimit jonizues të disa kategorive të personave, siç janë gratë shtatzëna dhe personat nën 18 vjeç.

Menaxhimi me mbeturinat radioaktive në të cilin caktohet obligim për Qeverinë e Kosovës që të krijojë mundësi për deponim të përkohshëm dhe të përhershëm të mbeturinave radioaktive.

Gjithashtu, obligimi që Qeveria e Kosovës të themelojë një autoritet regullativ i cili do të merret me çështjet e mbrojtjes. Trajton kushtet për import, eksport, bartje dhe transit të materialit radioaktiv dhe nuklear. Trajton masat për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve dhe sigurimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse për lokacion, ndërtim, punë provuese, lëshim në punë, shfrytëzim, ndërprerjet e përhershme të punës dhe dekomisionimi i objekteve nukleare.

Shqyrton veprimet në rastet e jashtëzakonshme të cilat i ndërmerr Qeveria për të mbrojtur jetën, shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Në rast të aksidentit nuklear, lajmërimin me kohë për faktet të emergjencës, hapat që duhet të ndërmarrë, masat për mbrojtjen shëndetësore për atë popullatë. Cakton përgjegjësinë për dëmet nukleare, trajton mbikëqyrjen dhe kompetencat, trajton dispozitat ndëshkuese.

Në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare parashihet që Qeveria, shfrytëzuesit e objektit nuklear dhe shfrytëzuesit tjerë të burimeve do të sigurojnë kushte për vendosje ose depozitim të mbeturinave radioaktive në afat prej 2 vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Projektligji.

Në projektligj parashihet që burimet e rrezatimit jonizues nga rrufepritësi të largohen në një afat prej 2 vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Projektligji.

Të nderuar deputetë,

Në fund, propozoj që ky Projektligj të pranohet në leximin e parë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit, zoti ministër!

Pas prezantimit të ministrit, hapim debatin lidhur me miratimin e ligjit në parim. Sipas renditjes, fjalën e ka kryetari ose raportuesi i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zoti Zeneli. Ai nuk është këtu. Në emër të tij, nuk ka të paraqitur. Në këtë rast, i kisha lutur kryetarët e komisioneve dhe komisionet në përgjithësi që paraprakisht t'i autorizojnë me shkrim ata që do të raportojnë në emër të komisioneve. Kryetarët e komisioneve të përhershme, as ata nuk janë paraqitur.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që të marrin pjesë në debat lidhur me ligjin. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, është paraqitur Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Për shkak të rëndësisë që ka Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, jojonizues dhe siguri nukleare, Grupi kuvendor i Partisë Demokratike e ka parë të arsyeshme ta përkrahë në miratimin, në shqyrtimin në parim të këtij Projektligji. Gjithashtu, mund të them se edhe Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis është i pajtimit që ky Projektligj të shkojë në shqyrtim të parë dhe të shkojë në procedurë parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Faleminderit, zoti ministër, për sqarimet që i dhatë lidhur me këtë ligj. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet në parim Projektligjin e paraqitur në emër të Qeverisë nga ministri Yagcilar dhe, sigurisht, ne do ta japim kontributin tonë në kuadër të komisioneve funksionale të Parlamentit tonë. Faleminderit!

KRYESEUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, është paraqitur deputeti Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguri nukleare është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Qëllimi i këtij Projektligji është realizimi i normave dhe konventave ndërkombëtare nga kjo lëmi si dhe lëmia e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridikë dhe ndërmarrjet që merren me aktivitetet e tilla ose interesat që promovojnë një mjedis të shëndoshë në Kosovë.

Ky Projektligj duhet të aprovohet sa më parë me qëllim që të zbatohen dispozitat ndëshkuese të nenit 52, pika 1 dhe 2, që të pengohen disa aktivitete të cilat po zhvillohen tani në Kosovë. Unë po përmendi këtu, për shembull, grumbullimin dhe shitjen e katalizatorëve të automjeteve motorike në mënyrë të pakontrolluar.

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe është pajtuar që në parim që të procedohet në komisionin funksional, duke e rezervuar të drejtën që me sugjerimet e veta nëpërmes përfaqësuesve të vet të kontribuojë në përmirësimin cilësor të këtij Projektligji me qëllim që të implementohet sa më parë dhe sa më mirë në praktikë pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zotëri kryesues!

Zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Është shumë mirë që ky Projektligj vjen për miratim në Kuvend sepse gjerë më sot ka pasur shumë paqartësi se a ekziston ndonjë rregull në këtë lëmi, kështu që shpesh janë paraqitur thashetheme për ekzistimin e rrezatimit në material ndërtimor të importuar. Shembulli i fundit ma i freskët ishin pllakat në sheshin e kryeqytetit, supozimet për ekzistimin e rrezatimit pas bombardimeve dhe lidhjes së tij me rritjen e paraqitjes së kancerit te popullata në Kosovë, kështu që të gjitha këto dilema ekzistuese në lidhje me këtë problematikë do të hiqen nga qytetarët nëse e dinë se do të rregullohet kjo lëmi me ligj.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë projektligj, miratimin e këtij Projektligji në parim, se është Projektligj shumë i mirë, por nëse analizohet ajo fleta për implikimet buxhetore, aty po shihet që shpenzimet për këtë projektligj nuk janë paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, as për vitet buxhetore 2009 – 2011, kështu që unë frikohem që ky ligj sot miratohet në parlament dhe kalon nëpër komisionet funksionale dhe komisionet e tjera përgjegjëse, por nuk do të mund të zbatohet për arsye se i mbetet Ministrisë së Planifikimit Hapësinor t'i gjejë paratë për aplikimin e këtij projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të LDD-së, fjalën e ka zoti Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, jojonizues dhe siguria nukleare. Këto janë kërkesa të përmbushjes së vakuumit legjislativ dhe edhe me *acquis communautaire*, do të thotë, parashihet përmbushja e këtij vakuumi që në Kosovë ka ekzistuar dhe bile këto vitet e fundit nuk është marrë askush me këtë problematikë dhe kemi pasur raste të 4 – 5 muajve të fundit me qarkullimin të lloj-lloj materialeve me këtë karakter negativ që ndikojnë dukshëm në shëndetin e popullatës.

Qëllimet e Projektligjit janë që të sigurojë realizimin e normave dhe të konventave ndërkombëtare nga lëmi i rrezatimit jonizues dhe sigurisë nukleare. Do të thotë, ky Projektligj në radhë të parë ka të bëjë me ruajtjen e mjedisit jetësor dhe ruajtjen e popullatës së këtij shteti, do të thotë, përkujdesjen shëndetësore nga efektet të dëmshme të rrezatimit jonizues.

E kemi një vërejtje, si grup, te kostot buxhetore për implementimin e këtij ligji të rëndësishëm, që nuk janë precizuar si duhet dhe çka në qoftë se në të hyrat që i ka paraparë ky Projektligj nuk realizohen për vitet 2009, 2010 dhe 2011.

Mos të harrojmë që Kosova është një shtet me sipërfaqe të vogël, siç e arsyetoi edhe ministri i dikasterit kompetent. Ndërtimi i deponive për materialet që kanë materie radioaktive në vendin tonë konsideroj që është shqetësues dhe Grupi Parlamentar i LDD-së nuk mund të pajtohet me këtë.

Besoj, zoti ministër, që së bashku me komisionin funksional të Parlamentit të Republikës së Kosovës, me grupet e ekspertëve dhe hartuesit e këtij projektligji duhet të keni shumë kujdes se çka po sanksionohet sa i takon kësaj lëmie tejte të ndejshme për vendin dhe qytetarët e Kosovës.

Ne, si Grup Parlamentar, në parim e mbështesim këtë projektligj dhe kontribimet tona do t'i japim gjatë procedimit të mëtejshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+" është paraqitur deputetja Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pozdravljam sve prisutne!

Nacrt zakona koji je danas pred nama, uredjuje i objašnjava pitanje zaštite životne sredine i ljudskog zdravlja od nejonizujućeg, jonizujućeg zračenja i nuklearne bezbednosti.

Nacrt zakona je izradjen dobro i kao osnov je koristio opšte principe zakonodavstva Evropske Unije iz ove oblasti. Ono što smo mogli primetiti jeste da tekst člana 50. stav 1. treba uskladiti u sve tri verzije.

Inače, Predlog zakona je zaista dobro izradjen, sveobuhvaten je i Parlamentarna Grupa „7+“ ga podržava u načelu i veruje da će funkcionalna komisija uraditi sve da dobijemo jedan zakonski dokument koji će biti sprovodljiv u praksi. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar SLS, nuk është paraqitur.

Sipas renditjes, fjalën e ka deputeti Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryeses!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar tre ministra,

Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe siguri nukleare është i rëndësishëm për plotësimin e kornizës ligjore në këtë fushë, sidomos duke marrë parasysh se deri më tani Kosova nuk e ka pasur këtë kornizë ligjore.

Ky është i domosdoshëm, po ashtu, për të trajtuar këtë çështje, për t'i avancuar çështjet e ambientit, por gjithashtu edhe për shkak të nevojës së harmonizimit të legjislaturës mjedisore me atë të Bashkimit Evropian.

Projektligji është sidomos i rëndësishëm duke marrë parasysh se mbrojtja e shëndetit të popullatës, në radhë të parë të pleqve, të grave shtatzëna dhe, po ashtu, të fëmijëve, dhe paraqitja më e shpeshtë të kacerëve, shtron nevojën që Kosova ta ketë sa më parë këtë kornizë ligjore.

Po ashtu, në Projektligj janë paraparë masat e ndryshme që kanë të bëjnë me zbatimin e mbrojtjes së rrezatimit, pastaj me menaxhimin e aktiviteteve nukleare, por edhe të mbeturinave radioaktive, me hulumtimin sistematik të përbërjes së radionuklidëve, me vlerësimin e shkallës së ekspozimit rrezatimit jonizues, me vendosjen e monitorëve të rrezatimit në vendet kufitare të Kosovës, formimin e organit rregullativ i cili merret me çështjet e mbrojtjes nga rrezatimi dhe siguria nukleare.

Në ligjin është paraparë, gjithashtu, që mbikëqyrja e zbatimit të ligjit të bëhet nga inspektoratet dhe inspektorët nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës, Ministria e Transportit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Ligji dhe aktet nënligjore që do të nxirret, parashihen të bëhen konform standardeve të BE-së. Megjithatë, unë e kam një dilemë, zoti ministër, lidhur me arritjen e qëllimit të këtij ligji, duke marrë parasysh se qëllimi i ligjit thotë se është zbatimi i normave dhe i standardeve ndërkombëtare, si dhe i konventave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushën e rrezatimit jojonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare. Nëse është ashtu, në bazë të përmbajtjes së ligjit shihet se ky kryesisht mbështetet në standardet e caktuara me Direktivën e Këshillit 9629 Eurotom, të nxjerrë në vitin 96, sipas të cilit janë caktuar standardet bazë për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe të publikut të gjerë. Kurse, ekzistojnë së paku edhe 7 lloje të tjera, gjegjësisht direktiva, rregullativa dhe vendime që vinë nga Këshilli i Evropës.

Prandaj, është me rëndësi që edhe këto të përfshihen, sepse nuk është mjaft i detajuar, për shembull, nuk është e përfshirë se sa është doza e rrezatimit, që sipas Direktivës Evropiane kjo dozë nuk duhet të jetë më e madhe se 100 miliseverë.

Tjetër, siç e përmendën edhe kolegët e tjerë, është vetë buxheti, me qenë se nuk është e paraparë as në buxhetin e Ministrisë në vitin 2009 – 2011 dhe as në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Parashihet që vetë Ministria të absorbojë shpenzimet buxhetore brenda Ministrisë.

Zoti ministër, a është paraparë kjo me buxhetin e Ministrisë për të ditur se do të jetë ligji i zbatueshëm?

Janë paraparë disa të hyra të Ministrisë për shkak të lejeve dhe të licencave të licat do të jepen, por kjo shumë e cila do të fitohet, është shumë e vogël për të mbuluar shumën që është e nevojshme për zbatimin e ligjit, që vlerësohet të jetë një kosto shtesë prej 2 milionë e gjysmë.

Megjithatë, siç e përmenda në fillim, për shkak të rëndësisë që ka ky ligj, mbrojtjen e shëndetit të publikut dhe nevojën e menaxhimit të këtyre rrezatimeve dhe sigurinë nukleare, unë e mbështesë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar ministra dhe deputetë,

Disa rekomandime parimore. Kosova e ka një territor të papërshtatshëm sa i përket depërtimit të rrezeve jonizuese, radioaktive, e tjera, e tjera, edhe nga vendet e tjera, sepse është një pellg dhe sipërfaqja është e limituar. Nuk është trajtuar fare me ligj kjo që mund të ndodhë, edhe parim, do të thotë.

Më pastaj, ministrit do të duhej t'i jepeshin ingjerenca edhe prerogativa shumë të gjëra sa i përket miratimit të instruksioneve juridike në funksion të aplikimit të këtij ligji, sepse ato në përgjithësi janë të standardizuara dhe janë tepër të nevojshme, kurse me dokumentin ligjor nuk mund të prezicohen dhe afatet, po e zëmë, ishte dashur të jenë më racionale, jo 18 muaj, po i bien praktikisht në aplikimin e këtij Ligji, se ky Ligj është shumë i rëndësishëm dhe do të duhej të kalonte, natyrisht, do të kalojë, po jo edhe afati i tillë. Ky dokument lëngon edhe nga aspekti terminologjik, juridik. Duhet t'i jepet një ton i gjuhës juridike sepse kuptohet më mirë, aplikohet më mirë dhe medoemos duhet të harmonizohet në tri gjuhët, nuk është i harmonizuar, ka diskrepanca. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Diskutuesi i fundit është deputeti Ardian Gjini. Ftoj deputetët që të kthehen në sallë për të votuar.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të isha pajtuar menjëherë që Ligji është i nevojshëm, ka filluar të përgatitet që një kohë të gjatë. Sidoqoftë, janë dy çështje të cilat në ekspozenë e vet ministri nuk i përmendi, e unë mendoj se janë çështjet më të rëndësishme në të cilat është dashur të vihet theksi përderisa ekspozohet ose prezantohet para Kuvendit për votim një ligj i tillë.

Unë kisha dashur që ministri të na i bëjë edhe disa shpjegime, sepse edhe ashtu rregull do të ishte shumë në rregull që të debatohet për një ligj kësi soji, sipas mundësive, nëse është i përgatitur dhe të na tregojë, a lë hapësirë ky ligj në bashkësi me Ligjin për mbeturinat, i cili ka kaluar një kohë më parë në Kuvend, që në Kosovë, shembull ta marrim, të ketë deponi të mbeturinave radioaktive në të ardhmen. Nuk është shpjeguar dhe mendoj se kjo është një ndër çështjet kryesore. Çështjet tjera të cilat janë përmendur në ligj, janë çështje rutinore. Ato janë çështje të cilat rregullohen edhe në vendet tjera, do të thotë, cilat janë materialet që mund të përdoren në Kosovë, me dozë radioaktivitetit gjithkund rregullohen, si mund të importohen, si mund të deponohen, e tjera, e tjera. Mirëpo, ekziston një element këtu, i cili thotë se në Kosovë mund të ketë deponi të mbeturinave radioaktive. Ndërsa, Ligji për mbeturinat thotë se në Kosovë mund të importohen mbeturinat.

Tani, janë disa rregulla atje në atë ligj, ekzistojnë disa lista, disa shifra. Unë mendoj se këto janë çështje të cilat ministri duhet t'ia shpjegojë Kuvenditë a e di, shembull ta marrim, a ka punuar dikush kur i bën bashkë këto dy elemente. Si elemente të ndara nuk i paraqesin asnjë problem. Mirëpo, kur i sheh në një bazë ligjore, atëherë ekziston mundësia që të shkaktojnë problem. Kjo është çështja e parë për të cilën ministri nuk foli, e ka qenë dashur të flet.

Dhe, çështja e dytë është buxheti. Shikoni, ne e kemi marrë draftbuxhetin për vitin e ardhshëm, për vitin 2009, prej Qeverisë. A ka diçka në draftbuxhet, çka do qoftë në atë draftbuxhet, që na bën neve të dimë se ky ligj do të fillojë të implementohet, nëse eventualisht themi, për diku 2 muaj i kalon të gjitha procedurat në Kuvend dhe eventualisht nënshkruhet prej Presidentit të Kosovës. Kur po flasim për ligjet në Kuvendin e Kosovës, po flasim për nene. Unë mendoj se duhet të fillojmë t'i shohim edhe për fjalë, se a janë përkthyer në rregull, apo nuk janë përkthyer në rregull. Duhet të fillojmë t'i shohim në bashkëdyzim me legjislacionin të cilën e kemi kaluar deri më tani dhe me pasojat të cilat këto ligje mund të shkaktojnë kur shihen si pjesë e tërësisë së ligjeve të cilat i kemi.

Unë edhe njëherë po them se është mirë që ministri të na flas diçka për këto dy pika, do të thotë për buxhetin, a ka buxhet, a ka paraparë buxhet. Që nëse ky ligj kalon, ta implementojë, për shkak se kështu punojnë qeveritë serioze. Duhet t'i dimë të gjithë hapat paraprakisht, e jo ta befasojnë vetveten me veprimet e veta.

Dhe, çështja tjetër është, cili është efekti i bashkëdyzimit të këtij Ligji me Ligjin për mbeturinat e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër, keni diçka për të shtuar? Ministri Yagcilar.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

Edhe njëherë, përshëndetje. Ligji do të ketë ndikim pozitiv në shumë sfera. Unë dëshiroj edhe njëherë të ritheksoj, sepse është një fushë shumë komplekse. Shfrytëzuesit e spektrit elektromagnetik, të cilët merren me distribuimin e radiove dhe televizioneve, të programeve operatore të telefonisë mobile dhe bartësit e sistemeve distribuese të kabllave pa tela, shfrytëzuesit dhe operuesit me burimet e rrezatimit jonizues, menaxhimin e mbeturinave radioaktive edhe shumë çështje tjera. Kështu që nga aspekti i fushës së rëndësisë, nuk dëshiroj edhe njëherë ta ritheksoj.

Sa i përket Ligjit për mbeturina, dihet se importi dhe transporti ose transiti nga Kosova vetëm përmes vendimit të Qeverisë së Kosovës mund të bëhet diçka e tillë me mbeturinat radioaktive, por gjithashtu në Kosovë në këtë moment ekzistojnë edhe me probleme me çështjet radioaktive për të cilat duhet ta bëjmë një zgjidhje të përkohshme. Mbeturinat janë edhe prej çështjeve të cilat i kam cekur.

S i përket kostonë së shpenzimeve, vërtet për realizimin e këtij Projektligji do të nevojitet kostoja shtesë, të cilën ne mendojmë dhe dëshirojmë ta përballojmë përmes donacioneve. Sigurisht, ne për vitin 2009 do të planifikojmë edhe për implementimin e ligjit, sepse kostoja e shpenzimeve gjithashtu edhe të hyrave, që ishte paraqitur në formularin për vlerësimin e ndikimit financiar dhe kryesisht qëndron në sigurimin e aparaturës për matjen e rrezatimit jojonizues dhe jonizues, pastaj pajisja me laboratore për matjen e rrezatimit, pajisjen e punëtorëve me rroba përkatëse si dhe ndërtimin e deponive për deponim të përkohshëm të materieve radioaktive. Këto deponi mendohet të ndërtohen me ndihmën e donacioneve të ndryshme, të cilat do t'i sigurojë Qeveria e Kosovës.

Sa u përket të hyrave, parashihen licencat që do të kërkohen nga personat juridikë dhe fizikë për ushtrimin e veprimtarisë me burimet e rrezatimit, i cili sigurisht do të jetë në një përqindje më të ulët se sa ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti Gjini, jeni paraqitur por mendoj që gjatë procedimit ose shqyrtimit përmes amendamenteve mund t'i jepni vërejtjet e juaja. Okej, unë nuk kam asgjë kundër, merre fjalën edhe njëherë. Zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sinqerisht ju falënderoj që ma dhatë fjalën edhe njëherë. Nuk është në procedura kësisoj e paraparë. Mirëpo, mendoj se kur flasim për ligjet ndonjëherë vendosin precedent që edhe të debatohet, i ndihmojmë vetvetes, i ndihmojmë vendit.

Kjo çka dua të them tani është kjo. Ministri tregoi se është i paraparë importi, transporti, e tjera, e tjera, i mbeturinave të rrezikshme në Kosovë. Unë e di atë çështje, e di që është e paraparë. Kjo është ekzakt pyetja ime. Nëse një ligj e parasheh transportin, deponimin, e tjera, e tjera, ndërsa një ligj tjetër që vjen dy vite më vonë e parasheh edhe deponimin e materieve të rrezikshme, kur e kemi një bashkëdyzim interesant këtu dhe mendoj se po e kuptoni edhe ju, e kjo ka qenë dashur të thuhet në fillim dhe ta shoh Kuvendi se çka do të bëjë në shqyrtimin e dytë, ekzakt me këto pika.

Dhe, e dyta, ju thatë se varet prej Ministrisë, unë besoj se ju jeni njeri i mirë dhe nuk do të jepni licencë të tillë, mirëpo ne nuk guxojmë të bëjmë ligje dhe të shpresojmë se gjithë njerëzit në pushtet do të jenë njerëz të mirë. Ne duhet t'i bëjmë ligjet edhe për rastin më të keq të mundshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini!
Diskutues të tjerë nuk ka.

(Diskutim i paraqitur me shkrim, i deputetes Mimoza Ahmetaj)

MIMOZA AHMETAJ: I nderuari Kryetar,
Kabinet Qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Nevoja për harmonizimin e legjislacionit në këtë fushë me rregullativat e BE, forcimi i regjimit për sigurinë nukleare dhe radioaktive në Kosovë dhe arritja e nivelit i cili i përgjigjet rritjes së kërkesave për siguri, të cilat janë paraqitur si pasojë e ndryshimeve të mëdha në botë gjatë 10 vjetorit të fundit, janë arsye kryesore për nxjerrjen e këtij ligji. Zbatimi dhe avancimi permanent i masave me të cilat garantohet siguria nukleare dhe radioaktive janë vënë si prioritet i bashkësisë ndërkombëtare, dhe shqetësimi themelor nuk është vetëm kontrolli i armëve nukleare, dhe pengimi i përhapjes së mëtutjeshme, por para së gjithash krijimi i kushteve për parandalimin ose evitimin efikas të keqpërdorimit të materialit radioaktiv dhe nuklear.

Qëllimi i këtij ligji është vendosja e standardeve për zbatimin e masave mbrojtëse nga rrezatimi jonizues, siguria nukleare dhe radioaktive, krijimi i kompleksit rregullativ, si dhe krijimi i mundësive për zbatim efikas të ligjit, vendosja e kontrollit strikt dhe gjithëpërfshirës mbi burimet e rrezatimit jonizues dhe objekteve nukleare, veprimtarive radioaktive dhe aktivitetëve nukleare, si dhe në menaxhimin me mbeturinave radioaktive.

Gjithashtu, domosdoshmëri e kohës ka qenë të definohet baza ligjore për krijimin e kapaciteteve administrative të domosdoshme për zbatimin e këtij ligji, dhe mbikëqyrja efektive e masave që përshkruhen në këtë ligj, e që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, garantimin e sigurisë nukleare dhe radioaktive, menaxhimin e sigurt me mbeturinat radioaktive dhe siguria në transportin (bartjen) e materialeve nukleare dhe të materialeve të tjera radioaktive.

Kapacitetet administrative që duhet të ndërtohen sipas këtij ligji, për të kryer zbatimin dhe mbikëqyrjen e tij, po ashtu janë në pajtueshmëri me rekomandimet e bashkësisë ndërkombëtare, me qëllim të lehtësimit të komunikimit dhe të koordinimit të aktivitetëve me shtetet tjera dhe organizatat tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

Për shkak të rëndësisë strategjike dhe kompleksitetit të fushës që e rregullon ligji për mbrojtje nga rrezatimi jonizues dhe siguria nukleare, përpilimi i këtij ligji është bazuar në principet themelore specifike të adaptuara ndërkombëtare, siç janë Agjensioni Ndërkombëtar për Energji Atomike (ANEA) , Agjensioni për Energji Nukleare dhe Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (AEN-OBEZH) , Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtje nga Rrezatimi Jonizues, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Organizata Botërore e Punës (OBP), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), etj.

Normativat që aplikohen në vendet anëtare të ANEA dhe në të cilat është bazuar ky projektligj janë:

- Normativa për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave profesionalë të ekspozuar, pacientëve, qytetareve dhe mbrojtja e mjedisit nga efekti i dëmshëm i rrezatimit jonizues. Në këtë ligj janë hartuar masat e domosdoshme të cilat janë

paraqitur në rekomandimet për arritjen e tyre nga (ANEA) të cilat përmbajnë udhëzime detale për vlerësimin e nivelit të ekspozimit të brendshëm, vlerësimi i nivelit të ekspozimit nga burimet e jashtme të rrezatimit jonizues dhe rekomandimet për avancimin e mbrojtjes dhe siguria gjatë përdorimit të burimeve të rrezatimit.

- Masat të cilat duhet të zbatohen gjatë shfrytëzimit, rekonstruktimeve dhe modifikimeve të reaktorëve hulumtues, forma dhe përmbajtja e raportit për sigurinë nukleare, përzgjedhja e lokacionit për objektet nukleare, si dhe standardet e sigurisë dhe rekomandimet.
- Direktivat për menaxhim me mbeturina radioaktive, si dhe rekomandimet për klasifikimin e mbeturinave radioaktive, dekomisionimi i objekteve nukleare, kontrolli dhe misionet e rrezatimit në mjedis.
- Direktiva për transport të sigurt të materialeve radioaktive.
- Direktiva për gatishmërinë e veprimit në raste të situatave të jashtëzakonshme.
- Direktiva për vendosjen e kornizës ligjore dhe të kapaciteteve administrative të cilat janë të nevojshme për rregullimin ligjor dhe mbikëqyrjen e ligjit për garantim të sigurisë nukleare dhe radioaktive.
- Rekomandimi për formatin dhe përmbajtjen e dokumentacionit që shfrytëzohet në objektet nukleare dhe burimet e rrezatimit jonizues.
- Direktiva për vendosjen dhe zbatimin e programit të sigurisë dhe të kontrollit të kualitetit në të gjitha aktivitetet nukleare dhe radioaktive dhe zbatimin e masave për mbrojtje nga rrezatimi jonizues.
- Ligji është në përputhje edhe me rregullativat e BE në këtë fushë, si: Direktiva 96/29 për normat themelore të sigurisë si dhe direktiva 97/43 për përdorimin në mjekësi.

Me këtë ligj gjithashtu do të formohet dhe të mirëmbahet regjistri qendror për personat profesionalë të ekspozuar, burimet e rrezatimit jonizues dhe materialit radioaktiv me çka shumë do të avancohet sistemi i sigurisë për masat mbrojtëse nga rrezatimi jonizues të qytetareve në përgjithësi dhe të mjedisit.

Hartimi i planit për veprim në rast të aksidenteve është po ashtu masë shumë e rëndësishme për zvogëlimin e rrezikut për qytetaret dhe mjedisin në rast të aksidenteve nukleare.

Prandaj, unë personalisht e përkrah këtë projektligj dhe dëshiroj që sa më shpejt të implementohet dhe e përgëzoj sponzoruesin, MMPH dhe Sektorin për Mbrojtjen e Ajrit për punën e bërë në përpilimin e këtij projektligji.
Faleminderit!

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Në vazhdim, kërkohet deklarimi ynë për votim në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 3 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet në parim Projektligji për mbrojtje nga rrezatimi jonizues, jonizues dhe siguri nukleare.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione:

1. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional,

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
4. Komisioni për Komunitete, dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet, brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, duhet Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ngrohje qendrore

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për ngrohje qendrore dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, zonjën Myzejene Selmani, apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve të prezantojë raportin.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritarë,

Përshëndetje për gjithë deputetët që janë sot në seancë,

Ky Ligj është hartuar nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, të cilin Komisioni me datën 6.09.2005 ia ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës, për miratim.

Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për ngrohje me datën 03.10.2008, i cili sipas procedurës i është proceduar për shpallje Zyrës ligjore të PSSP-së. Zyra ligjore e PSSP-së pa arsye nuk ka dhënë sqarime, ligjin nuk e ka shpallur, por më 20 shkurt të vitit 2008 e ka kthyer me vërejtje se ligji duhet të harmonizohet sipas disa vërejtjeve konkrete të evidentuara. Komisioni i ka shqyrtuar vërejtjet dhe i ka miratuar në tërësi, të cilat me raportin e datës 11.03.2008 ia ka proceduar sipas procedurës Kryesisë së Kuvendit, për procedim të mëtutjeshëm.

Kryesia e Kuvendit, me datën 24.06.2008 ia ka kthyer komisionit funksional Ligjin për ngrohje me rekomandim që ligji të harmonizohet me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion më 08.07.2008 e ka shqyrtuar ligjin dhe ka harmonizuar me dispozitat kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe e ka proceduar për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Kërkojmë që sot të miratohet ky Ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Për fjalë është paraqitur Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Konsideroj se duhet të mbesin në ligj dhe po e arsyetoj për arsye se në ligj, pa amendamentimin e komisionit, thuhet se “me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe standardet për kryerjen e aktivitetit të prodhimit, të distribuimit dhe të furnizimit me energji termike”. Komisioni e ka zëvendësuar me “ngrohje”, nuk mund të prodhohet ngrohja, prodhohet energjia termike, por jo ngrohja. Prandaj, mendoj se duhet të mbetet si ka qenë më parë në ligj. Nuk mund të prodhohet ngrohja, prodhohet energjia.

KRYESUESI: Zonja Selamani e ka fjalën, për sqarim shtesë.

MYZEJENE SELAMANI: Me gjithë kuptimin për zonjën deputete, këtu e ka pasur anëtarin e Partisë së vet në komisionin funksional. Vërejtja ka ardhur se gjatë prodhimit, është një fjalë shumë e qartë që thuhet: “me distribuim, furnizim prodhohet ngrohje”, jo energji elektrike, ne nuk jemi kah lypim energji elektrike këtu, por jemi kah duam, ta zëvendësojmë me fjalën “ngrohje”, e për këtë arsye edhe PSSP-ja e ka kthyer këtë vërejtje.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, kemi një propozim shtesë. Edhe pse me rregullore nuk e kemi, ndoshta kështu do të ishte mirë që për hera të tjera mundësisht propozimet të jenë edhe me shkrim të bëra për ndryshim, që të mbetet edhe dokument i shkruar.

Atëherë, votojmë sipas propozimit, sipas Rregullores.

Votojmë së pari propozimin e amendamentit 2 dhe në qoftë se nuk i fiton votat, votojmë edhe propozimin tjetër.

Atëherë, votojmë për amendamentin 2 të komisionit funksional.

Votojmë tani. Faleminderit!

Konstatoj se me 56 vota “për”, 6 abstenime dhe 2 “kundër”, miratohet amendamenti 2 i komisionit funksional. Propozimin tani nuk ka nevojë ta qesim në votim.

Amendamenti 3.

Të paraqitur për fjalë nuk ka.

Përgatitemi për votim, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatoj se me 58 vota “për”, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 1 abstenim”, miratohet amendamenti 4 i komisionit funksional.

Amendamenti 5.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Lus regjinë që ta shkurtojë kohën në 5 sekonda për votim.

Amendamenti 6.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Regjia, ju lutem, shkurtojeni kohën e votimit në 5 sekonda.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani: Më falni, është paraqitur për diskutim Suzan Novobrdaliu.

U krye votimi tash.

Konstatohet se me 62 vota “për” asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 51 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 18.

Atëherë, konstatoj se të gjitha amendamentet u votuan. Tani votojmë tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tani:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet Ligji për ngrohjen qendrore.

Vazhdojmë me pikën pestë:

- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentet e Ligjit për procedurën jokontestimore

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka shqyrtuar tekstin e Ligjit për procedurë jokontestimore dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara, për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, zotin Bahri Hyseni që para deputetëve të prezantojë raportin.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, në cilësi të komisionit funksional, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Kosovës të datës 30 korrik 2008, ka shqyrtuar Projektligjin për procedurën jokontestimore, Projektligj i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga Zyra e PSSP-së. Komisioni, pas shqyrtimit ka konstatuar se nuk ka asnjë vërejtje konkrete nga Zyra e PSSP-së dhe i propozon Kuvendit të Kosovës vetëm 2 amendamente me qëllim të harmonizimit të preambulës dhe të dispozitave të hyrjes në fuqi. Prandaj, i rekomandojmë Kuvendit që ta aprovojë Projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Tani votojmë për tekstin e Ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për procedurën jokontestimore.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës që është:

- Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për Avokatinë

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për Avokatinë dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim. Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion, zotin Bahri Hyseni, që para deputetëve të prezantojë raportin.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në cilësinë e komisionit funksional, duke u bazuar edhe në vendimin e Kuvendit të Kosovës për riprocedimin e ligjeve të pashpallura nga Zyra e PSSP-së, me kohë ka formuar një nënkomision për të shqyrtuar Projektligjin për Avokatinë. Në këtë nënkomision kemi ftuar edhe përfaqësuesit e Odës së avokatëve në Kosovë, të cilët kanë dhënë propozimet e tyre për Projektligjin në fjalë. Në bashkëpunim me anëtarët e nënkomisionit, që kanë qenë anëtarë që janë përfaqësuar nga të gjitha grupet parlamentare, kemi arritur në përfundim se ky Projektligj ka qenë e domosdoshme të amendamentohet dhe si Komision për Legjislacion dhe Gjyqësi kemi paraparë që të ketë diku 22 amendamente, duke futur në brendi edhe çështjen e harmonizimit të Projektligjit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë që ka Projektligji në fjalë, i rekomandojmë Kuvendit të Kosovës që ta aprovojë Projektligjin dhe amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i Komisionit!

Konstatoj që ne nuk kemi kuorum, apo u kthyen. Unë, nuk po i kuptoj, vërtet jemi në votim dhe s’ka nevojë askush të dalë në asnjë komision, kemi seancë, realisht. Në qoftë se është në pyetje mëditja që duhet marrë në Komision, le ta shtyjnë më vonë. Okej. Atëherë, marrim 5 minuta pauzë dhe lus sekretarinë që ta ndërpresin mbledhjen e komisionit, që të kthehen në seancë. Nuk mund të votojmë, s’kemi kuorum. S’kemi kuorum, unë nuk mund të votoj vetë. Pritni, kush do të pres, le të pret. Kush do të pijë cigare, le të pijë cigare.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë,

Konstatoj se kuorum kemi për të vazhduar seancën. Ju lus që t’i zëni vendet e juaja për t’u bërë gati për votim.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet që në sallë janë 69 deputetë prezentë.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Regjia, votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Regjia, votojmë tani:

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3, gjithnjë duke llogaritur plus 2 vota që nuk kanë kartelë që janë deklaruar për miratimin e amendamenteve.

Vazhdojmë me amendamentin 4.

Regjia, votojmë tani:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, votohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 2 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet edhe amendamenti i fundit 23.

Konstatohet që të gjitha amendamentet janë votuar dhe tani votojmë tekstin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, gjithnjë duke ju referuar votës së zotit Ibrahim Gashi dhe zotit Bajram Kosumi, që nuk i kanë kartelat, 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet Ligji për Avokatinë. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor

Konstatime hyrëse: Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për inspeksion bujqësor dhe Kuvendi i kanë parashtruar rekomandimet e tyre. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji ka baza juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për inspeksionin bujqësor dhe Kuvendi i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me funksionimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme për ta arsyetuar raportin me rekomandimin. Nuk është paraqitur.

Në vazhdim, procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve sipas radhitjes së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Regjia, fillojmë votimin!

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Tani votojmë tekstin e Ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi sot miratoi Ligjin për inspeksionin bujqësor. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të akreditim

Konstatime hyrëse: Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji ka baza juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë parimet e përgjithshme...

Komisioni Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Transport, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme për ta arsyetuar raportin me rekomandimin. Nuk e kërkon fjalën.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim, procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve sipas radhitjes së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Atëherë, vazhdojmë, regjia dhe deputetët bëhuni gati për votim.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Dhe, konstatohet që u miratuan të gjitha amendamentet për Ligjin.

Tani vazhdojmë me votimin e Ligjit në tërësi, me amendamente të miratuara.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi sot miratoi Ligjin për akreditim. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës dhe debati për gjendjen në Trustin Pensional**

A po vazhdojmë me këtë a doni të shkojmë në pauzë të drekës. Vazhdojmë, okej.

Para se të procedojmë me emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2008, me kërkesë të 2 grupeve të deputetëve ka kërkuar nga Qeveria që të përgatit një informatë lidhur me gjendjen në Trustin Pensional të Kosovës.

Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor 2008, ka ripërsëritur kërkesën dhe ka kërkuar nga Kryeministri që për seancën e sotme plenare të përgatit informatën për deputetët e Kuvendit.

Lus zëvendëskryeministrin, nëse ka diçka për të thënë lidhur me këtë, zotin Kuçi, sepse nuk kemi ndonjë informatë me shkrim.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për aq sa di unë, besoj se Kryesia e Kuvendit, respektivisht Kabineti i Kryetarit ka një marrëveshje me guvernatorin apo udhëheqësin e Bankës Qendrore, që ai të vijë dhe ta prezantojë para Kuvendit çështjen e Trustit.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, sipas kësaj del që ne do ta shtyjmë për javën e ardhshme edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Ju lus që të miratohet propozimi i Qeverisë me një votim formal.

A jeni “për”? Faleminderit!

Mbështetet propozimi i Qeverisë që debati të shtyhet, sipas propozimit në fjalë, për javën e ardhshme të seancës së re.

Tani unë mendoj që të shtyhet edhe votimi, apo të gjitha përnjëherë shtyhen. Okej.

Vazhdojmë me pikën dhjetë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për raportin e Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L74 për revizionin e brendshëm**

Vërejtjet hyrëse: Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin e Grupit të punës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm dhe ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet në seancë plenare.

Raporti i Grupit të punës dhe rekomandimet e Komisionit iu janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj Kryetarin e komisionit funksional, zotin Gani Koci, për ta arsyetuar raportin.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne edhe nga mbledhja e kaluar e fillimit, që u shty nja dy herë ky raport, arsyet nuk dua t'i përmend. Si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, ashtu siç e thatë edhe ju, kemi caktuar një grup të punës rreth mbikëqyrjes së implementimit të Ligjit të auditimit të brendshëm. Grupi i punës ka qenë i përbërë prej Armend Zemajt, edhe si raportues do të jetë i këtij grupi, Safete Hadrxhonaj, Xhevdet Neziraj dhe Besa Gaxherri.

Prandaj, në emër të Komisionit dhe në emër të punës së këtij raporti, unë do t'i kisha dhënë fjalën zotit Armend Zemaj, edhe pse tani momentalisht nuk është anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, por ka qenë pjesë e punës.

Unë dua të shtroj edhe një çështje tjetër këtu. Dy herë është shtyrë ky raport, arsyeja ka qenë pikërisht mosprezenca e ministrit të Ekonomisë dhe Financave. Por, ne sot, në bisedë me ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, që është në udhëtim zyrtar, kërkuam së paku bile të jetë dikush nga Qeveria dhe në këtë rast kemi edhe zëvendëskryeministrin, kemi edhe ministra të tjerë, andaj konsideroj që ne mund ta diskutojmë sot këtë raport, i cili është përgatitur. Çdo shtyrje e mëvonshme mendoj që është e tepërt dhe e panevojshme që diskutohet.

Prandaj fjalën ia jepni Armend Zemës, ju lutem, nëse ka mundësi!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, e keni fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministër, ministra,

Unë desha t'ia rikujtoj edhe kryetarit të Komisionit, edhe atyre që herën e kaluar kanë kërkuar që ta shtyjmë për hir të konstruktivitetit dhe të punës që e kemi pasur në këtë grup punues. Le ta lexojnë kapitullin IV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 65, pika 9, Kuvendi mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve, i raportojnë Kuvendit. Qeveria është ajo që i raporton Kuvendit, e jo Kuvendi t'i raportojë Qeverisë. Kjo është arsyeja pse s'kemi nevojë ta shtyjmë. Nëse dikush ka dëshirë, Ministria e Financave është këtu afër, kati 11, është ministri i Financave, shkoni i raportoni. Ne sot do ta lexojmë dhe nuk është arsye që të shtyhen raportet e monitorimit.

Të nderuar deputetë,

Në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe duke u bazuar në Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e datës 5 qershor 2008, vendosi të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për auditimin e brendshëm. Komisioni formoi Grupin punues, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë është marrë me mbikëqyrjen e Ligjit mbi auditorin e brendshëm.

Komisioni ishte përbërë nga 4 anëtarë: Armend Zemaj, Safete Hadergjonaj, Xhevdet Neziraj dhe Besa Gaxherri.

Bazuar në mandatin e autorizuar nga Komisioni, Grupi punues për mbikëqyrje të zbatimit të Ligjit ka pasur autoritetin të zhvillojë aktivitete të nevojshme me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave mbi nivelin e zbatimit të Ligjit për auditimin e brendshëm dhe në fund kemi përgatitur këtë raport përmbledhës, të cilin, të nderuar deputetë, besoj që edhe ju e keni marrë me kohë për shqyrtim.

Grupi punues, bazuar në autorizimet që kishte, edhe pse me vështirësi logjistike, ka arritur me sukses të përmbyll aktivitetet të planifikuara në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për auditorin e brendshëm, në bazë të planit të veprimit, të miratuar nga Grupi punues dhe anëtarët e tjerë të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Vizitat e Grupit punues në terren u përqendruan në 3 nivele të institucioneve: institucionet lokale, institucionet qendrore dhe ndërmarrjet publike.

Në të gjitha fazat e procesit të monitorimit të ligjit, Grupi punues është mbështetur nga Instituti Demokratik Kombëtar NDI dhe stafi mbështetës i Komisionit. Me këtë rast i falënderojmë dhe shprehim respekt të veçantë për ndihmën në të gjitha fazat që kemi zhvilluar në Grupin punues.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për auditimin e brendshëm, Grupi punues ka arritur të mbledhë të dhëna të mjaftueshme mbi nivelin e zbatimit të këtij Ligji. Në bazë të të gjeturve nga vizitat në terren, Grupi punues ka vlerësuar se cili është niveli i zbatimit të ligjit, ka identifikuar problemet dhe në formë të rekomandimeve kemi propozuar masat konkrete që duhet të ndërmerren për të ndryshuar gjendjen.

Duke u bazuar edhe në faktin që Qeveria e Republikës së Kosovës, në strategjinë legjislative për vitin 2008 pati vendosur në agjendë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për auditimin e brendshëm, Komisioni për Buxhet dhe Financa synoi që përmes mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit të marrë të dhëna të mjaftueshme për problemet në zbatueshmëri, identifikimi i këtyre probleme do t'i ndihmojë Komisionit gjatë ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji.

Në bazë të vlerësimit se cili është niveli i zbatimit të Ligjit kemi identifikuar këto probleme:

1. Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit në bazë të ligjit. Gjatë punës, Grupi punues për mbikëqyrje gjatë vizitave në terren ka identifikuar si problem mosfunksionimin e Komitetit të Auditimit në bazë të ligjit. Ligji për auditimin e brendshëm, në nenin 5, paragrafi 1, parasheh krijimin e Komitetit të Auditimit në të gjitha organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet autonome publike.
2. Mungojnë planet strategjike trevjeçare. Gjatë mbikëqyrjes, Grupi punues ka identifikuar si problem mungesën e planit strategjik trevjeçar. Ligji për auditimin e brendshëm, neni 5, paragrafi 2, obligon njësi të auditimit të brendshëm dhe auditorë të brendshëm që të përgatisin një plan trevjeçar strategjik, i cili duhet t'i dorëzohet Komitetit të Auditimit për shqyrtim dhe miratim.
3. Afatizimi i kontratave të punës auditorëve për periudhat e shkurta paraqet pengesë në kryerjen e punëve.
4. Nuk merren parasysh rekomandimet e propozuara nga auditorët e brendshëm. Ligji për auditimin e brendshëm, neni 5, pika 4a) dhe neni 14, pika b), obligon komitetet e auditimit ose Zyrën e Komitetit të Auditimit që ta autorizojë menaxhmentin kryesor të ndërmarrë masa në përputhje me rekomandimet e auditimit.
5. Mungon pavarësia auditorëve të brendshëm. Pavarësia e njësive të auditimit dhe auditorit të brendshëm në kryerjen e aktiviteteve të auditimit, është njëri nga parimet bazë

të Ligjit për auditimin e brendshëm, neni 3, pika f. Bazuar në paragrafin e lartpërmendur, Grupi punues ka konstatuar se nuk ka pavarësi të mjaftueshme të auditorëve në kryerjen e aktiviteteve të auditimit. Ky konstatim bazohet në të gjeturat në vizitat në terren. Në ato organizata buxhetore që nuk ka komitete të auditivit, për shembull, ministritë dhe komunat, njësitë e auditimit funksionojnë si zyra në kuadër të sekretarit, që është zyrtari administrativ më i lartë në një institucion dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë i raportojnë atij. Pavarësia e auditorëve mund të shndërrohet në varësi nga institucioni i sekretarit. Mundësinë e kontrollit të auditorit nga institucioni i sekretarit e përjashton neni 5, paragrafi 1, i plotësuar edhe me Rregulloren 2007, neni 19, pika f.

6. Funksionimi i Njesisë Qendrore për Harmonizim të brendshëm. Njësia Qendrore për Harmonizim të brendshëm pas themelimit të saj është orientuar në plotësimin e infrastrukturës ligjore për auditimin e brendshëm. NJQH ka filluar punën nga 1 prilli 2008. NJQH ka një staf prej 7 punëtorëve dhe qysh në fillim të themelimit të saj ka filluar me çështjen dhe implementimit të Ligjit për auditorin e brendshëm.

7. Njësia Qendrore për Harmonizim nuk ka nxjerrë aktet nënligjore dhe rregullat e tjera të parapara me ligj. Njësia Qendrore për Harmonizim sipas nenit 6, paragrafi 4, mosnxjerrja e këtyre akteve si përgjegjësi e NJQH-së është moszbatim i Ligjit për auditorin e brendshëm. Sipas auditorëve të kontaktuar, nxjerrja e këtyre akteve do të ndihmonte në përfundimin dhe efikasitetin e punës së auditorëve të brendshëm. Zyrtarët e NJQH-së u arsyetuan për mosnxjerrjen e akteve të lartpërmendura duke thënë se kanë përgatitur 4 dokumente, mirëpo nuk mund t'i publikojnë për shkak se nuk e dinë se cilat do të jenë ndryshimet në Propozimligjin e ri për auditorin e brendshëm.

8. Mungon bashkëpunimi i NJQH-së me ndërmarrjet publike dhe anasjelltas.

9. Mungon bashkëpunimi i ndërmarrjeve autonome publike me Auditorin e përgjithshëm.

10. Mosdorëzimi i raportit vjetor të Ministrisë për Ekonomi, Financa dhe NJQH-së mbi funksionimin e auditorit të brendshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe NJQH, në bazë të Ligjit për auditimin e brendshëm, neni 7, pika b), janë të obliguara që të paraqesin një raport vjetor në formë të shkruar në Kuvend dhe tek Auditori i përgjithshëm. Raporti duhet të përmbajë të dhëna mbi funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm dhe zbatimin e ligjit.

11. Auditorët të brendshëm nuk kanë kushte të mjaftueshme për punë. Nga vëzhgimet e bërë në terren dhe bisedat me auditorët e brendshëm, Grupi punues ka konstatuar se auditorët e brendshëm përballen me kushte jo të mira të Prishtinës. Mund të shihni paragrafin shtesë, Komuna e Prishtinës, në çfarë gjendje e kemi gjetur Auditorin e brendshëm.

12. Vështirësitë e Auditorit të brendshëm në qasjen në dokumentet zyrtare. Neni 9, paragrafi 7 i Ligjit për auditimin e brendshëm u garanton njësive të auditimit dhe auditorit të brendshëm qasjen në të gjitha sistemet dhe dokumentet, sipas kërkesës. Shumë auditorë kanë vështirësi në marrjen e dokumenteve të nevojshme për auditim. Kjo dukuri është shprehur më tepër në organizatat buxhetore, si komunat dhe ministritë, por edhe te ndërmarrjet autonome publike. Disa ndërmarrje, pas shumë problemeve në këtë çështje, e kanë të rregulluar me një vendim të caktuar, për shembull, KEK-u, i cili i autorizon zyrtarët t'i lejojnë auditorët të qasen në këto dokumente.

13. Në shumë organizata buxhetore nuk janë zgjedhur drejtorët e njësive të auditimit.

14. Pagesa për drejtorët e njësive të auditimit nuk bëhet në bazë të ligjit.

15. Konflikti i interesit. Grupi punues ka identifikuar si problem në zbatimin e Ligjit për auditorin e brendshëm edhe konfliktin e interesit. Nga të dhënat e analizuara, konflikti i interesit është identifikuar tek auditorët e brendshëm në raport me përgjegjësitë që kanë dhe tek anëtarët e komiteteve të auditimit. Disa auditorë të brendshëm, në të njëjta organizata buxhetore, ministri dhe komuna kanë kryer punët e auditorit dhe punë të tjera, që do të thotë se ka konflikt interesi. Grupi punues ka konstatuar se ka konflikt interesi dhe me këtë rast nuk janë zbatuar neni 12, paragrafi 3 dhe neni 16 i Ligjit për auditorin e brendshëm.

16. Rasti i ish i auditorëve të brendshëm në KEK, të suspenduar, dhe

17. Ligji për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 mbizotëron Ligjin për auditimin e brendshëm në raport me ndërmarrjet publike.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet publike, neni 38, pika 2 nr. 03/087, Ligji për auditimin e brendshëm nuk është i zbatueshëm për ndërmarrjet publike.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë për bazë problemet e identifikuara, Grupi punues konkludon se Ligji për auditimin e brendshëm ka pengesa të mëdha të zbatim, për çka duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshimin e gjendjes. Prandaj, me qëllim të ndryshimit dhe të përmirësimit të gjendjes aktuale, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji, Grupi punues propozon këto rekomandime, të cilat janë mbështetur edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa

REKOMANDIMET

- Qeveria, përkatësisht Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet që në afatin sa më të shkurtër të ndërmarrë masa të nevojshme për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit dhe të komiteteve të auditimit nëpër të gjitha organizatat buxhetore, neni 5, pika 1 dhe neni 9, pika 1.

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave, përkatësisht Njësia Qendrore për Harmonizim duhet të ketë bashkëpunim me të gjitha organizatat buxhetore.

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe NJQH të ndikojë tek organizatat buxhetore që rekomandimet e Auditorit të brendshëm të merren parasysh dhe të implementohen. Qeveria, përkatësisht Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë e auditorëve, në përputhje me Ligjin për auditimin e brendshëm.

- Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe NJQH duhet të nxjerrin në afatin sa më të shkurtër aktet nënligjore dhe rregulla të tjera në përputhje me Ligjin për auditimin e brendshëm, neni 6, pika 4.

- Ministria për Ekonomi dhe Financa, përkatësisht Njësia Qendrore për Harmonizim duhet të ndërmarrë masat e nevojshme që organizatat buxhetore të përmirësojnë kushtet e punës së Auditorit të brendshëm.

- Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të ndërmarrë masat e nevojshme që organizatat buxhetore t'u lejojnë auditorëve të brendshëm qasjet e pakufizuara në dokumentet zyrtare.

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të ndikojë te organizatat buxhetore që të zgjidhen drejtorët e njësive të auditimit të brendshëm në bazë të ligjit. Gjithashtu, Ministria duhet të sigurohet që pagesa e drejtorëve në njësitë e auditimit të bëhet në bazë të ligjit.

- Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të penguar dhe larguar konfliktin e interesit tek auditorët e brendshëm dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit.

- Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në afatin sa më të shkurtër duhet të paraqesë në Kuvend Raportin vjetor mbi funksionimin e auditimit të brendshëm. Qeveria duhet të ndërmarrë masa në zbatimin e Ligjit për auditimin e brendshëm brenda njësive të veta, e sidomos nëpër ministri. Të krijohen raporte bashkëvepruese në mes të Njesisë Qendrore për Harmonizim me Auditorin e përgjithshëm.

Dhe, një rekomandim shtesë.

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet t'i raportojë Komisionit për Buxhet dhe Financa për nivelin e zbatimit, të ligjeve së paku një herë në vit. Kjo përgjegjësi e Ministrisë buron nga rregulla 53, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Kuvendit. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas renditjes, për t'u shprehur lidhur me raportin, fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Buja.

RAMË BUJA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, pasi i ka shqyrtuar këto rekomandime, i kemi realizuar dhe u japim përkrahje.

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, s'ka diçka.

Në emër të AKR-së, nuk është paraqitur askush.

Paraqituni, ju lutem, paraqituni kush ka për të diskutuar! Në emër të AKR-së, deputetja Selmani.

MYZEJENE SELAMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

I gjithë raporti është analizuar nga Grupi Parlamentar i AKR-së dhe shihet mjaft mirë se ekzekutivi duhet të ketë kujdes gjatë implementimeve të ligjeve. Raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa, përfshirë në përgjithësi, është mjaft mirë i punuar, por problemi më i madh qëndron se nuk kemi harmonizim të ligjeve, ku zotëri Armendi e ceku mjaft mirë se Ligji për auditim të brendshëm, me miratimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, ky ligj bie, që do të thotë se duhet të ketë kujdes Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si sponzorizues i ligjeve, apo Qeveria, që të kemi harmonizim mes ligjeve. Në mungesë të ekspertëve brenda Kuvendit, si organ më i lartë brenda një shteti, duhet të kemi ekspertë që të bëjmë harmonizim të ligjeve, që do të thotë se Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë kisha për të shtuar edhe diçka në fjalën e parafolësës. Grupi Parlamentar i AAK-së mbështet rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, por propozojmë që Ministria për Ekonomi dhe Financa në rekomandimet që miratohen në këtë Kuvend, pra që miratohen tani, të ketë afat se kur të raportojë për mënjanimin e këtyre defekteve, mangësive që janë identifikuar nga Grupi punues. Pra, të mos mbetet në afatin sa më të shkurtër, por të jepet një afat edhe për arsye, zoti kryesues dhe deputetë, se shpeshherë kur miratojmë rekomandime, ato pastaj nuk përcillen dhe nuk kemi raportime kthyesë nga dikasteret të cilat i marrim këto vërejtje dhe nuk e dimë se ato rekomandime a janë marrë parasysh a jo.

Pra, Grupi Parlamentar i AAK-së propozon që rekomandim shtesë të miratohet edhe afati kur Ministria për Ekonomi dhe Financa do t'i raportojë Kuvendit për mënjanimin e këtyre defekteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë edhe jam si pjesë përbërëse e këtij Komisioni që kemi bërë monitorimin e këtij ligji dhe vërtet edhe sot jam shumë e zhgënjyer ose nuk pajtohem që nuk është sot ministri prezent kur raportohet për mosfunksionimin e ligjit në Kosovë dhe, natyrisht, jepen vërejtje konkrete dhe rekomandime, por si duket, kjo Qeveri, përveç mënyrës deklarative që thotë çdo ditë, sundimi i ligjit në Kosovë ose respektimi i ligjit ose thotë, luftimi i korrupsionit, ndërsa kjo është vetëm në mënyrë deklarative. Ky raport tregon shumë qartë sa funksionon ligji në Kosovë. Bile, pikërisht, kur është fjala te korrupsioni, ne sot po raportojmë para Kuvendit të Kosovës, ky Komision, për Ligjin për auditimin e brendshëm, i cili ligj pretendon të bëjë mbikëqyrjen apo kontrollin e menaxhimit të parasë publike dhe, natyrisht, ky Ligj nuk implementohet në Kosovë.

Unë nuk dua të marrë shumë kohë, sepse kryesuesi i këtij grupi punues i tha në tërësi apo në përgjithësi vërejtjet, por nuk është e tepërt edhe njëherë edhe për qytetarët e Kosovës dhe për kolegët deputetë t'i identifikojmë problemet kryesore, siç është do me thanë, për këtë ligj, mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit në baza të ligjit. Duhet ta kemi parasysh çka do të thotë. Mungojnë planet strategjike trevjeçare, që janë të theksuara me ligj shumë mirë. Asnjë ndërmarrje buxhetore nuk bën afatizimin e kontratave të punës së auditorëve për periudhë të caktuar. Periudhat e shkurta paraqesin pengesa në kryerjen e punëve. Natyrisht, nuk merrem parasysh rekomandimet e propozuara nga auditorët e brendshëm, bile këta auditorë të brendshëm nëpër shumë organizata buxhetore shikohen si një trup që e bën pengesë, sepse dihet çfarë roli duhet të luaj auditori i brendshëm. Mungon pavarësia e auditorit të brendshëm, mungon sepse nuk ka përkrahje nga Njësia Qendrore Harmonizuese, e cila është në kuadër të Ministrisë së Financave, do me thënë këto as nuk bashkëpunojnë, kurse kjo Njësi Qendrore Harmonizuese nuk funksionon gati fare.

Njësia Qendrore Harmonizuese nuk ka nxjerrë aktet nënligjore dhe rregullat e tjera të parapara me ligj. Ende mungon bashkëpunimi i Njesisë Qendrore Harmonizuese me ndërmarrjet publike dhe anasjelltas. Tash, me aprovimin e Ligjit për ndërmarrjet publike

këtu ka edhe ndërhyrje të ligjit në ligj, do me thënë duhet të ndërmerret urgjentisht, të rregullohen këto ose të amendamentohen këto ligje. Mungon bashkëpunimi i ndërmarrjeve autonome publike me auditorin e brendshëm. Mosdorëzimi i raportit vjetor, s'ka dorëzim të raportit vjetor në Ministrinë e Financave nga Njësia Qendrore Harmonizuese. Auditorët e brendshëm nuk kanë kushte të mjaftueshme për punë, ende edhe pas 2 – 3 vjetëve të këtij ligji që është në funksion, ata s'kanë as kushte elementare. Ne kemi qenë në vend të ngjarjes dhe vërtet është për t'u shqetësuar se në çfarë kushtesh punojnë këta auditorë. Vështirësitë e auditorëve të brendshëm në qasjen në dokumentacionin zyrtarë, merreni me mend, ju lutem, çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë me Ligjin për qasjen në dokumentacion zyrtarë, ndërsa auditori që, s'po e përsërisë çfarë roli ka, ai ka pengesa në qasjen në dokumentacionin zyrtar. Ta keni tash parasysh sa ka pengesë vetë opozita në dokumentacionin zyrtar në përgjithësi.

Dhe, në 13 a më shumë organizata buxhetore, nuk janë zgjedhur drejtorët e njësive të auditimit të brendshëm, hala, nuk janë zgjedhur as drejtorët. Pagesa për drejtorët e njësive të auditimit nuk bëhet në baza të ligjit. Konflikt i interesave, dihet. Kolegë të nderuar, mos t'ju marrë kohë shumë, konkluzionet, ju lutem, kjo nuk është për hajgare, as për kopsht zoologjik, se bile as nuk kemi kopsht zoologjik në Kosovë, po është për ne. Ligji nuk funksionon, ligji në Kosovë nuk funksionon. I keni 13 rekomandime, po ua lexoj veç rekomandimin shtesë, sepse krejt për shkak mosseriozitetit të Qeverisë dhe të këtij Kuvendi ndodh kjo. Prandaj, ndodh, rekomandimin shtesë po ua lexoj edhe një herë.

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet t'i raportojë Komisionit për Buxhet dhe Financa në nivelin e zbatimit të ligjeve, së paku njëherë në vit. Kjo përgjegjësi e Ministrisë buron nga Rregulla 53, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.

Kolegë të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për durimin dhe vërtet koha është për të vepruar, mos të kthehen gjërat në shaka, sepse në Kosovë nuk ka sundim të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në qoftë se vërtet ka çështje të tilla, është mirë që të thuhet me emra, mos të përgjithësohen. Mirë është që të debatohet çdo rast veç e veç edhe këtu, s'ka ndonjë problem.

Në emër të Grupit “7+” është paraqitur deputeti Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë për bazë rekomandimet e Grupit punues, me gjithë përkrahjen e Komisionit, Grupi Parlamentar “7+” e përkrah, por për implementimin e këtij ligji, me të vërtetë dëshirojmë nga Qeveria apo Ministria të zbatojë vërejtjet dhe rekomandimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të SLS-së është paraqitur deputetja Nikoliq.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa SLS podržava izveštaj Radne grupe sa preporukom da se to što pre prenese u delo sa dobrovid građana Kosova.

KRYESUESI: Faleminderit!

Konstatohet që në emër të grupeve parlamentare u prononcuan të gjithë.

Tani fillojmë debatin në emër të deputetëve. Zoti Riza Smaka është paraqitur për fjalë.

RIZA SMAKA: Respekt, zoti kryesues!

Qeveritarë dhe deputetë të nderuar,

Në çdo shtet modern, dy punë janë më të rëndësishme. Një, bërja e ligjeve të mira, që do të duhej t'i bënim ne si legjislativ, dhe dy, ekzekutivi që t'i përmbaronte, t'i ekzekutonte, t'i implementonte ato sa dhe si duhet.

Nga ky raport del se këtu kemi defekte, sidomos në ekzekutivin. Në këtë kontekst, unë do ta kisha mbështetur plotësisht Komisionin për Buxhet dhe Financa, si një komision funksional serioz dhe raportimin e Grupit punues, por do të isha angazhuar që të bëhen disa precizime, qoftë në shprehje, qoftë në afate, siç e tha me vend zotëri Maloku.

Këtu konkludohet pa mëdyshje se ka probleme serioze sa i përket zbatimit të Ligjit për auditivin, që do të thotë nuk aplikohet ligji, e kjo çështje tepër serioze. Ose, nuk funksionojnë komitetet e auditivit, do të thotë se nuk ka auditim, s'ka kontroll që është aq i nevojshëm, aq i dobishëm, aq i domosdoshëm, edhe pse ka aq shumë konsekenca të cilat për çdo ditë shihen. Ose, mungojnë planet strategjike, kur s'ka plan, ose nuk janë miratuar aktet nënligjore, atëherë del se është e pamundur që të bëhet ky aktivitet aq i dobishëm dhe aq i nevojshëm.

Do të isha angazhuar që të hiqen këto shprehje në konkluzione, po e zëmë, se ka këtu shumë çka, po shkurtimisht, kur thuhet, bie fjala, në afatin sa më të shkurtër. Ju lutem, kjo është një shprehje freksibile që jep mundësi për t'u interpretuar kështu edhe ashtu dhe për të kaluar pa asnjë sanksion. Prandaj, këtu duhet të precizohet dhe definoen afatet.

Ose, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të njohë, të ndikojë. Të ndikojë, kjo është më tepër, si të them, shprehje voluntariste, që nuk obligon askënd, e nevoja është për të obliguar, se Komisioni parlamentar ka pushtet dhe ka autoritet për të caktuar detyra dhe për t'i definuar mirë edhe afatet, për të kërkuar përgjigje dhe raporte kthyesë dhe për të përcaktuar edhe masa.

Bie fjala, "Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në afatin sa më të shkurtër". Cili është ai afat sa më i shkurtër? Këtu mund të interpretohet edhe afati njëvjeçar, fundi i fundit.

Ose, konkluzioni i fundit, po e zëmë, rekomandimi i fundit, ku thotë: "Edhe pse Qeveria në strategjinë e saj legjislative ka paraparë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për auditivin, ajo ka përgjegjësi të zbatojë ligjin deri në miratimin e ligjit të ri". Kjo është çështje e njohur, se ligji i cili është në fuqi, obligon përderisa nuk zëvendësohet në ligjin tjetër, i cili do të hynte në fuqi. Prandaj, do të duhej të gdhendeshin këto dhe të precizoheshin dhe medoemos do të duheshin afatet edhe raportet kthyesë që të vlerësoheshin nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Koci!

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Thuhet se përsëritja është nëna e mësimi dhe, në qoftë se përsërisim ndonjëherë, atëherë përsërisim që të mësojmë diçka prej asaj përsëritje. Dhe, vërtet, ndoshta të gjithë jemi të përsëritshëm, nuk jemi origjinal këtu dhe asnjëherë as nuk kemi qenë kështu.

Unë desha të përkujtoj të gjithë zbatuesit e këtij ligji dhe anëtarët e Kuvendit dhe të Qeverisë se neni 1 i Ligjit përcakton qëllimin për çka është nxjerrë ky Ligj. Unë dua ta lexoj këtë nen, nuk do të bëhem i tepërt ndoshta. “Qëllimi i Ligjit është vendosja e një efikasiteti më të madh operacional, një disiplinë më të madhe fiskale, si dhe respektimin e rregullave nga njësitë e sektorit publik, duke kërkuar që veprimtaritë, shënimet si dhe sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit të gjitha subjekteve të sektorit publik t’i nënshtrihen auditimit të brendshëm sistematik dhe gjithëpërfshirës”. Nga raporti që dëgjuam tani këtu, del se qëllimi i këtij ligji nuk është realizuar, do të thotë synimi i këtij ligji nuk është realizuar dhe nuk është realizuar jo pse ka një ligj të keq, siç konstaton Njësia Harmonizuese, por nuk është realizuar pse Njësia e Harmonizimit është njësi shumë e keqe dhe në këtë rast përpara se do të duhej të futemi në amendamentimin e këtij ligji, do të duhej të shikojmë dhe të reformojmë këtë zyrë të Njesisë së Harmonizimit, sepse kjo është shkaku dhe pika e vetme prej të cilave derivojnë të gjitha, po them kushtimisht, të këqijat që kanë rrjedhur në të gjithë sektorët e tjerë sa u përket zyrave të auditimit të brendshëm. Që në startin e parë të themelimit të kësaj njësie, në vend që t’i rreket implementimit të ligjit, ajo ka ardhur në përfundimin e saj se ligji është i keq dhe duhet të amendamentohet, që unë mendoj se është e kundërta, se nuk kanë pas njohuri se si duhet të zbatohet ky ligj. Prandaj, është e mirë dhe gjithë ajo që del nga ky raport është që Ministria e Ekonomisë dhe Financave si përgjegjëse të shikojë me urgjencën më të madhe këtë njësi, të ndryshojë njerëzit, ta reformojë këtë njësi dhe pastaj zinxhiri shkon edhe më tutje, te të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm.

Çështja tjetër, që u potencua me të drejtë, për moszbatimin e këtij ligji është pikërisht sepse në të gjitha agjencionet buxhetore këto zyra nuk kanë vepruar në bazë të ligjit, por në mënyrë indirekte ju kanë nënshtruar funksionarëve ekzekutiv për të mos thënë, sekretarëve të përhershëm, dhe në këtë drejtim kanë qenë shumë të penguar në zbatimin dhe implementimin e këtij ligji.

Në anën tjetër, sa i përket asaj, ai konflikti që u quajt i interesit në mes të Ligjit të auditimit dhe Ligjit për ndërmarrjet publike, që e ka një pasus të veçantë për auditimin e ndërmarrjeve publike, nuk është në konflikt absolutisht, sepse mënyra e auditimit të ndërmarrjeve publike është një formë tjetër e veçantë që e përcakton Ligji i ndërmarrjeve publike, por deri më 15 qershor që ka qenë i zbatueshëm në ndërmarrjet publike. Ky ligj, nga këto ndërmarrje nuk është zbatuar fare, por më tepër janë marrë masa antiligjore ndaj njerëzve të cilët kanë qenë në këto zyra.

Vërtet, rekomandimet që dalin nga ky raport do duhej të zbatoheshin, do duhej të caktohet afati dhe unë mendoj që brenda vitit, muajit të parë të vitit të ardhshëm, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave do të duhej të dilte vërtet me një raport rreth implementimit të këtij ligji dhe funksionimit të zyrave të auditorëve të brendshëm.

Një çështje, që nuk u përmend këtu, është edhe çështja e pagave të auditorëve të brendshëm, që nuk është zbatuar në shumë agjencione buxhetore. Ligji përcakton shumë qartë se paga e auditorit të brendshëm është barazi me pagën e shefit ekzekutiv të atij agjencionit dhe këtu, shumë sekretarë të përhershëm, në emër të asaj që nuk donë të barazojnë funksionarë të tjerë edhe në pagesa me pagën e tyre, kanë qenë të dëmtuar edhe në këtë drejtim auditorët e brendshëm. Prandaj, në këtë çështje po them, është theks i veçantë se ligjin duhet ta zbatojnë të gjithë që janë të thirrur për zbatimin e tij.

Ndoshta i përsërita gjërat, por sinjerisht ligji nuk është i keq, janë të këqij ata që nuk e zbatojnë ligjin ashtu si është.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputetja Gjylnaze Syla, e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë shumë shkurt do të shtoj edhe diçka nga gjithë ajo që thanë kolegët e mi. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave nuk mund t'ia sjellë Kuvendit ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për auditimin e brendshëm për shkak se, është e qartë nga raporti, nuk ka të bëjë me atë se ligji është i keq, por pse nuk e dimë sa është i suksesshëm zbatimi i dispozitave ligjore. Prandaj, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave së pari duhet t'ia sjellë Kuvendit raportin për zbatimin e ligjit, e pastaj ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Shpresoj se do të jem shumë i shkurtër. Dua ta respektojmë punën që e ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe në veçanti ta respektojmë edhe punën e nënkomisionit. Por, mendoj që duhet të përqendrohemi pak edhe në çështjet reale dhe në rekomandimet që janë bërë.

Së pari duhet të jemi të vetëdijshëm se Njësia Qendrore e Harmonizimit është krijuar në këtë legjislaturë dhe ka një periudhë shumë të shkurtër dhe ndoshta është një arsye që nuk është bash lehtë të harmonizohet komplet infrastruktura ligjore.

x

Çështje tjetër me interes. Unë i pash të gjitha rekomandimet nga fillimi dhe deri në fund. Pati edhe diskutime në Kuvend për çështje të ndryshme, por shpresoj se duhet ta kuptojmë ku është çështja dhe çka është auditimi i brendshëm. Auditimi i brendshëm bëhet me qëllim që t'iu ndihmojë institucioneve dhe njerëzve të cilët menaxhojnë me institucionin, me buxhetin, me personelin. Prandaj, nuk e kuptoj që ka ndonjë pengesë dhe nuk shkon në interes të askujt të pengojë qasjen, qoftë në dokumentet zyrtare, qoftë në dokumentet e tjera të një organi, sepse auditimi i brendshëm e ka qëllimin të ndihmojë institucionin dhe në një mënyrë të përgatisë fushën apo rrugën për auditorin gjeneral, i cili në bazë të ligjit bën auditim vjetor.

Unë po ndalem vetëm te çështjet, për shembull, është cekur rekomandimi nr. 11, ku thuhet se auditorët nuk kanë kushte për punë. Është shumë e vërtetë, mirëpo këto kushte për punë nuk janë vetëm për auditorët, kushte për punë nuk kemi edhe ne deputetët, edhe një pjesë, andaj nuk është ndonjë shkelje e madhe e ligjit. Është çështje që institucionet e Kosovës nuk kanë mundësi të krijojnë kushte më të mira.

Vështirësitë e auditorit të brendshëm në qasjen në dokumente zyrtare. Këtu nuk është specifikuar, ndoshta ka qenë mirë të specifikohet se këtë nuk e kuptoj. Auditorët nuk mund të kenë asnjë pengesë në qasje në dokumentet zyrtare, dhe nëse ka pasur pengesë, ka qenë mirë që të shkruhet në rekomandim ku kanë qenë të penguar, në cilën ministri, në cilën komunë, sepse Ligji për qasje në dokumentet zyrtare iu lë qasje edhe njerëzve të cilët nuk janë auditorë, e lëre më auditorëve. Prandaj, ky rekomandim mendoj që nuk duhet të qëndrojë bash kështu si është i përgjithshëm. Unë, mendoj, ndoshta ka edhe pengesa, ndërmarrjet publike e kështu, mirëpo duhet të specifikohet. Në anën tjetër, këtu ka rekomandim që Ministria për Ekonomi dhe Financa t'ju mundësojë auditorëve të

gasen në dokumentet zyrtare. Auditorëve nuk iu lejon qasje apo nuk mund t'ju mundësojë Ministria për Ekonomi dhe Financa, por është Ligji për qasje në dokumente zyrtare dhe krahas ligjit ata kanë mundësi të kërkojnë çdo dokument i cili nuk konsiderohet sekret për shtetin dhe konsideroj që brenda ministrive nuk ka dokumente të tilla.

Mandej, çështja tjetër, pagesa e drejtorëve të njësive të auditimit nuk është bërë në kuadër të ligjit. Këtu duhet të kemi parasysh, ne e kuptojmë që është paraparë me ligj pagesa e drejtorëve por a është paraparë mirë, unë personalisht mendoj që jo. Pagesa e drejtorëve të departamenteve, të shefave të agjencioneve dhe të sekretarëve të përhershëm është e rregulluar me një urdhëresë apo udhëzim administrativ, të cilin janë duke e aplikuar institucionet e Kosovës. Në momentin kur është hartuar në këtë ligj, unë e di se është aprovuar në Kuvend, por është aprovuar gabimisht. Prandaj, këtu ndoshta me plotë të drejtë Njësia Qendrore Harmonizuese nuk mund të aplikojë, sepse buxheti nuk është i ndarë për atë buxhet që është planifikuar për drejtorët e departamenteve dhe ko do të bie ndesh me gjithë stafin e drejtorëve që janë brenda organizatave buxhetore. Kjo çështje shpresoj se do të rregullohet me Ligjin për pagat, që do të jetë i përgjithshëm edhe për shërbimin civil, por edhe për atë pjesën politike.

Dhe, krejt në fund, unë mendoj se duhet të përkrahen rekomandimet dhe jemi për t'i përkrahur rekomandimet, por gjithsesi mos të dalim në opinion se, do me thënë, ka shkelje shumë të mëdha apo mosimplementim shumë të madh të ligjit. Natyrisht, ka probleme rreth implementimit të ligjit, disa paragrafë janë për kushte, disa nene të ligjit janë në kundërshtim me dispozitat aktuale, si ai për rregullimin e pagave dhe, natyrisht, diku nuk ka edhe vullnet për implementim të ligjit, por të merret si çështje që në të ardhmen të përmirësohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Mendoj se Raporti i Komisionit është mjaft i hollësishëm dhe sistematik dhe mendoj që kanë arritur ta incizojnë gjendjen dhe të identifikojnë problemet nga kjo fushë.

Mendimi im është që nga ky raport del një punë konkrete për Qeverinë e Kosovës dhe atë në dy aspekte: e para, pra del me masa konkrete për të gjeturat në lëshime dhe shkelje që janë bërë në të kaluarën dhe ne jemi dëshmitarë që Auditori gjeneral ka dalë me raporte konkrete nga puna e Qeverisë së kaluar, ku janë gjetur shkelje konkrete dhe keqpërdorime, si dhe faza tjetër është që në këtë vit të kësaj qeverisjeje të kemi një raport të Auditorit gjeneral se ç'po ndodhë tash.

Unë mendoj se për t'i çuar përpara këto punë, nën një, duhet të ketë vullnet politik për t'u marrë me këtë çështje, por në anën tjetër sundimi i ligjit, e kam thënë edhe herëve të tjera, është prioritet i Qeverisë së Kosovës. Një obligim më shumë na del nga Raporti i Komisionit Evropian, i cili në këtë fushë sigurisht i rekomandon Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha institucioneve të Kosovës të punojnë më shumë, në mënyrë që jo vetëm të krijohet një gjendje më e mirë në shtetin tonë, por edhe të jemi më afër synimeve tona për integritet evropian. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit!

Unë mendoj, gjithashtu, sikur edhe të tjerët, që ky raport i Grupit të punës të Komisionit për Buxhet dhe Financa është mjaft i mirë, pasqyron gjendjen, ani që nuk kanë mundur të vizitojnë shumë organizata, organizata buxhetore, por si për nivelin lokal, qendror apo në ndërmarrje publike, tregon një gjendje reale. Tash mund të thuhet se Qeveria është përgjegjëse për moszbatimin e ligjit, edhe Ministria e Financave i ka obligimet, sidomos nga ky Ligji për auditim të brendshëm, por duhet të jemi real, për zbatimin e ligjit e kemi një përgjegjësi totale në shoqëri. Prandaj, kur diskutojmë tash për këtë ligj, unë mendoj se më lehtë i aprovojmë ligjet, se sa që e shikojmë zbatimin e tyre. Ky Kuvend, me siguri në të ardhmen duhet të ketë një kujdes në këtë drejtim.

Unë nuk do t'i përmend ato që desha prej raportit ta komentoj, se ka qenë diskutim, por është e vërtetë që auditorët, me rekomandimet e tyre nuk janë të fuqishëm. Pse nuk janë të fuqishëm? Nuk është puna e mungesës së ligjit, janë me siguri ato vërejtjet që u dhanë, që janë shënuar në raport. Ekziston varësia e tyre, ato mundën të eliminohen, por unë e kam një sugjerim në lidhje me rekomandimet.

Në tërësi rekomandimet mendoj se janë gjithëpërfshirëse, por ato duhet ndahen në dy grupacione. Një, rekomandimet të cilat janë eventualisht për iniciimin e plotësimit të ligjit, eventualisht po them, se nuk është problemi aty, dhe nevoja për harmonizimin me Ligjin për ndërmarrje publike dhe të shikohet a mungon ndonjë akt nënligjor, do me thënë, rekomandimet në lidhje me infrastrukturën ligjore. Nën dy, rekomandimet për funksionimin dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e ligjit, se në raport e kemi një vlerësim se njerëz të autorizuar nuk i kanë krijuar komitetet e auditimit, e gjithashtu janë edhe disa probleme të tjera. Prandaj, rekomandimet të cilat janë për krijimin e mekanizmave, edhe unë po pajtohem me të tjerët për afatizimin, se gjithkund po shkruan afati sa më i shkurtër, por jo edhe afati real, nuk mund të themi për një muaj, por një afat real.

Por, edhe diçka. Unë mendoj se të gjitha rekomandimet janë për Ministrinë për Financa, se është edhe obligimi ligjor, por mungon një rekomandim obligativ edhe ndaj të gjitha institucioneve buxhetore për krijimin e mekanizmave për auditim të brendshëm. Prandaj, propozoj edhe rekomandim direkt pos përmes Ministrisë, e cila e ka obligimin ligjor.

Duhet t'i kthemi zbatimit të ligjeve. Po e përfundoj me këtë fjali, sidomos ky ligj është shkalla e parë e luftës kundër korrupsionit, prandaj unë nuk jam përkrahës i asaj që duhet patjetër të kritikohet ose patjetër të mbrohet, po realitetin ta pranojmë dhe zbatimin e ligjit është me siguri për të ardhmen një prej problemeve shumë serioze të shoqërisë sonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Sa për të qenë korrekt mes veti të gjithë, janë edhe dy diskutues të paraqitur dhe është zëvendëskryeministri, që do ta marrë fjalën në fund. A do të vazhdojmë, se kam sinjale, po kërkojnë pushim për drekë. Vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues,

Unë personalisht mbështes Raportin dhe rekomandimet e komisionit dhe ky raport tregon më së miri gjendjen reale të zbatimit të ligjeve në Republikën e Kosovës.

Unë do të ndalem konkretisht në komunën e Skenderajt. Unë personalisht kam kërkuar qasjen në dokumente zyrtare të Zyrës së prokurimit të komunës së Skenderajt, dhe aty

nuk më është lejuar mua e lëre më qytetarit të Kosovës që të ketë qasje në dokumentet zyrtare të një komune që dokumentet zyrtare të prokurimit nuk janë dokumente sekrete dhe kanë të drejtë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë qasje. Merreni me mend, kur mua nuk më është lejuar, sa të drejtë kanë qytetarët që të kenë qasje në dokumentet zyrtare të një komune ku, ta zëmë, e ka pushtetin PDK.

Po e them këtë për arsye se zyrtarët komunalë, lëre që nuk më kanë lejuar, por më kanë detyruar ta thërras ministrin e Pushtetit Lokal, që e kam thirr në telefon dhe me zë e kam lëshuar me interfon që ta dëgjojnë që me ligj është e rregulluar qasja në dokumente zyrtare edhe të Republikës së Kosovës, edhe të komunës dhe, aty, lëre që nuk kanë lejuar, por edhe kanë bërë fjalë ku ta di çfarë për ministrin.

E them këtë për arsye se zyrat e prokurimit në komunat tuaja veprojnë ashtu siç dëshirojnë ata dhe nuk i përshtaten dhe nuk i përgjigjet ligjit që e kemi miratuar ne.

Mora shembull komunën time për shkak se e kam bërë edhe kërkesën me shkrim dhe në bazë të ligjit, në kërkesat me shkrim duhet të përgjigjet dikush. Nëse ata nuk përgjigjen, atëherë jam i detyruar që këto t'i them para Kuvendit të Kosovës.

Nuk po them fjalë, nëse juve e keni ministrin e Pushtetit Lokal, ai e di kur e kam thirr, unë e kam të incizuar në telefon kur e kam thirr, e kam minutën, orën, datën dhe ky është realiteti zbatimit të ligjeve në Republikën e Kosovës.

Ky është realitet, kjo është që më ka ndodhur mua, po çka i ndodhë qytetarit? Cili qytetar guxon që në komunat ku ju e keni pushtetin, të kërkojë zbatimin e ligjit apo të kërkojë qasje në dokumentet zyrtare, që është me ligj e rregulluar. Unë po them sinjerisht, kur nuk zbatohet kushtetuta, ku mund ta zbatoni ligjin. Ligji është më i vogël se Kushtetuta dhe ju nuk po e zbatoni Kushtetutën.

Kemi edhe probleme që Kushtetuta nuk po zbatohet, e kemi Këshillin e Sigurisë që prej se është bërë Kushtetuta nuk është formuar dhe duhet të vijë dikush prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të na thotë silluni si shtet se jeni shtet dhe ne ju kemi pranuar shtet, dhe kur të vijnë ata...

(Ndërhyrje e Kryesuesit: Zotëri Geci, në kuadër të temës, ju lutem!)

GANI GECL....le të na shpëtojnë prej situatë. Kjo është ajo që desha të them dhe e ndërlidha këtë për shkak se Kushtetuta nuk po zbatohet e lëre më ligjet në fjalë që nuk janë duke zbatuar askund. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Edhe unë jam dakord se ligji duhet të zbatohet nga të gjithë dhe vlen për të gjithë. Sidoqoftë, mendoj se rrugët për ankesa dhe për denoncime janë të hapur dhe duhet të bëhen, jo vetëm kështu publikisht në Parlament, por edhe brenda institucioneve. Mirë është që të ankoheni për secilin rast veç e veç, kujtudo që i ndodhë, jo vetëm prej deputetëve, por edhe prej qytetarëve. Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Zëvendëskryeministër, ministra,
Deputetë të nderuar,

Edhe unë desha pa qëllim t'i përsërisë ato që i thanë kolegët e mi, me të cilët gati në tërësi pajtohem. Vërtet, ky rekomandim, gjegjësisht propozim për shqyrtimin e Raportit të Grupit të punës të Komisionit të Kuvendit për mbikëqyrjen dhe aplikimin e ligjshmërive, respektivisht kur është fjala mbi revizionin e brendshëm, është ndoshta një ndër raportet që duhet të jetë model për komisione dhe grupe të tjera të interesit për këto qëllime, në aspektin e zbatueshmërisë së ligjit.

Vërtet, këto rekomandime, shumica, mos të them tërësisht, janë rekomandime që adresohen kah Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e cila e ka edhe përgjegjësinë për këtë fushë, por ajo çka të unë e ka peshën më të madhe dhe i kam vërejtjet më të mëdha, është fjala te Ministria e Ekonomisë dhe Financave që duhet t'i raportojë Komisionit për Buxhet dhe Financa për nivelin e zbatimit të ligjit, së paku një herë në vit, që është e rregulluar me rregullore të posaçme.

Sa e kuptova unë, nga anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe financa, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur ose ka ndodhur krejt në mënyrë provizore, andaj këto rekomandime të zbatueshmërisë së ligjit për revizion të brendshëm nëpër agjencionet buxhetore, respektivisht nëpër njësitë buxhetore që reflektojnë shfrytëzimin apo harxhimin e mjeteve nga taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, është një shembull i mirë që duhet të jetë në kuptimin e asaj që të rishikojmë edhe aspekte të tjera, respektivisht ligje të tjera.

Kur është fjala te auditimi i brendshëm, mos të keqkuptohemi, as qytetarët e as ne si deputetë. Ju lutem, auditimi i brendshëm është në interes të njësisë buxhetore, të vetë institucionit që e krijon. Andaj, është nonsens i madh të mos ketë qasje në dokumente auditori i brendshëm, sepse në një farë forme ai jep pasqyrën për gjendjen financiare ekonomike në aspektin e shfrytëzimit të mjeteve, qoftë në nivel buxhetor lokal, qoftë në nivel buxhetor qendror. Andaj, ai është në interes të agjencionit buxhetor, të njësisë buxhetore që ta bëjë këtë. Në qoftë se ka raste të tilla, ndoshta më së miri është që bartësit e kësaj njësie të revizionit të qesin në shesh këto fenomene, apo në qoftë se ka elemente të konfliktit të interesave midis përfaqësuesit të revizionit, respektivisht përfaqësuesit ekzekutiv, që fjala vjen, te ministritë është sekretari permanent ose te agjencionet e tjera buxhetore, si janë komunat, është kryeshefi i ekzekutivit apo tash është drejtori i administratës apo i prokurimit, apo format e tjera, por të kuptohemi, në kuptimin e harmonizimit. Interesi i njësisë buxhetore është auditori i brendshëm, se në njëfarë forme ai bën transparente shfrytëzimin e mjeteve brenda institucionit. Andaj, mos të keqkuptohemi këtu në kuptimin e asaj kush ka të drejtë në kontrollimin, respektivisht vëzhgimin e njësisë buxhetore. Ajo është e drejtë ekskluzive e tij, që në njëfarë forme të bëjë publike çështjen e shfrytëzimit të mjeteve.

Unë pajtohem në tërësi me këto rekomandime, edhe pse ka edhe shumë çka të thuhet, mirëpo ndoshta është një model i mirë që është shembulli i mirë për shumë komisione të tjera, të cilat duhet të shikojnë zbatimin e ligjit, sepse vërtet kemi ardhur deri në njëfarë pozite. Ky Kuvend ka nxjerrë mjaft ligje, edhe ligje përmbajtësore, andaj të shikojmë pak në aspektin e fitbekut, sa janë duke u zbatuar ligjet në Kosovë, që është detyrë e komisioneve. E përgëzoj komisionin edhe një herë dhe të gjithë ata që dhënë kontribut në këtë drejtim. Unë, kaq kisha!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për fjalë është paraqitur edhe njëherë deputeti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Për të mos e zgatur, më vjen keq para zëvendëskryeministrit që do ta ketë fjalën e fundit, por për hir të deputetëve dhe të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në Grupin punues, i shoh të arsyeshme vetëm disa sqarime rreth raportit.

Mua më vjen keq, sepse ka kaluar kohë e gjatë që e kemi dorëzuar raportin dhe, siç shihet, shumica e deputetëve nuk e kanë raportin e plotë me veti dhe kualifikimet e bëra, sidomos nga të gjeturat pas çdo vizite, ne si grup punues, e kemi përgatitur raportin nga çdo vizitë dhe nëse ata që i kanë raportet, nga rekomandimet janë edhe fusnotat, fusnotat se cilës komunë, cilës ministri ne i referohemi. E falënderoj profesor Ramosajn, sidomos për kualifikimin e bërë, se është profesor dhe e di se si bëhen temat apo punimet. Ndoshta ne kemi shkuar në këtë formë, se për 8 vite në Kuvendin e Kosovës nuk kemi gjetur një model se si ta hartojmë një raport për monitorimin e zbatimit të ligjit. Na vjen mirë, se edhe komisionet e tjera kanë filluar ta marrin si model këtë raport.

Te afati, te precizimi i afatit, unë e kam një sqarim edhe për profesorin Smaka, kur janë vizitat në terren, të cilat janë me fusnotë, ne nuk kemi mundur të vejmë afate, sepse shikoni datat, kur janë bërë vizitat dhe kur po shqyrtohet raporti, të nderuar deputetë, 4 muaj. Ajo çka është me rëndësi, ta ceku, vetë vizitat e grupeve punuese në organizatat buxhetore nga të gjeturat ne kemi informata që janë zbatuar pikërisht në ditët në vijim.

Do t'i marrë tre shembuj. Njësia Qendrore për Harmonizim të auditimit të brendshëm ka ngritur nivelin e përgjegjësisë dhe menjëherë ka filluar procedurat për hartimin e dokumenteve dhe të të gjitha obligimeve që dalin nga ligji.

Komuna e Prishtinës, nga vizita që e kemi pasur ne në komunë, kemi gjetur auditorin në një zyrë të madhësisë një metër me një metër. Pikërisht të nesërmen iu është bërë akomodimi dhe është akomoduar në një zyrë më të përshtatshme për punë.

Komuna e Pejës, ne kemi gjetur se aty nuk paguhet udhëheqësi i njësisë apo drejtori. Pikërisht në ditët në vijim i kemi informatat që është zbatuar ajo pikë e ligjit dhe është shumë e arsyeshme. Ne nuk kemi mundur si grup punues apo si komision t'i vizitojmë 35 komuna dhe të gjitha qeveritë dhe të gjitha organizatat buxhetore, por këto i kemi marrë si model dhe në bazë të tyre janë këto rekomandime. Sa u përket afateve, afatet i përcakton Kushtetuta, i përcakton ligji, të cilat e obligojnë ministrin për Ekonomi dhe Financa që një herë në vit të raportojë para Komisionit për Buxhet dhe Financa për zbatimin e të gjitha ligjeve që janë në kompetencë dhe fushëveprimtarinë e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Do të jem shumë i shkurtër dhe ju kisha lutur për pak vëmendje! Unë, me ju thënë të drejtën, edhe nuk e kisha në plan të diskutoj, mirëpo duke e parë se disa deputetë e shfrytëzuan këtë raport, që në parim unë e përkrah, sepse Raporti i Komisionit ishte shumë i mirë, e shfrytëzuan për të bërë propagandë më shumë politike, e shfrytëzuan për të akuzuar Qeverinë aktuale, m'u duk se doza e kritikave që vijnë ishte pak e tepëruar.

Praktikat qeverisëse në Kosovë dhe përgjegjësia e zbatimit të ligjit në Kosovë, në përgjithësi është e ulët dhe nuk fillon as me këtë legjislacion, as me këtë Qeveri. Unë besoj që raporti këtu do të ndikojë pozitivisht që nëpër organizata buxhetore, nga

drejtuesit të shtohet përgjegjësia për ta zbatuar ligjshmërinë e funksionimit dhe të harxhimit të parasë publike, por gjithsesi ky raport do të ketë ndikim pozitiv edhe në vetë qeverisjen aktuale që disa praktika dhe shprehje, disa vese të këqija të të gjithë neve së bashku këtu, jo vetëm si qeveritarë dhe deputetë, por si tërësi, si popull, që më shumë gjërat i kryejmë me kanun të Lekës, e jo me ligje, besoj që do të ndikojnë pozitivisht që të përmirësohen gjërat në këtë sferë për arsye se është në interesin e qytetarëve.

Në këtë drejtim, unë i përkrah të gjithë, mirëpo zotëri Geci ishte krejt jashtë teme gjatë diskutimit. Ne, zoti Geci, nuk e kishim këtu Ligjin për qasje në dokumente zyrtare, ne këtu bisedonim për një raport konkret, kurse ai fliste për Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare dhe një përvojë personale të tij e përgjithësoi dhe e ngriti në një nivel të përgjithshëm, gjëja se çdo kund, në çdo komunë dhe në çdo vend ndodhin gjëra të tilla. T'jua them të drejtën, këtu i kishte fajin edhe kryesuesi, i cili nuk e ndërpreu, por si duket, ishte i papërqendruar dhe nuk kishte të bënte asgjë me temën e debatit që e diskutuam.

Edhe diçka desha të shtoj, krejt në fund. Nuk duhet edhe më tepër t'i jepet pompë një pune që është një punë e një nënkomisioni, punë e mirë, punë që ne duhet ta bëjmë edhe në të ardhmen, si deputetë, me komisionet e tjera, por jo tash të krijohet përshtypja se gjëja të gjitha këto dobësi filluan me këtë Qeveri edhe kjo Qeveri tash i ka përgjegjësitë për gjithë atë gjendje që është krijuar në administratën tonë shtetërore. Këtë desha të them, të tërheq vëmendjen. E përkrah raportin dhe besoj se ky Raport do të ketë shumë ndikim pozitiv, siç e tha edhe vetë zoti Zemaj, që menjëherë ka pasur efekte pozitive dhe një qasje tjetër të zyrtarët në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUQI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Me vëmendje të gjatë dhe të thellë, do të thosha, kemi dëgjuar dhe kemi lexuar për raportin që u përmend sot.

Që në fillim duhet të themm në emër të Qeverisë është një ndër pikat e rendit të ditës që me ëndje e kemi pritur. Natyrisht që është në mandatin e Kuvendit që ta bëjë një gjë të tillë dhe dua të inkurajoj jo vetëm Komisionin për Buxhet dhe Financa, por edhe komisionet e tjera që ta bëjnë një gjë të tillë.

Më lejoni që në fillim të falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa, në veçanti nënkomisionin që e ka bërë një punë të tillë, e cila është ndihmuese për Qeverinë e Kosovës dhe ndihmuese për të gjithë ne në vendin tonë.

Që në kohën kur e kemi filluar mandatin në këtë Qeveri, kemi vërejtur dy dukuri, do të thosha, në raport me Ligjin.

Dukuria e parë ka qenë moszbatimi i ligjeve dhe dukuria e dytë është mosharmonizimi i ligjeve njëri me tjetrin, që po paraqiten edhe në rastin konkret. Ne kemi themeluar dy komisione, Komisionin për monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe Komisionin për monitorimin e harmonizimit të ligjeve.

Në këtë drejtim, kemi përfaqësues nga Kuvendi, nga gjykatat dhe nga organizatat e nivelit komunal, por edhe të atyre shkencore dhe intelektuale që merren me fushën e çështjeve qoftë juridike, ekonomike apo edhe të tjera.

Një prej çështjeve që po përmendet sot, duhet të them që në fillim, rekomandimet Qeveria i pranon me kënaqësi, i pranon me kujdes të shtuar dhe ju premtoj që do të tentojmë me gjithë kapacitetin tonë, qoftë buxhetor, qoftë në kuadër të mundësive tona legale, që t'i implementojmë në praktikë.

Mosimplementimi i ligjeve edhe në rastin konkret, ka shpeshherë rrethana edhe objektive, edhe subjektive. Rrethanat objektive i dimë me siguri, mungesa e kapaciteteve e kështu me radhë, që u përmend, por kur është fjala për auditimet, me siguri ka edhe anë subjektive. Këtu është fjala për menaxhimin e financave publike dhe ne nuk e përjashtojmë mundësinë, si Qeveri, që ka disa nivele, qoftë brenda Qeverisë, brenda komunave apo edhe të ndërmarrjet publike që dikujt nuk i pëlqen që të bëjë veprime të tilla të auditimit.

Në kuptimin figurativ, me lejon të them vetëm një fjali. Auditimi i brendshëm, në kuptimin politik i shërben Qeverisë, auditimi i jashtëm i shërben opozitës. Nëse do të funksiononte mirë auditimi i brendshëm, nuk do të befasoneshim ne me auditimin e jashtëm. Këtu besoj, ne do të angazhohemi shumë më shumë që auditimet që do të dalin në vitin 2009 për qeverisjen tonë, të mos janë befasuese, në radhë të parë për ne, por edhe për vetë qytetarët dhe të mos jenë instrument edhe i luftës politike, por në raste të caktuara, pse jo edhe i përgjegjësive legale.

Ajo çka dua të them është se Qeveria e Kosovës ka filluar t'i ndërmarrë disa hapa. U përmend edhe nga zotëri Zemaj Njësia për harmonizimin e organizimit të tillë dhe çështjet e tjera, por nuk jemi të kënaqur me nivelin që po e bëjmë. Zakonisht, të gjithë ne presim me dridhje, po e them, se mund të kemi shkelje objektive, subjektive, ndoshta në momentet e caktuara pakujdesi, pastaj në momente të caktuara, do të thosha, keqmenaxhim apo keqpërdorim të financave. Në këtë drejtim nuk duhet që auditorët e brendshëm, po premtoj, të na lejojnë neve, që ditën kur të vijë auditimi i jashtëm, të jemi nën ethe. Ne duhet të punojmë në atë drejtim që auditori i brendshëm në çdo moment të vërej paraprakisht veprimet, lëshimet që mund t'i bëjë Qeveria dhe ne në momentin e duhur të funksionojmë.

Unë e di që kemi një shqetësim të tillë, e di që nuk ka funksionuar dhe nuk funksionon si duhet një sistem i tillë dhe ky sistem do të na kushtojë në radhë të parë neve si Qeveri, pastaj edhe të tjerëve.

Unë po ju premtoj se të gjitha rekomandimet e theksuara dhe të tjerat, do të shprehim një vullnet politik që t'i realizojmë, do ta krijojmë bazën e domosdoshme legale, qoftë me akte nënligjore. Nuk është qëllimi i parë ndryshimi i ligjit. Qëllimi i parë është zbatimi i atij ligji ekzistues dhe nëse vërehet që ka pengesa dhe me zbatimin e atij ligji vërehen edhe çështje të tjera që nuk mund të jenë efikase dhe efektive në terren, atëherë do t'ju lusim juve për mirëkuptim. Do t'i krijojmë mundësitë buxhetore për funksionim të plotë, autonominë edhe të individëve që punojnë, natyrisht auditorët, besoj që më së paku na duhet të jenë servil. Neve na duhen, po e them në kuptimin, të jenë lojalë administrata, njerëzit e tjerë, por jo auditorët që të na lejojnë të jemi lojalë për gjashtë muaj ose një vit, ndërsa pas një viti ta dërgojmë dikë para organeve të drejtësisë. Nëse ata ia donë të mirën kujtdo që punon në Qeveri, do t'i tregonin që nëse bën lëshime ..., të mos e shkel ligjin në momentet e caktuara.

Unë dua të them se organizimi i brendshëm që do të bëhet te auditorët, krijimi i kushteve të domosdoshme, autonomia që u përmend edhe me ligjet e tjera, duhet t'i dallojmë dy gjëra: moszbatimi i Ligjit, që mund të jetë përgjegjësi, pra përgjegjësi edhe disiplinore,

edhe politike, edhe diku tjetër, dhe shkelja e ligjit. Shkelja e ligjit është diçka që Qeveria mund të marrë vetëm masa disiplinore ndaj dikujt, mund të marrë veprim politik me ndonjë ndryshim, ndërsa për procedurat e mëtejme për shkeljet e ligjit janë organet kompetente, nuk është as Kuvendi, as dikush tjetër. Ky Kuvend e konstatoi sot dhe unë besoj që me konstatime të tilla do të merremi.

U përmend çështja e afatit. Unë po ia përcaktoj afatin Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, që brenda vitit të dërgojë raportin konkret, raportin që u përmend për Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ne jemi të gatshëm, jo vetëm në afatin ligjor brenda vitit, por jemi të gatshëm sa herë që është nevoja, të prezantojmë një gjë tilla.

Edhe njëherë ju falënderoj të gjithë juve që dhatë kontributin tuaj. E falënderoj në veçanti komisionin për punën që e ka bërë dhe ju premtoj se rekomandimet që i keni dhënë sot dhe do të miratohen, jo vetëm që janë obligative, në kuptimin juridik formal, por do të reflektojmë ne edhe me vullnet politik, por edhe me angazhime konkrete. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zëvendëskryeministër!

Gani, edhe pse e ke kërkuar fjalën pas kohe, megjithatë, merre!

GANI GECI: Jo, nuk isha këtu, mirëpo edhe ata që e kanë shfrytëzuar rastin, kur s'isha këtu, s'prish punë. Problemi është kështu: nëse unë kam dal jashtë rendit të ditës kur kam folur për auditimin dhe kam kërkuar qasje në dokumente zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në dokumentet zyrtare të komunës së Skenderajt dhe flasim për rekomandimet e Komisionit, unë besoj që nuk kam dalë jashtë rendit të ditës, sepse kjo temë, e para, është në rend dite, e dyta, nëse dikush thotë se del jashtë rendit të ditës, nëse bisedon për kryetarët e komunave dhe kryetarët e komunave tuaja shkojnë nëpër burgje, kjo s'është jashtë rendit të ditës, por është në rendin e ditës. Pra, nëse ne flasim për Kushtetutën e Republikës, as kjo nuk është jashtë rendit të ditës, sepse ne po flasim për menaxhimin dhe respektimin e ligjeve dhe respektimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prandaj, unë ju kuptoj shumë mirë që ju jeni pozitë dhe ju keni fuqinë t'i zbatoni ligjet ashtu siç ju përshtaten juve, sepse edhe numrat i keni, kur të doni çoni dorën dhe neve na mundni, mirëpo respektimi i ligjit është i barabartë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, jo vetëm për mua si deputet, por edhe për zotin Gani, sepse ne para ligjit jemi qytetarë të barabartë. Pra, nëse një ligj nuk zbatohet në Republikën e Kosovës dhe kërkohet respektimi i tij nga Komisioni kompetent dhe thuhet se ke dal jashtë rendit të ditës, kjo le të mbetet në ndërgjegjen e atyre që flasin në këtë drejtim. Mirëpo, unë po them sinqerisht, më ka ndodhur mua në komunën e Skenderajt, që ta thërras ministrin e Pushtetit Lokal dhe ta pyes a kam të drejtë unë si anëtar i Parlamentit të Republikës së Kosovës të kem qasje në dokumentet zyrtare? Merreni me mend, kur mua s' më lejohet dhe plus ministri fyhet, sa të drejtë kanë qytetarët e tjerë? Pra, kjo është ajo që kam dalë unë jashtë rendit të ditës dhe nëse kam dalë jashtë rendit të ditës, po ju kërkoj falje dhe po ia jap fjalën zotit Gani, le të na shpjegojë rendin e ditës se si duhet t'i përmbahemi rendit të ditës kur bisedojmë për dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: E ke kaluar pak kohën Gani, por të kemi toleruar. Urdhëroni! Gani Buçinca, tash edhe ti një minutë e ke.

GANI BUÇINCA: Dëgjoni, më falni, ajo çka unë e thashë pak më herët, krejtësisht m'u konfirmua gjatë kësaj replike. Unë nuk e kuptova a është replikë, a është debat? Kjo ishte një shkelje flagrante e rregullave këtu që i kemi ne në Kuvend.

Pra, u shkel Rregullorja, se ky ishte diskutim, e në fakt ishte replikë, por unë nuk e kuptova. Domethënë, foli prapë edhe e bëri të njëjtën veprim që e bëri gjatë diskutimit edhe në replikë. Edhe kjo nuk ish në rregull me normat dhe ligjet që e konfirmoi atë që e tha, që ne nuk i respektojmë normat në përgjithësi. E dyta, prapë doli prej temës së rendit të ditës. Kurrë nuk kam çka për të thënë, i nderuari, zoti Gani, vetëm unë ju kuptoj se ju keni nevojë për këso eksponimesh politike dhe i kuptoj nevojat tuaja të brendshme edhe individuale edhe partiake, kështu që vazhdoni edhe më tutje.

KRYEARI: Ju faleminderit! Gani Geci, e ke një minutë.

GANI GECI: Jo, unë nuk kam nevojë për eksponim. Sa për informatë, kam vota më tepër se ai dhe nuk kam nevojë për eksponim. (Duartrokitje). E di Gani Buçinca këtë, por problemi im është ligji dhe nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i zbaton ligjet, nëse nuk e zbaton Kushtetutën, nëse institucionet tona nuk i zbatojnë ligjet dhe Kushtetutën, kjo nuk është dalje jashtë rendit të ditës. Ganiu po i ngatërron gjërat. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Mendoj se deri më tani Kuvendi nuk i ka shkelur ligjet dhe Kushtetutën, as Rregulloren e Punës, edhe pse këtë e bëjnë nganjëherë deputetët. Mendoj që të gjithë jemi për sundimin e ligjit, po shpeshherë për sundimin e ligjit flasin ata që vërtet më së shumti dalin jashtë tij. Po, ne kalojmë në votim. I keni rekomandimet e Komisionit. Është zhvilluar një debat dhe tash votojmë për rekomandimet e Komisionit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Ju faleminderit! Konstatoj se Kuvendi me 63 vota "për", asnjë kundër, 1 abstenim, miratoi Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm.

2. Ngarkohet Qeveria, përkatësisht, Ministria e Ekonomisë dhe Financave për implementimin e rekomandimeve të miratuara.

Me këtë e përfunduam pikën e 10- të rendit të ditës. Shkojmë në një pauzë deri në orën 15,00 dhe në orën 15,00 vazhdojmë, sepse i kemi edhe dy pika tjera.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYEARI: Vazhdojmë.

Pika e 11-të e rendit të ditës është:

- **Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007.**

Qeveria në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit ia ka paraqitur Kuvendit Raportin lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007.

Komisioni Funkcional për Bujqësi dhe Mjedis ka shqyrtuar Raportin dhe ia ka rekomanduar Kryesinë që ta radhisë për shqyrtim në seancë.

Ftoj përfaqësuesit e Qeverisë për ta arsyetuar Raportin nëse dëshiron fjalën. A e doni fjalën? Urdhëro!

Ministri Yagcilar e ka fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Hartimi i Raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e mbrojtjes së mjedisit sipas të cilit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor çdo dy vjet ia dorëzon raportin Qeverisë së Kosovës, e cila pas miratimit ia paraqet Kuvendit të Kosovës.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, është organ që ka bërë hartimin e këtij dokumenti.

Ky raport paraqet gjendjen e mjedisit për periudhën 2005-2007 edhe pse në të ka të dhëna për një periudhë më të gjatë kohore.

Të nderuar deputetë,

Ky raport është i rëndësishëm edhe për faktin se prezantohet në një moment kur Kosova, pas shpalljes së pavarësisë, është orientuar në ndërtimin e një shteti modern për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Në këtë rrugë, krahas sfidave tjera, ne do të përballemi edhe me plotësimin e kërkesave dhe nevojave mjedisore.

Në pamundësi për t'i prezantuar në mënyrë të detajuar të dhënat e këtij raporti, me këtë rast po ju prezantojmë vetëm disa nga të dhënat më kryesore që dalin nga ky raport siç janë ajri dhe ndryshimet klimatike. Në territorin e Kosovës, gjatë periudhës 2004-2007, në disa raste është shënuar tejkalimi i vlerave maksimale të lejuara: blozës, pluhurit dhe CO₂. Vetëm nëpërmjet KEK-ut, Kosova i kontribuon ngrohjes globale me rreth 5.5 milionë ton CO₂ brenda vitit.

Vlerësohet se po aq sasi e CO₂ lirohet brenda një viti edhe nga komunikacioni dhe burimet e tjera.

Uji. 70% e popullatës së Kosovës furnizohet me ujë nga ujësjellësi publik. Rreth 92% e popullatës nëpër qytete e pinë ujin me klor dhe 60% e popullatës rurale pinë ujë nga pusët ku vetëm 1.2% e tyre trajtohen me klor dhe 30% e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit.

Mbeturinat. Rreth 90% e popullsisë urbane mbulohet me mbledhjen e organizuar të mbeturinave, popullsia e zonave rurale mbulohet rreth 10%.

Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë sillet rreth 2 kilogramë për kokë banori në ditë.

Pylltaria dhe biodiversiteti, vetëm gjatë vitit 2007, përafërsisht 8 mijë e 700 hektarë e pyjeve të Kosovës janë përfshirë nga zjarri. Nga prerjet ilegale të pyjeve, mesatarisht,

gjatë vitit Kosova humb, përafërsisht, 10 mijë metër kubë dru. Rreth 222 mijë metër kub të drurit teknik dhe drurit për djegie eksploatohet nga të dy sektorët në vit.

Bujqësia. Përderisa dendësia e banimit në Kosovë është rreth 204 banorë në një kilometër katror, sipërfaqja e tokës bujqësore për kokë banori është vetëm 0.15 deri 0.18 hektarë tokë, që është shumë më e vogël krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian, ku është 0.52 hektarë për banor. Mesatarisht rreth 4 milion e 800 mijë kilogram pesticide përdoren brenda vitit në Kosovë dhe ende nuk ka program specifik të monitorimit të përdorimit të pesticideve dhe të plehrave kimike.

Energjia. Krahasuar me vitin 2004, konsumi i energjisë së përgjithshme në Kosovë është rritur për 18%. Në konsumin e përgjithshëm të energjisë në periudhën 2003-2006, nafta dhe nënproduktet e saj janë kontribuuesit kryesor me rreth 60%, energjia elektrike me 25.87%, druri me rreth 20%, thëngjilli 2.67%, ngrohja qendrore me rreth 1% dhe energjia solare me 0.1%.

Edhe pse vlerësohet se Kosova ka potenciale për prodhimin e energjisë elektrike, nga burimet e energjisë alternative vetëm 2% e energjisë elektrike prodhohen nga këto burime, ndërsa 98% e energjisë elektrike prodhohet nga thëngjilli.

Transporti. Kosova ka rreth 300 mijë automjete të regjistruara. Mesatarisht në vit regjistrohen afërsisht 17 mijë automjete të reja. Në periudhën 2005-2006, numri i fluturimeve nga Aeroporti i Prishtinës ka arritur në rreth 5000 fluturime në vit. Një ilustrim i thjeshtë, një aeroplan i tipit Boeing 707, për 8 orë fluturim, shpenzon sasinë e oksigjenit që e prodhojnë rreth 25 mijë hektarë pyje.

Shëndeti publik dihet se ekziston një numër i rasteve me sëmundje ngjitëse dhe me epidemi në Kosovë, që janë ende në shkallë të lartë.

Kur është fjala për Shoqërinë Civile në Kosovë, për dallim nga vitet 2002-2006, është dyfishuar numri i organizatave joqeveritare aktive mjedisore, por janë zvogëluar donacionet për mjedisin.

Tek edukimi mjedisor, niveli i përfshirjes së mbrojtjes së mjedisit në plan programet arsimore-edukative, si në arsimimin e ulët, ashtu edhe në studimet bazë dhe studimet posdiplomike ka shënuar rritje të theksuar. Numri dhe kualiteti i këtyre plan programeve ende nuk i kënaq nevojat dhe kërkesat që dalin përballë problemeve të mëdha mjedisore që ka Kosova.

Gjithashtu ekziston edhe rekomandimi si nevojë e ngutshme për kompletim dhe implementim e legjislacionit, rritjen e buxhetit dhe ngritjen e fondeve ekologjike, ngritjen e shpejtë të sistemeve monitoruese mjedisore, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të pijes dhe ujërave të zeza, impianteve për ndarjen dhe përpunimin e mbeturinave, ndërtimin e kapaciteteve për prodhim të pastër të energjisë nga burimet e ripërtërira e të tjera.

Për të arritur rezultate në mbrojtjen e mjedisit nevojitet bashkëpunim dhe angazhim i të gjithëve. Shpresojmë që me rritjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e sistemeve të integruara monitoruese, do të rritet edhe cilësia e raportit. Andaj, me këtë rast, në emër të stafit të Ministrisë, shpreh falënderimin për të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare që kanë dhënë kontributin e tyre përmes ofrimit të dhënave të nevojshme

për hartimin e këtij raporti dhe, ju bëj thirrje të gjithëve për thellimin e bashkëpunimit në dobi të mbrojtjes së mjedisit.

Po theksoj edhe një herë se ky raport, i cili është i pari, do të jetë një kontribut i vlefshëm në avancimin, përmirësimin dhe përsheptimin e zgjidhjes së çështjeve të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë.

Ju ftoj që edhe ju, të nderuar deputetë, të jepni kontributin tuaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit ministër!

Lulzim, a e do fjalën si kryetar i Komisionit? Po mirë, merre fjalën!

Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Unë si kryetar i Komisionit Parlamentar, mund të themi se Komisioni vetëm ia ka përcjellë këtë raport seancës plenare dhe seanca plenare është ajo e cila do ta thotë fjalën e vet. Pra, duhet ta njoftoj Kuvendin e Kosovës, përkatësisht deputetët se Qeveria e Kosovës, sipas nenit 9 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, me propozim të Ministrisë i paraqet Kuvendit raport dyvjeçar dhe ai publikohet pas debatit në Kuvend. Kam edhe një njoftim lidhur me amendimin, pra, duhet një procedurë e mëtejme e amendimit për ligjin në fuqi, kështu që kemi paraparë që çdo vit Ministria t'i raportojë...

Sipas nenit 9, Qeveria paraqet raport, mirëpo raporti kur i paraqitet seancës plenare janë disa kritere se çka duhet të përmbajë.

Neni 9 i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit e specifikon shumë qartë. E tash, duhet të kthehemi pa e lexuar ligjin, pa e specifikuar se çka do të thotë neni 9, do të kthehem në kuadër të raportit dhe këtu, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të shpreh qëndrimin tonë pasi si Komision nuk kemi pasur mundësi dhe nuk ka qenë obligim i Komisionit të dalë me rekomandim.

E para, ky nuk është raport për gjendjen e mjedisit për periudhën kohore të cekur. Raporte të tilla mund të bëjë Enti i Statistikave të Kosovës dhe të japë vlerësim se sa është shkalla e varfërisë, sa është shkalla e natalitetit, mortalitetit, sa është shkalla e automjeteve që qarkullojnë në territorin e caktuar? E tha edhe ministri që një aeroplan Boeing sa shkakton ndotje apo shpenzim të oksigjenit e kështu me radhë, mirëpo, raport për gjendjen e mjedisit ky nuk është. Raporti për gjendjen e mjedisit i referohet gjendjes aktuale, duke pasur në konsideratë gjendjen e kaluar dhe duke iu referuar standardeve të Bashkimit Evropian, por kjo deri me tash nuk ka ndodhur. Unë shpreh keqardhjen se në qoftë se Qeveria e Kosovës ka miratuar këtë raport, atëherë nuk e di se cila do të jetë rruga e mëtejme e Ministrisë së Mjedisit apo cilat do të jenë politikat e Qeverisë së Kosovës sa i përket këtij dikasteri ministror?

Standard për integrim në BE është evaluimi i vazhdueshëm i gjendjes mjedisore. Është mirë që përfundimisht kemi një raport, mirëpo ky raport nuk duhet të jetë bazë që ne të konkludojmë se cila është gjendja aktuale. Nëse i referohemi këtij raporti, sa i përket mjedisit, gjendja në Kosovë qenka fenomenale. Pse po e them këtë kështu? Krahasimet që janë bërë, dikush mund të thotë që edhe në raport ka pasur një vlerësim negativ, por tash do t'i demantoj dhe do ta them argumentin e kundërt.

Gjatë kësaj periudhe, njerëzit të cilët merren me këtë sektor apo me këtë lëmi kanë pasur rastin të njihen me raportet të cilat i ndërtojnë shtetet e Bashkimit Evropian. Standarde,

apo krahasime për gjendjen aktuale të mjedisit nuk janë ato vlera, të cilat sot janë publikuar në këtë raport, apo përqendrimi maksimal i lejuar i ndotjes së mjedisit në rajonin e Mitrovicës, të Obiliqit apo diku tjetër. Nëse tejkalohen këto standarde që parashihen me këtë raport që e keni sot ju përpara, atëherë pacientët duhet të jenë në Qendrën Klinike Universitare, ndërsa popullata e asaj treve, atij mjedisi ku i referohet nuk ka mundësi të bëjë jetë normale. Standardet e Bashkimit Evropian janë ekstrem më të ulëta krahasuar me këto që referohen sot, në rastin konkret. Raporti u referohet sasive të pluhurit që gjendet në mjedisin, siç është Obiliqi apo diku tjetër. Pra, merreni me mend, i referohet standardit 150 mikrogramë për 1 metër kub, ndërsa, në shumë raste, ky standard apo kjo vlerë është tejkaluar, sipas vlerësimit që e jep ministri apo Qeveria. Standardi i Bashkimit Evropian nuk është 150 as 300 mikrogramë, por është 50 mikrogramë. Ky standard ka qenë në vitet e 50-ta dhe 60-ta, që iu kanë referuar vendet e ish, thashë ish-Republikës së Jugosllavisë së dikurshme. Prandaj, duhet ta keni në konsideratë se ky raport nuk paraqet gjendjen reale të mjedisit dhe mund të jetë një shembull shumë i keq se kapacitetet njerëzore të Ministrisë përkatëse janë aq të ulëta, sa që ky raport mund të shërbejë vetëm në kuadër të një literature shkollore për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme.

Pak më herët, me profesorin Mark Krasniqi pata një komunikim dhe thashë se shumë pjesë të këtij raporti janë kopjuar prej librit- “Gjeografia Ekonomike”, autor i të cilit është profesori Mark.

Është për keqardhje, po them që ne kemi raporte të tilla. Dhe, ky raport, pas miratimit nga ky Kuvend dhe nëse merr miratimin, do të publikohet. Ky është realiteti që kemi sot parasys.

Çka të them, si do të jetë ky raport, duhet të vlerësohet nga menaxhmenti në kuadër të fushës së mjedisit, të cilës i referohet Ministria përkatëse. Po ashtu duhet t’i referohet instituteve, laboratorëve apo agjencive të caktuara, por nuk kemi pasur rastin që Ministria e Mjedisit të ketë një angazhim të tillë. Nëse thotë, ministri në fjalën e vet, “ky është një kontribut”, është fakt, është kontribut, por kontribut me takatin e kësaj ministrie sa ka dhe unë nuk pres më shumë.

Nëse dëshiron Qeveria përkatëse, unë e kam raportin që është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, i kam kriteret dhe mund t’ia ofrojë, që i kanë kriteret bazë për anëtarësim, mirëpo me këtë gjendje dhe me këtë performancë çfarë po demonstrojmë ne sot me të vërtetë është një porosi e keqe.

Unë, në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë – Grupit Parlamentar, them se e kundërshtojmë fuqishëm dhe i ftojme deputetët, ata të cilët kanë pasur rastin të njoftohen me këtë raport, të mos e pranojnë një gjë të tillë për arsye se është një fatkeqësi, s’po them fjalë më të rënda, mirëpo është edhe ofendim për Kuvendin e Kosovës t’i ofrohen raporte të tilla. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Selvije Halimi.

SELVIE HALIMI: Faleminderit Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, jo për të replikuar, por vetëm për t’ia përkujtuar kolegut dhe kryetarit të Komisionit se Ligji për mbrojtjen e mjedisit është miratuar në Kuvend në vitin 2003 dhe

që atëherë ky ligj ka obliguar që të sillet raport për gjendjen e mjedisit, por edhe një varg dokumentesh tjera ku në ish-qeveritë e kaluara deri para një viti vetë kryetari i Komisionit për Mjedis ishte pjesë e Qeverisë dhe ka mund të kritikojë në formën çfarë po kritikon sot. Sido që të jetë, nuk e pata për replikë, por vetëm për t'ia përkujtuar.

Sido që të jetë, mbrojtja e mjedisit, krahas zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, është sfidë e madhe e shekullit 21, andaj arritja e një bilanci në mes të mbrojtjes së mjedisit, në njërin anë, dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në anën tjetër, do të ndihmonte një zhvillim të qëndrueshëm të njerëzimit.

Me këtë rast, Grupi Parlamentar i PDK-së e inkurajon dhe përshëndet Qeverinë për sjelljen e Raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë. Është fakt se raporti nuk përmban standarde dhe vlera të cilat ekzistojnë për tejkalimet në dëmtimet e mjedisit. Mirëpo, raporti përmban ose përshkruan të gjithë faktorët të cilët në mënyrë direkte apo indirekte, në masë të madhe apo të vogël, ndikojnë në mjedis, duke i cilësuar si faktorë të dëmshëm.

Faktorët janë të përshkruar në të gjithë sektorët duke krahasuar në mes viteve dhe të dhënat janë të paraqitura në të gjitha format e mundshme që të mund të kuptohet nga të gjithë ata të cilët mund ta marrin në shqyrtim raportin.

Ndikimet e faktorëve janë të paraqitura në tri komponentët e mjedisit, në tokë, ujë dhe ajër, si dhe ndikimi i vetë mjedisit në shëndetin publik të popullatës. Nga raporti në fjalë, në paraqitjen e të dhënave, vërejmë një bashkëpunim ndërqeveritar dhe joqeveritar, që tregon një angazhim të avancuar për mbrojtjen e mjedisit. Ky angazhim vërehet në grumbullimin e të dhënave, pavarësisht se të dhënat a mund të krahasohen me të dhënat që mund të gjenden në libra shkollorë, të gjithë autorët e teksteve të dhënat i kanë marrë diku – në institucione të specializuara të cilat janë në Kosovë, më herët apo edhe tash.

Nga analiza e raportit, mund të vërejmë : mungesën e ndarjes së përgjegjësisë në mbrojtje të mjedisit ndërmjet nivelit lokal qeverisës dhe atij qendror. Pra, mund të vërejmë mosangazhimin e duhur për t'i njohur dhe për t'i zbatuar parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit konform nenit 5 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit; mungesën e pikënisjes bazë për aktivitetet e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit dhe gjendjen se deri kur është arritur; pamjaftueshmërinë e bashkëpunimit ndër sektorial qeveritar dhe joqeveritar për mbrojtjen e mjedisit gjatë realizimit të aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu, vërejmë edhe zbatueshmërinë e ulët të ligjeve në mbrojtjen e mjedisit dhe mungesën e investimeve në mbrojtjen e mjedisit, ngase ende nuk është formuar Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit.

Ajo që është inkurajuese në këtë raport, është fakti i paraqitjes së rekomandimeve për të ardhmen për angazhimin e të gjithëve në mbrojtjen e mjedisit, rekomandime këto që kanë të bëjnë me aspektin: socio-ekonomik, energjetikën, industrinë, bujqësinë, pylltarinë, transportin, kemikatet, ujërat dhe ajrin, biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura, mbeturinat e tjera. Mirëpo, realizimi i këtyre rekomandimeve bëhet vetëm atëherë kur do ta kemi në dorë një dokument zyrtar për mbrojtjen e mjedisit. Deri më tash, në Ministrinë e Mjedisit qarkullon një dokument ” Strategjia e mbrojtjes së mjedisit”, mirëpo, ju përkujtojmë, zoti ministër se edhe pse tash vonë e keni mandatin dhe ende nuk është bërë një vit, duhet t'i merrni të gjitha masat dhe ta sillni për miratim në Kuvend strategjinë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Vetëm atëherë ky dokument do të mund t'i obligonte të gjithë sektorët qeveritarë dhe ata joqeveritarë që në

zbatimin e ligjeve dhe gjatë ndërmarrjeve së aktiviteteve për realizimin e programit të tyre t'i kenë parasysh prioritet për mbrojtjen e mjedisit.

Ju falënderojmë shumë për raportin që keni sjell dhe shpresojmë se në afat shumë më të shkurtër sesa raportin që e keni sjell prej kohës **kur ju** keni mandat ta sillni edhe strategjinë për miratim në Kuvend. Ju përsërisht!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Falënderoj ministrin për Raportin për periudhën 2006-2007, i cili pasqyrohet dhe shihet nga fusnotat që është i ndërtuar mbi bazë të statistikave dhe të dhënave nga institucionet e Kosovës, ndërsa lider i përpilimit të këtij raporti është Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit. Me të dhënat tjera që referohen këtu nuk dua të merrem më shumë.

Në parim, ne e mbështesim këtë raport. Sigurisht se ka vend të krahasohen shifrat dhe gjendja të konstatohet ajo që është. Kosova është një ambient dhe një vend me shkallë të lartë të ndotjes dhe sigurisht ana e mirë e këtij raporti ka të bëjë me fillimin e zbatimit të ligjit. Pra, nëse kthehemi prapa të shqyrtimi i raportit të progresit për vitin 2008 nga Komisioni Evropian, shihet se kaptina e mjedisit shënon një progres, shënon një arritje dhe në kuadër të këtyre kapaciteteve unë dëshiroj ta konstatoj si gjendje të tillë.

Duke dashur që anëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së ta japin kontributin e vet për këtë çështje, unë dëshiroj edhe një herë vetëm të kërkoj sqarim, ndoshta, për pjesën e fundit.

Kryetari i Komisionit për Bujqësi paraqiti një sërë vërejtjesh në emër të këtij raporti. Është njëri nga kolegët tanë të çmuar, sepse e ka specializim çështjen- pra në mënyrë profesionale merret me këtë çështje, që duhet respektuar. Realisht, parametrat që i paraqiti ai janë të qëndrueshëm, por në emër të Komisionit për Bujqësi ai ka rekomanduar që kjo seancë ta shqyrtojë raportin.

Nëse këto të dhëna kanë qenë të sakta, Komisioni funksional është dashur ta kërkojë plotësimin, është dashur t'i rekomandojë Qeverisë që të ndërmarrë masa para se të vijë raporti në Parlament. Pra, me vetë faktin se ka rekomanduar sjelljen e raportit këtu dhe se e ka lejuar dhe ka kërkuar që Kryesia e Kuvendit ta procedojë në seancë, është një lloj kundërshtie që vjen me ushtrimin e detyrave tona këtu. Andaj, në këtë raport, pa dashur të kërkoj asgjë tjetër, përveç asaj se a e ka shqyrtuar Komisioni funksional, këtë raport para se të vijë në seancë plenare e ne tash formalisht po e kalojmë këtë raport vetëm sa për ta miratuar. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të AKR-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet zotërinj ministra,

Të nderuar deputetë,

Kjo audiencë – ky Kuvend kohëve të fundit është familjarizuar mjaft me probleme të ambientit dhe unë kujtoj se një raport që e kemi sot nuk është as minimum i asaj që është diskutuar kohëve të fundit në këtë Kuvend për shqetësimet që i ka opinioni për çështjen e ambientit në Kosovë, madje – ato shqetësime gati fare nuk zënë vend në këtë raport.

Unë do të shkoj si joprofesionist që jam, por jam munduar të evidentoj diçka nga raporti dhe ka rezultuar se raporti në fillim thotë se përfshinë periudhën për gjendjen e mjedisit 2006-2007 e këtu, një pjesë e madhe e raportit bazohet në të dhëna statistikore dhe në të dhëna tjera të vitit 2003. Pastaj pasqyron disa parametra – hipotetikë të rritjes së popullsisë në periudhën e ardhshme deri në vitin 2051, pa ndonjë analizë e ne e dimë që nuk mund të themi se do të kemi në vitin 2051 4 milion e gjysmë banorë nëse nuk kemi analiza serioze të bazuara nga institucione kompetente për këtë. Pra, ne e dimë që s’kemi fare regjistrim të popullsisë në Kosovë nga viti 1981 dhe ky është indikator që e bën të dyshimtë krejt çka flasim për trendët e rritjes së popullsisë në vend. Pastaj, është çështja që mungojnë statistikatat prapë të analizuara për çështjen që ka të bëjë me sipërfaqen e tokës. Këtu fare nuk evidentohet zvogëlimi i sipërfaqes së punueshme që ndodh çdo ditë në vendin tonë ose s’janë prezantuar ata parametra të këtij zvogëlimi. Përgjithësisht, në pjesën ku raporti flet për gjendjen në fusha të caktuara që lidhen me mjedisin, është shumë i shkurtër, është shumë sipërfaqësor dhe s’na jep ndonjë pasqyrë reale të gjendjes dhe për indikatorët konkret që janë mjaft shqetësues mendoj dhe që i kemi evidentuar, thashë, edhe më herët. Edhe të dhënat statistikore që i jep raporti nuk i interpreton në funksion të paraqitjes së gjendjes, do të thotë janë vetëm të dhëna për të cilat nuk komentohen në funksion të raportit, i cili është titulluar së paku si i tillë e që përshkruan gjendjen e mjedisit në Kosovë.

Raportit i mungojnë konkluzionet . Ka disa rekomandime që janë shumë të shkurta dhe shumë sipërfaqësore dhe fare të pa analizuara se si të mbërrihen ato. Do të theksoja edhe ndotësit më të mëdhenj që përmenden, për shembull industria që, natyrisht, është si e tillë dhe unë i kam evidentuar për shembull disa ndotës që aktualisht kanë ngritur shqetësime të qytetarëve në ato zona. Për shembull Feronikeli shkakton një ndotje të ambientit, përkundër asaj që thuhet se përdoren standarde dhe filtra të standardeve të fundit, por megjithëkëtë banorët kanë ngritur disa herë shqetësime për ndotje që i bën ambientit Feronikeli dhe këtu nuk figuron Feronikeli si ndotës. Përmenden disa resurse tjera industriale, por jo Feronikeli. Pastaj, kur flet për turizmin dhe për zonat e mbrojtura nuk shpreh fare shqetësim për shkatërrimin e atyre zonave, që bëhet çdo ditë, e që ne në këtë Kuvend, e thashë në fillim, kemi debatuar gjatë për shkatërrimin që u bëhet atyre zonave.

Dhe, përfundimisht, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, propozoj që ky raport të mos votohet si i tillë, të rikthehet dhe të hartohet një raport më i detajizuar ose të mos kemi fare të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, nga AAK-ja fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ky raport për mjedisin për periudhën 2006-2007 nuk i referohet krejt kësaj periudhe, por është një raport shumë i përgjithësuar, me përshkrime më shumë statistikore se sa me një analizë, e cila do të ishte shumë e qartë për Parlamentin e Kosovës në mënyrë që të mund të miratohej.

Prandaj, cilësia e raportit është shumë e dobët, sepse janë marrë të dhënat të cilat fare nuk kanë pasur nevojë të jenë brenda këtij raporti, por është dashur të bëhet një analizë krahasuese me standardet e BE-së dhe të jetë një raport i cili përmban vërtet ato çfarë janë shqetësime të qytetarëve të Kosovës sa i përket mjedisit.

Po ashtu, cilësia është shumë e dobët dhe nuk arrihet qëllimi që ky raport të jetë bazë e mirë për zhvillimin e politikave të përshtatshme mjedisore dhe sidomos me një rëndësi që do të duhej t'i jepej zhvillimit ekonomik, energjetik, bujqësisë, transportit e të tjera.

Për të mos i përsëritur kolegët e mëparshëm, konsideroj se raporti është më shumë përshkrues, por nuk është një raport studiuës, i cili do t'i shërbente Parlamentit të Kosovës për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Në emër të Grupit "7+", deputetja Shinik.

MÜFERA ŞINIK: Sayın Başkan, Sayın Bakanlar ve Değerli Milletvekilleri 2006-2007 yılları döneminde Çevre ve Yaşam ortamının Raporu, Çevre ile Alan Planlama Bakanlığı tarafından iyi bir şekilde hazırlanmış. Fırsattan yararlanarak Çevre ve Alan Planlama Bakanı Sayın Mahir Yağcılara teşekkürlerimi sunmak istiyorum. Ancak buraya ek olarak hava kirliliğinin günden güne arttığını vurgulamak gerek. Bunun ortadan kalkması amacıyla acil bir şekilde gerekli tedbirlerin alınmasının gerekli olduğunu düşünüyorum.

Aynı zamanda Prizren'deki Akdere nehrine kanalizasyonların döküldüğünü de gözönünde bulundurarak, acilen tedbirlerin alınmasını da eklemek gerek. Sonunda şunu belirtmek isterdim ki, Çevre ve Yaşam ortamı Raporunun diğer yasalarla tamamlanması gereklidir, niceki Etkinliklerin değerlendirilmesine ait Çevre Yasası gibi. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, nuk është paraqitur askush. Tani, sipas radhës, vazhdojmë me diskutimet. Mund të paraqiteni për replikë. Urdhëroni, Lulzim!

LULZIM ZENELI: Faleminderit! Nuk kam replikë, por vetëm një informatë të shkurtër se çka në esencë duhet të përmbajë ky raport.

Ky raport nuk përmban kualitetin apo cilësinë e ujit të pijes, që është elementar për Kuvendin e Kosovës, për publikun e Kosovës. Problemet sa i përket cilësisë të ujit të pijes janë aq të mëdha në vendin tonë dhe dallojnë prej komunës në komunë. Ky raport duhet të japë përgjigje se cila është cilësia e ujit për pije në liqenin e Radoniqit, Batllavës, Ujmanit e kështu me radhë. Standardet e BE-së e kërkojnë që ky raport ta ketë informatën e vet, nën një.

Dhe tjetra, nuk dua të polemizoj prapë, mirëpo, ky raport nuk përfshinë pjesën menaxheriale, që duhet t'i referohet, cilat janë objektivat, sa ka arritur t'i realizojë Qeveria e Kosovës për periudhën e kaluar dhe t'i bëjë krahasimet me standardet e vitit?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, përkatësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka sjellë në Kuvend raportin për gjendjen e mjedisit për periudhën dyvjeçare 2006-2007. Duhet thënë se raporti është i hartuar mirë, është i thjeshtë dhe i qartë dhe

përshkruan gjendjen, por nuk pasqyron veprimet që ka ndërmarrë Ministria, gjegjësisht Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit.

Meqenëse 97-98% e burimeve energjetike, gjegjësisht të rrymës elektrike burojnë nga termocentralet, kemi edhe pasojat më të mëdha mjedisore nga ky sektor ekonomik, kurse në raport shumë pak vend ose fare nuk i jepet mbrojtjes së mjedisit nga pasojat e funksionimit të termocentraleve në Kastriot.

Unë do të përqendrohem më shumë në gjendjen katastrofike të mjedisit në Kastriot dhe rreth tij, do të flas për ndotjet enorme të ajrit, të ujit e të tokës të shkaktuara nga Korporata Energjetike e Kosovës, që e bën pothuajse të padurueshme jetën e popullatës së këtushme. Lëshimi i gazrave nga tymtarët e termocentraleve me përqendrim të madh të acidit sulfurik, pastaj të tymit, të pluhurit me sendimente të metaleve të rënda, të blozës e tjerë, shkakton ndotje përtej çdo standardi dhe shkakton pasoja e probleme shëndetësore dhe jetësore të popullsisë, e cila jeton në skëterrën e dinozaurit të quajtur KEK.

Lëshimi i ujërave të përdorura dhe të ndotura teknologjike dhe mostrajtimi i tyre teknologjik, shkarkimet e ujërave të zeza të patrajuara, kontaminimi i ujërave me fenol nga rrjedhat e deponive të hirit, gjendja jo e mirë e rezervuarve dhe e baseneve të ujërave me fenol në zonën e gazifikimit, shkarkimi i karburanteve e vajrave të përdorur, shpëlarja e tokës së ndotur me fenol nga të reshurat atmosferike në zonën e termocentraleve shkakton ndotjen e lumit Sitnicë, lum i cili tashmë është shndërruar në lum të vdekur, si një kolektor i ujërave të zeza dhe i ujërave të përdorura dhe të ndotura teknologjikisht. Degradimi i tokës dhe i peizazhit, gjithashtu, paraqet një gjendje tepër shqetësuese. Tashmë dihet për mbulimin e rreth 400 hektarëve tokë nga deponitë e hirit që akumulojnë 40 milionë tonelata hi. Deponia e Termocentralit A me afër 250 hektarë është e ndërtuar dhe funksionon jashtë standardeve dhe në mënyrë joprofesionale teknike. Ngritja e pluhurit nga deponitë e hirit kur fryjnë erërat paraqet një problem tjetër specifik. Në disa pjesë ka filluar rrëshqitja apo shembja e masës së hirit që rrezikon qytetarët që jetojnë rreth 50 metra larg tij.

Zgjidhje urgjente duhet të bëhet sidomos për disa familje që janë atakuar drejtpërdrejt nga shembja e dheut. Dihet për gropat e hapura në qindra hektarë tokë për eksploatimin e thëngjillit, nëpërmjet mihjeve sipërfaqësore. Si pasojë e eksploatimit pa kritere të thëngjillit, kemi ndotje urbane të vendbanimeve me mbeturina të ngurta, me materie të rrezikshme si fenoli, mbetjet e elementeve radioaktive, kryesisht të lëshuara nëpërmjet pluhurit dhe hirit, por edhe tokë të ndotur me mbetje teknologjike të gazifikimit si: fenol, katran, vajra e tjera.

Për shkak të punës së pandërprerë termocentralet shkaktojnë zhurmë enorme, e cila pengon popullsinë, sidomos, gjatë natës. Në gjendje më të rëndë mjedisore ndodhet fshati Dardhishtë i rrethuar nga njëra anë nga deponia e hirit e nga ana tjetër nga Termocentrali A dhe nga ana e tretë nga hapja e minierës së re të thëngjillit në Sitnicë. Edhe banorët që kanë mbetur në fshatin Hade tashmë gjenden në pozitë të vështirë, me shqetësime të shumta dhe me jetë të parehatshme dhe të pa perspektivë.

Deviza se ai që ndot edhe paguan, e rregulluar edhe me ligj, nuk vlen për KEK-un, i cili ndot mjedisin jo vetëm në Kastriot e rrethinë, por edhe më larg. KEK-u nuk ndanë asnjë qindarkë për mbrojtjen e mjedisit që e ndot vetë. As Ministria e Mjedisit dhe as ajo e Energjetikës, deri tash nuk kanë bërë ndonjë përpjekje serioze në këtë drejtim. Sigurisht se për këtë gjendje më së paku faj kanë ministrinë aktuale, por këto ministri duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për ta sanuar gjendjen. Se degradimi i natyrës në Kosovë dhe jo

vetëm në Kastriot ka arritur përmasa shqetësuese, tregon edhe prerja pa kritere e pyjeve, ndotja enorme e lumenjve, ndotja e ajrit, ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore dhe të tokave pyjore e tjerë.

Komisioni për Mjedis dje ka vizituar Pejën dhe Grykën e Rugovës. Me këtë rast ka konstatuar prerje masive të druve me përmasa alarmuese në Malet e Rugovës. Meqenëse Gryka e Rugovës është zonë e mbrojtur e natyrës, i kisha lutur ministrin e Mjedisit, ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që ta vizitojnë sa më shpejtë Grykën e Rugovës dhe të shohin gjendjen katastrofike të prerjes së drurëve në këtë zonë me leje dhe pa leje, me letra dhe pa letra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Ndoshta nuk do të ma merrni si agjitacion dhe propagandë nëse citoj nenin 52 të Kushtetutës së Republikës që ka të bëjë me mjedisin, që thotë: “Natyra dhe biodiversiteti i mjedisit jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi për secilin” dhe besoj se nuk është agjitacion dhe propagandë këtu. Unë dua të ndalem në këtë raport vetëm në atë se nuk është përfshirë këtu gjendja e mjerueshme e pyjeve dhe mjediseve pyjore dhe hapësirave pyjore të Republikës së Kosovës.

Nuk dua t’i përsëris ato që u thanë më herët, sepse veç u thanë disa gjëra që desha unë t’i them, por dhashë Zoti që në raportin e ardhshëm të përfshihen të gjitha ato që kanë ndodhur më herët dhe që po ndodhin tani në këtë vit në hapësirat e guroreve të Republikës së Kosovës. Gjatë këtij viti dihet, besoj që e din edhe ministri i Mjedisit se sa gurore të reja janë hapur dhe çfarë dëmi do t’i sjellin natyrës.

Gjithashtu, në raport nuk është përfshirë as gjendja e lumenjve të Republikës së Kosovës, ashtu siç duhej të përfshihej, sepse ju e dini se për zhavorrin, rërën që nxirret nga lumenjtë e Republikës së Kosovës nuk paguhet asnjë cent në buxhetin e Republikës së Kosovës, kështu që dëmtohet shumë hapësira, dëmtohen brigjet e lumenjve të Republikës së Kosovës dhe ambienti në përgjithësi. Prandaj, besoj se në raportet e ardhshme që kemi të bëjmë me mjedisin dhe planifikimin hapësinor do të zë vend kjo dukuri negative dhe do të luftohet nga Ministria dhe nga Kuvendi i Kosovës, sepse këtë fushë e rregullon edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Në këtë raport nuk është përfshirë edhe pse në vitet 2006 dhe 2007 diku atje në Prevallë kanë filluar të ndërtojnë disa persona nga ky Kuvend në hapësira të mbrojtura me ligj, pra nuk është përfshirë fare se çka ka ndodhur dhe çka po ndodh me hapësirat e mbrojtura me ligj të Republikës së Kosovës, pse po ndërtohet dhe kush po ndërton. Unë mendoj se edhe kjo është dashur të përfshihet në raport, sepse ky raport është bërë për vitet 2006 dhe 2007. Kjo ishte ajo që desha të them. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me lejen tuaj, unë do të filloja nga faqja e parë e këtij raporti, ku thuhet se në duart tuaja keni një dokument që ju informon për gjendjen reale për mjedisin e Kosovës. Qëllimi i tij është jo vetëm informimi për gjendjen e mjedisit, por nëpërmjet tij të paraqiten edhe angazhimi i institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare për zbatimin e politikave adekuate mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

E kam lexuar këtë raport, nuk dua ta luaj rolin e avokatit të djallit, por sa i përket raportit për aq sa kam unë njohuri se si shkruhen raportet, vetëm që ky pasus i takon një raporti, por nuk është vazhduar. Ka aq shumë informata që lexuesin e arsyeshëm ordinar e hutojnë. Duhet të jesh goxha ekspert edhe atëherë ke problem për ta marrë një informatë për të cilën raporti shkruhet.

Këtu është shkruar në atë stilin që i kritikua edhe agjencitë e tjera që nuk po dinë të shkruajnë raporte. Kanë bërë raport 142 faqesh, për t'i mbushur këto faqe, kanë shkruar jo t'i kopjojnë librat e autorëve tjerë, por i kanë përshtatur. Dhe, pastaj, del krejt ai mos akordimi i krejt kësaj pune voluminoze që drejt në fije s'mund t' i bie.

Duhet të humbësh aq shumë kohë për ta marrë një informatë që i intereson, po them, gjithmonë lexuesit ordinar, të arsyeshëm, domethënë për atë që shkruhet raporti, kurse raporti nuk shkruhet për ekspertë, por shkruhet për njerëz që u interesojnë këto gjëra.

Për të mos shkruar në secilën faqe, urdhëroni veç shikoni çka shkruhet te Parku Nacional Malet e Sharrit. Është shpallur park nacional në vitin 1986 dhe ti tash pret një raport për gjendjen atje çka është, çka do të ndërmerret për ta përmirësuar atë gjendje dhe has në këso fjali. Thuhet: “Është shpallur park nacional në vitin 1986, me sipërfaqe 39 mijë hektarë dhe shtrihet në kufijtë e katër komunave -Prizren 19.500 hektarë”. Pra, ashiqare shihet se është kopjuar nga ndonjë libër dhe janë paraqitur pa nevojë – informata të paarsyeshme.

Sot, ne patëm një pyetje parlamentare këtu për aktivitetet ilegale që bëhen në Sharr, këtu nuk i paraqet fare, për prerjen e druve. Nuk po e përmendi Prevallën.

Pastaj, ngjashëm jep shpjegime për Bjeshkët e Nemuna.

Tash shkojmë te faqja tjetër – mbeturinat. Dhe, ti pret një raport për gjendjen e mbeturinave. Ja se si fillon: “ Mbeturinat janë lëndë komplekse dhe heterogjene të cilat krijohen gjatë aktiviteteve të përditshme të njeriut në: punë, banesë, sipërfaqe publike, shkolla, industri, dyqane. Kjo është marrë prej ndonjë libri të leximit apo ndonjë libri Dituri Natyre të klasës së parë apo të dytë.

Po vazhdoj, mos të shkoj faqe për faqe, sepse nuk kam kohë dhe nuk dua t'ju maltretoj, aq më shumë ata që e kanë lexuar, e kanë parë nivelin e të shkruarit.

Pastaj vazhdojmë, për shembull, me Raportin për mbeturinat e letrës dhe ja çfarë shkruan këtu:”Grumbullimi i letrës së vjetër dhe riciklimi i saj është i rëndësishëm për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave, ruajtjen e resurseve natyrore, kursimin e energjisë dhe zvogëlimin e tjera”, që nuk të ngelë tjetër pos për të thënë ” Eureka”

Po shkojmë te plastika. Plastika, thotë, nuk mund të zbërthehet në mënyrë të natyrshme, ajo është biologjikisht e pazbërthyeshme. Dhe, ti tash, mendon, thua – cili gjeni e ka shkruar këtë kaq mirë që po na edukon neve? A kanë përgjegjësi shkruarit se këto raporte i lexojnë edhe ndërkombëtarët, pra, marrja e dheut.

Unë, singërisht, po them edhe një herë me mirësinë më të madhe, pa dashur ta kundërshtoj, e ktheni prapa, mos e shpërndani, të mos qeshin njerëzit me ne, sepse unë jam i bindur që di të shkruaj më mirë. Shumë më mirë di të shkruaj se ky raport dhe të kemi konsideratë herëve të tjera, qofshin komisionet, qofshin Kryesia, aman të mos na

sillni në këtë gjendje të diskutojmë për këto gjëra të nivelit kaq të ulët. Duhet ta respektojmë pak Parlamentin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryesia nuk është lektor i letrave të askujt. Ne vetëm procedojmë kërkesa...

(Ndërhyrje – reagim)

Në rregull, por mos u merr fort me atë punë, sepse je duke i dhënë vetes të drejtë të flasësh për shumë gjëra që nuk ke të drejtë. I tillë ke qenë edhe mbrëmë, po them dhe nuk të takon. Pra, është pjesë e përgjegjësisë edhe imja, edhe jotja dhe e të gjithë neve për shumë çështje që ndodhin këtu në Parlament, jo që në emision televiziv të flasësh përralla.

(Reagim)

Fjalën e ka deputetja Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Duke bërë një analizë shumë të thellë të këtij materiali apo të këtij raporti të Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit 2006-2007, në aspekt të përgjithshëm i gjithë ky raport nuk është i saktë duke ditur parametrat nga aspektet sociale-ekonomike ku thuhet se me numër të popullsisë sa është rritja e popullsisë kur ne ende nuk kemi një regjistrim të popullsisë. Në Kosovë parametrat janë të marrë si parametra. Çështja e dytë është te parametrat në pasqyrën sektoriale siç janë: energjetika, industria, transporti, ujërat dhe ujërat e zeza dhe nuk di ku ka marrë një përqindje kur thotë këtu diku deri në 18% me keqardhje them shumë sinqerisht zoti ministër, nuk e di, ndoshta vetëm ta kanë dhënë materialin me veti dhe s'di si kanë mund ta përgatisin kësi lloji.

Kisha kërkuar që këtij raport t'i bëhet një analizë e thellë, të mendohet mirë nga ekspertë dhe të vihet edhe një herë në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

I nderuari zoti ministër dhe kolegë deputetë,

Përkundër angazhimit që është bërë, që i është kushtuar mjedisit për këtë dokument që është shumë i nevojshëm tani, duke ditur që Kosova është para një sfide të madhe para integritetit evropian dhe duhet t'i plotësojmë disa standarde....

(Ndërhyrje – reagim. Deputeti Tali: Për replikë kam të drejtë. Më ofendove, the përralla...)

NJOMZA EMINI: Megjithatë, unë a do të vazhdoj apo? Mirë. Këtu u tha prej parafolësve që ky dokument nuk është... dhe ka mangësi të veta, por ajo se çka është me rëndësi është që ka vend edhe për këtë raport që të jepen edhe disa rekomandime apo edhe të plotësohen. Këtu pash në raport, në fund, se janë disa rekomandime, por nuk janë konkrete, janë më shumë përmbajtjesore dhe nuk specifikohen ashtu në mënyrë të duhur. Tani s'kemi nevojë ne edhe shumë të flasim apo ta lexojmë këtë raport, sepse në jetën e përditshme ne e shohim mjedisin dhe faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt te ne. Sidomos ajo që është më e ndjeshme, është tek mjedisi, tek shëndeti, ku tani në kohën e fundit janë

paraqitur shumë raste në Qendrën Mjekësore prej sëmundjeve ngjitëse që janë dhe **që ajo** ndikon drejtpërdrejt. Për të mos u ndalë më shumë, shkruhet edhe këtu në raport që, përkundër angazhimit maksimal, ky raport ka edhe mangësi të veta, që në radhë të parë janë pasojë e mungesës së të dhënave. Këtu ceket edhe shumë mirë që nuk është bërë aq sa duhet në këtë raport. Atëherë, kjo ishte. Faleminderit!

(Ndërhyrje – reagim: Për replikë!)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti Kryesues!

Qeveritarë dhe deputetë të respektuar,

Nuk jam ithtar i vështrimit të çështjeve në përgjithësi bardhë-zi, sepse fundi i fundit nuk ka edhe bardhë-zi krejt, por megjithatë synimi im është për t'i dhënë disa vlerësime analitike – kritike, me qëllim që të bëhet ky dokument më i mirë dhe më i përshtatshëm dhe në funksion të përmirësimit të gjendjes.

Vërejtje parimore në këtë dokument do të kisha dhe do të kisha konkluduar se parametrat janë jo aktual dhe si të tillë rezultojnë në pamje joadekuat. Konkluzionet janë hipotetike që nuk japin të dhëna të besueshme as pasqyrë çfarë do të duhej të kishin në bazë të këtij raporti. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për pyjet tona, për sipërfaqet të cilat janë devastuar, janë degraduar krejtësisht, për sipërfaqet të cilat do të mund të përtëriheshin nëpërmjet pyllëzimeve, për tokat e bukës që i kemi me grat e që sa hektarë në vit uzurpohen arbitrarisht, për burimet alternative të energjisë që kemi aq tepër nevojë dhe me mundësi të substitucionit të thëngjillit që prodhon aq shumë dioksid karboni, për ujin, për shkallën e ndotjes së ujit dhe për ata parametra që janë vi e kuqe e përdorimit të ujit të dëmshëm, për ajrin – polucionin, shkallën e polucionit, që natyrisht është një ndër burimet apo resurset ekzistenciale, për zhurmën. Ne e kemi edhe ligjin në aplikim që nuk përputhet me realitetin, sepse nuk aplikohet. Dhe, përfundimisht, çdo raport do të duhej t'i kishte këto komponentë që nuk i ka. Një, incizimi i gjendjes që do të duhej të ishte i thuktë dhe konkret. Identifikimi, kualifikimi dhe definimi i problemeve, konkluzionet që nuk i ka dhe raport pa konkluzione nuk mund të ketë dhe propozimi i masave që, fundi i fundit, qëllimi i këtij raporti është propozimi i masave reale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Ne sot po debatojmë për Raportin për gjendjen e mjedisit për periudhën 2006-2007. Raporti, sipas mendimit tim është i shkurtër dhe nuk jep një pasqyrë të qartë për gjendjen e mjedisit në Kosovë. Shumë shënime të dhëna në këtë raport u referohen shënimeve që janë marr, siç thuhet në raport, nga Libri i gjelbër i Kosovës për vitin 2003. Unë me këtë rast kisha dashur t'i shtroj disa pyetje konkrete lidhur me këtë raport. Për shembull nën një, sa sipërfaqe të tokës së punueshme iu ka ndërruar destinimi, do të thotë, nga toka e punueshme në tokë ndërtimore për periudhën 2006-2007, do të thotë periudhën për të cilën ne sot po e debatojmë? Sa sipërfaqe e pyjeve me masë drunore është prerë dhe sa sipërfaqe e pyjeve është djegur për këtë periudhë dyvjeçare? Pastaj në raport është dhënë një shënim se është dhënë numri i automjeteve që është regjistruar në vitin 2006, ndërsa nuk dhënë numri i automjeteve të gjitha kategorive të cilat janë regjistruar në vitin 2007. Prandaj, raporti për gjendjen e mjedisit duhet të jetë më gjithëpërfshirës dhe të ketë mundësi të krahasohen të dhënat me raportet për periudhat e caktuara apo periudhat e mëhershme kohore. Prandaj, me keqardhje mund të konstatojmë se gjendja e mjedisit sot

në Kosovë për këtë periudhë për të cilën ne po debatojmë, është përkeqësuar, do të thotë nuk është përmirësuar, por është përkeqësuar.

Dhe, në fund, kisha pasur dëshirë që raporti për periudhën e ardhshme dyvjeçare të jetë me të dhëna të cilat do të dëshmonin se gjendja e mjedisit në Kosovë është përmirësuar. Ju faleminderit, zoti Kryesues.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet raporti i Ministrisë, gjegjësisht i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit na sjell një konglomerat të dhënash dhe një varg rekomandimesh. Unë do të përpiqem që të tërheq vëmendjen tek kategorizimi i prioritetëve dhe objektivave se ku do të duhej të fokusohet Ministria, gjegjësisht Agjencioni, por edhe të gjithë të tjerët të cilët duhet t'i kontribuojnë përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe të ambientit tonë.

Për mendimin tim, ka shumë sfida në këtë lëmi, por ne do të duhej të përqendrohemi në ato prioritare të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me shëndetin e qytetarit tonë. E para, domethënë, ka bazë të mjaftueshme ligjore për të ndikuar tek kapacitetet teknologjike të cilat lirojnë masa ndotëse në ambient, në mënyrë që të pamundësohet ose të zvogëlohet lirimi i atyre masave dhe nëpërmjet formave të sanksionimit, qoftë në Feronikel, në termocentrale apo edhe në kapacitete tjera, qofshin ato edhe private.

E dyta, diçka që nuk u përmend këtu, është qasja në rrjetin e kanalizimit. Vetëm 30% e qytetarëve të Kosovës kanë qasje në rrjetin e kanalizimit. Dikush e merr si çështje të zgjidhur problemin e kanalizimeve vetëm në rast se lidhet në një gyp, por problemi është se mungojnë impiantet për trajtimin e ujërave të zeza dhe të gjitha ato ujëra lirohen apo derdhen në lumenj të cilët po ndikojnë në vdekjen e lumenjve tanë.

Dhe, e treta, ajo çka do të mund të bëjmë, është që të nxitet, të stimulohet dhe të subvencionohet bujku për punimin e tokave bujqësore, sepse në momentin kur të punohen arat tona – tokat bujqësore, ajo do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ambientit.

Domethënë, unë nuk dua t'i përsëris ato diskutimet apo fjalët e diskutuesve paraprak për të thënë se vërtet është një kriter shumë i rëndësishëm i afrimit tonë me komunitetin evropian, përmirësimi i gjendjes në ambientin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se duhet të sqarohet në fillim se raporti është një obligim ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, i cili është themeluar para disa kohe dhe është supozuar se ky raport, të cilin do ta marrim sivjet, do ta vendosë një bazë, sepse është raport i gjendjes, jo analizë, tregon në çfarë gjendje është mjedisi sot dhe do të shfrytëzohet si bazë për raportet e mëtejshme, në mënyrë që ta shohim progresin prej vitit në vit se çka ka ndodhur me mjedisin në Kosovë prej viti në vit. Kjo ka qenë ideja, mendoj se është tentuar që të përcillet me kujdes. Mirëpo, duke pasur parasysh këtë çështje, tani shtrohet pyetja për çka po flasim ne sot këtu, cila është tema?

Shikoni, jemi duke folur për raportin e gjendjes mjedisore për vitet 2006 dhe vitin 2007. Sa për t'ju përkujtuar, ky është fundi i vitit 2008. Do të thotë, nëse ne debatojmë gjatë, siç po shihet se po debatojmë këtu për këtë raport, atëherë dikush duhet pyetur, a ka ndodhur diçka gjatë vitit 2008 në aspektin mjedisor në Kosovë? A ka ndryshuar gjendja prej datës 31 dhjetor 2007 deri më sot apo nuk ka ndryshuar gjendja hiq dhe tash të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës po flasin për raportin, i cili ka qenë dashur të diskutohet para më pak se një viti. Çka po flasim ne tani? Për çka jemi duke folur?

Tjetra që duhet të thuhet – Kuvendi nuk është konferencë shkencore, ku bisedojmë në për parametra e për çështje tjera. Kuvendi është organ politik i zgjedhur dhe ne duhet të flasim se a kemi mundësi të ndikojmë në politika apo jo, a ka ndodhur diçka mirë apo ka ndodhur diçka keq, e jo të shndërrohet Kuvendi në konferencë shkencore, duke i përmendur parametrat? Mendoj se është humbje kohe për Kuvendin, nuk kemi nevojë kështu. Pra, nuk është mirë për një Kuvend.

Thashë edhe një herë, ka qenë dashur të ketë diçka këtu a ka ndodhur diçka në vitin 2008 apo nuk ka ndodhur asgjë? Ose, nëse flasim për vitet 2006 dhe 2007, atëherë nuk guxojmë të flasim për gjendjen, për shkak se gjendja na gënjen, duhet të flasim për vendimet të cilat janë marrë në vitet 2006 dhe 2007 dhe të cilat kanë efekt edhe sot e kësaj dite në jetën e qytetarëve të Kosovës ose që pritet se do të kenë. Këto vendime janë dhe u përmend shumë qartë pak më parë këtu – trajtimi i ujërave të zeza. Janë marrë disa vendime, nuk ka ndodhur, nuk po debatojmë për to ne, por po debatojmë për konferenca shkencore. Ka ndodhur Kosova C, nuk po bisedojmë për Kosovën C ne. Prapë po bisedojmë për çështje krejt tjera, që nuk kanë të bëjnë me punën e Kuvendit dhe në fund të fundit u përmendën për shembull gurthyesit, e përmendi kolegu Geci. Nëse dikush do të flas për këtë raport, le të flet se çka ka ndodhur deri tash, jo çka ka ndodhur deri para një viti, për shkak se raporti nuk korrespondon absolutisht me gjendjen të cilën sot e kemi në terren. Gurthyesit, bazat e asfaltit, janë të gjitha çështjet që duhet të ndodhin, të mos keqkuptohem, mirëpo, a është e përfshirë në raport? Jo. Atëherë, çka po flasim ne? Cila është tema me të cilën sot Kuvendi i Kosovës po merret, me çfarë teme po merret? Cilat janë çështjet për të cilat ne sot mund të vendosim, a e miratojmë raportin apo nuk e aprovojmë raportin, çfarë rëndësie ka në fund të fundit? Dhe, në fund, çështja e fundit që dua të them – raporti duhet të jetë një rrëfyes për atë që po ndodhë në mënyrë që Kuvendi të ketë të drejtën të marrë vendime në të ardhmen. Çka na ndihmon neve ky raport për të marrë vendime në të ardhmen? Asnjë gjë, hiq. Nëse në mendjet tona themi se nëse një rrugë fillon të ndërtohet dhe ne kuptojmë që për t'u përfunduar ajo rrugë nja dy vjet duhet të heqim keq, duhet të kalojmë nëpër baltë, duhet të anashkalojmë dhe është shumë e qartë dhe ndodh gjithkund në botë, nuk është asgjë e re, atëherë ka projekte tjera për të cilat flitet në kuptimin kinse ato projekte duhet të ndodhin me shkopin magjik, kinse nuk duhet të pritet edhe për projekte tjera derisa të përfundojnë në mënyrë që t'i shohim përparësitë të cilat na i japin ato projekte. Unë këto po i shoh sot këtu dhe mendova se do të kontribuoj pak nëse flas. Ju faleminderit shumë! Ky raport, është për vitet 2006 dhe 2007 dhe ky Kuvend po i humb disa orë duke debatuar për një raport, i cili nuk e përshkruan gjendjen të cilën e kemi sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Për fjalë është paraqitur deputetja Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!
Së pari dua të them se vlerësimet e mia për raportin e paraqitur nga ana e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit, do t'i bëj si një qytetare e rëndomtë dhe jo si eksperte e kësaj fushe.

Agjencioni i Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit për herë të parë na ofron një raport të këtillë dhe mendoj se ka të dhëna të shumta statistikore. Mirëpo, sa i përket analizës dhe vlerësimit të gjendjes së mjedisit, për ta bërë këtë Ministrisë i duhen edhe kapacitete të shumta njerëzore, do të thotë profesionalisht të ngritura, por edhe mjete të shumta financiare, që do të thotë se ne vetë jemi të vetëdijshëm se që të dyja na mungojnë.

Jemi një vend i dalë nga lufta dhe e dimë se sa është shkatërruar mjedisi në çdo pikëpamje. Mirëpo, për ta sjell mjedisin në gjendjen e duhur vërtet duhet kohë dhe mjete financiare. Prandaj, secili prej nesh mundet shumë lehtë të vërejë se gjendjen në mjedis nuk e kemi të mirë, qoftë nga pikëpamja e përbërjes, do të thotë të përbërjes së ajrit, qoftë nga kualiteti i ujit ose të humbjes së sipërfaqeve tokësore bujqësore.

Meqenëse në të ardhmen shpresojmë të kemi një zhvillim më të madh ekonomik, i cili do të shoqërohet edhe me shfrytëzimin e resurseve natyrore, që gjithsesi do të rrisë edhe ndikimin në mjedis, andaj, duhet që sa më parë t'i qasemi zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mjedisin. Për këtë na obligojnë edhe marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ne i kemi nënshkruar deri më tani.

Unë do të përmendja njërin prej marrëveshjeve ndërkombëtare që ka të bëjë me prodhimin e energjisë. Kosova është nënshkruese e Traktatit të komunitetit të energjisë dhe ky traktat obligon Kosovën që deri në vitin 2015 t'i plotësojë 10 deri në 12% të nevojave të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Ndërsa, si forma të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme konsiderohen: energjia e ujit, do të thotë nga hidrocentralet; energjia e diellit; energjia e erës dhe energjia e biomasës, burime të cilat te ne, tani për tani shfrytëzohen në mënyrë simbolike gjë që konstatohet edhe në raport. Prandaj, viti 2015 do të vijë shumë shpejt. Ne duhet me kohë të punojmë për plotësimin e kriterëve të parapara nga ligjet dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare, pasi që me respektimin e tyre do të kontribuojmë edhe në mjedisin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqyrtimi i këtij raporti sot, ka të bëjë në të vërtetë me gjendjen ndoshta më të rëndë që e karakterizon shtetin tonë të ri – Republikën e Kosovës. Dhe, për fat të keq, këtu duhet të themi se të gjithë nga pak, në një mënyrë ose në tjetër, i kemi kontribuar kësaj gjendje nëse jo për forma të ndryshme thjeshtë vetë duke mos u përpjekur për t'i zbatuar, qoftë hedhjen e mbeturinave si duhet qoftë vendosjen për shembull të tyre në plastika, kursimin e ujit e të ngjashme. Mirëpo, unë nuk do të ndalesha në detaje, do t'i them vetëm disa gjëra se raporti si raport në të vërtetë i ka të gjitha karakteristikat e një raporti, ndërkaq mund të diskutohet sikurse që u diskutua këtu nga shumë parafolës lidhur me përmbajtjen.

Në anën tjetër, për atë që unë dua të përqendrohem në fjalën time, nuk ka të bëjë shumë me përmbajtjen e vet raportit, pasi që vërtet sidomos fjala e zotit Luzha, por edhe e disa të tjerëve theksuan ose vënë në pah disa mangësi dhe disa shqetësime që besoj do të jenë të dobishme për ministrin dhe Ministrinë e ambientit që të kenë parasysh me qëllim që të bëjnë aq sa kanë mundësi në atë drejtim.

Unë në fakt do të përqendrohem në lidhje me rekomandimet dhe kushdo që i ka lexuar rekomandimet, që janë diku gati 8 faqet e fundit, në të vërtetë do ta kishte pasur të qartë se pak kemi çka të diskutojmë dhe të themi. Thuaja se gjithçka është paraparë se çka duhet të bëhet në këto rekomandime. Ajo çka mua më shqetëson nuk është mungesa e ideve, mungesa e orientimeve, sepse këto rekomandime i thonë qartë. Shqetësimi im ka të bëjë me atë se implementimi i të gjitha këtyre rekomandimeve është shumë i kushtueshëm. Natyrisht i kushtueshëm po, por ka të bëjë me jetën tonë, prandaj edhe i vlefshëm. Ndoshta këtu do të ishte mirë që të dalë si një rekomandim nga Kuvendi që Qeveria në buxhetin ose në projektbuxhetin për vitin 2009 të shtojë ose të parashoh mundësi për të shtuar mjetet për këtë Ministri, me qëllim që të mund të merren masa dhe ato të realizohen dhe të evitohen në praktikë.

Unë udhëtoj çdo ditë pune Ferizaj-Prishtinë - Prishtinë-Ferizaj, sepse vazhdoj të jetoj e të banoj në Ferizaj dhe vetëm sasia e gazrave të veturave se si lëshohet, vetëm pjesa e gurthyesve dhe tymrat që i lëshojnë, mjaftojnë për të parë pa folur për pamjen që shihet nga termocentralet për të cilat kemi nevojë, sepse na furnizojnë me rrymë. Çka mund të bëjë Ministria në këtë drejtim? Mund që të marrë vendime që jo të ndalohen gurthyesit dhe format tjera të kompanive të ndryshme, por të obligohen ato që të kenë pajisje adekuate të cilat zvogëlojnë në minimumin e lejueshëm të ndotjes së ambientit. Dhe, duke i plotësuar këto kushte, do të mbrohej ambienti dhe do të mbrohej edhe gjithçka tjetër.

Ndërkaq, është shqetësuese për të gjithë ata, nëse e kanë lexuar me vëmendje, dy faqet e fundit, ku parashtrihen mungesat me të cilat ballafaqohet kjo Ministri. Dhe këto mungesa nuk janë të këtij viti. Janë mungesa që janë trashëguar dhe mungesa të ndjeshme, mungesa që nuk dot ë mundemi t'i eliminojmë lehtë as në këtë vit e as në vitin e ardhshëm sepse, le të themi vetëm për atë se mungesa, për shembull, e planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura... pastaj mungesa që parashtrihen në monitorimin e mjedisit janë mungesa që mund të evitohen, por që përsëri duhet të planifikohen dhe kërkohen të shtojnë njerëzit në vende të punës, do të thotë për punësime të reja, pajisja e tyre dhe gjithçka që kushton dhe sidomos, nëse e shihni pjesën e fundit, ku me nëntitullin për probleme të tjera shohim se ka, për shembull, mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Si të bëhet kjo zgjidhje, si të dilet nga kjo kur kjo do të na kushtojë dhe po na kushton edhe sot në shëndet dhe ndotje të ambientit. Unë e kuptoj se Kosova ka prioritete shumë të tjera të zhvillimit ekonomik, ka prioritete të sigurisë së vendit, ka prioritete të konsolidimit të shtetit, por apeloj që të kihet parasysh dhe të mos harrohet edhe mjedisi, sepse ne edhe si deputetë edhe si qytetarë jetojmë në këtë mjedis. Të bëhet angazhimi ynë në radhë të parë për t'i eliminuar këto mungesa me të cilat ballafaqohet Ministria pastaj do të kemi të drejtën morale që të kërkojmë Ministria të bëjë më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

U inkuadrova edhe unë në këtë diskutim duke qenë një ambientalist i padeklaruar, por që në fakt problemet e ambientit më shqetësojnë jashtëzakonisht shumë.

Konsideroj se një nga sfidat që paraqiten para Qeverisë aktuale dhe qeverive të cilat do të vijnë, krahas asaj të zbutjes së varfërisë, papunësisë, zhvillimit ekonomik, energjisë, pa dyshim çështja e ndotjes së ambientit do të duhej të ishte një prej këtyre sfidave kryesore të qytetarëve të Kosovës.

I nderuari zoti ministër,

Unë ju falënderoj që ju keni gjetur kohë dhe na keni sjell këtë raport dhe besoj se të gjithë e dimë këtu që ju jeni më së paku fajtor për këtë gjendje që është në mjedisin tonë.

Ma së paku fajtor jeni ju dhe padyshim edhe Qeveria, e cila, aktualisht qeveris me vendin pa pretenduar që t'ia hedh fajin ish qeverisë që ka qenë se edhe ajo e ka trashëguar një mjedis dhe një mentalitet ambientalist në Kosovë, që edhe ajo nuk ka pasur ndoshta mundësi të bëjë ndryshime radikale në mbrojtjen e ambientit në Kosovë.

Unë dëshiroj të orientoj diskutimin tim krejt ndryshe, jo duke kërkuar fajtorë në mesin e konkurrentëve politik por duke kërkuar fajtorë të mendësia jonë se ma kanë thënë kolegët e mi sllovenë qysh në vitin 80 a 81-82 kur vinin në Kosovë – si mund të jeni Gani aq të pastër brenda pragut të shtëpisë, na keni befasuar me një pastërti perfekt brenda pragut të shtëpisë, kurse nuk keni kurrfarë vetëdije për ambientet e përbashkëta për atë çka nuk është brenda pragut të shtëpisë tuaj. Ne duhet të pranojmë si qytetarë të gjithë se këto shprehje për atë çka është e përbashkët në Kosovë është e askujt dhe askush nuk e ka një qëndrim të drejtë, me pak përjashtime. Ne të gjithë mund të shohim si ndotet ambienti aty ku jetojmë, mund t'i shohim mbeturinat gjithandej nëpër Kosovë. Në këtë drejtim unë besoj se raporti duhet pranuar ashtu si është, duhet votuar dhe duhet përkrahur Ministrinë dhe ministrin që t'i ketë duart e lira, që në kuadrin e Ministrisë dhe Agjencionit për Mbrojtjen e Ambientit të marrin hapa radikal, të shikohet a ka ekspertizë, para se gjithash në këto dikastere, a ka njerëz të cilët dinë të krijojnë një strategji se si duhet luftuar këto fenomene dhe këto dukuri?

E dyta, që desha të theksoj. Ne jemi duke tentuar që ta rrisim numrin e vendeve të punës. Kemi kriter shumë të ulët të tolerancës ndaj subjekteve ekonomike që prodhojnë në Kosovë. Nuk vendosim kurrfarë kriteri. Ta marrim për shembull Feronikelin. Feronikeli është shndërruar në një problem të jashtëzakonshëm për qytetarët të cilët banojnë në komunën e Drenasit dhe të matet sasia e ndotjes. Prandaj, duhet të ndërmerren hapa të shpejtë për të mbrojtur qytetarët që mos të shpërngulen prej vendbanimeve të tyre, për shkak se nuk mund të jetojnë aty. Dhe, në këtë kontekst, për masat që duhet marrë për mbrojtjen e ambientit, duhet të inkuadrohet edhe ekonomia, duhet të inkuadrohet edhe legjislativin. Unë kisha inkurajuar ministrin që të bëjë një ekspertizë të bazës ligjore dhe në kuadër të kësaj ekspertize t'i inkuadrojë të gjitha ministrinë të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ambientin. Ne duhet të kemi përgjegjësi jo vetëm ndaj jetës sonë, ndaj shëndetit tonë dhe fëmijëve tanë, por edhe ndaj jetës dhe shëndetit të brezave që do të vijnë pas nesh. Ne duhet të kemi një orientim të qartë si Qeveri, si deputetë, si përfaqësues të popullit se çfarë ambienti do t'u lëmë në trashëgim brezave që do të vijnë pas nesh. Ne nuk do të orientohejmë në veprimet tona konkrete, qofshin ato ligjore, qofshin administrative, vetëm se kërkon Bashkimi Evropian një standard dhe duhet ta plotësojmë ne. Ne duhet të vetëdijesohemi se të gjitha këto duhet t'i bëjmë për shkak të interesave të qytetarëve të Kosovës dhe për shkak të interesit tonë. Dhe në këtë drejtim, unë mendoj se ka shumë për të bërë dhe unë do ta votoj këtë raport dhe do të kisha inkurajuar Ministrinë dhe ministrin që të na paraqet një pako të masave të cilat duhet t'i ndërmarrim ne që të ndërhyjmë në infrastrukturën ligjore në Kosovë dhe t'i japim mundësi ligjore Qeverisë që të zbatojë ligjet dhe të veprojë që të parandalohen këta trendë shumë shqetësuese të degradimit të ambientit në të cilin jetojmë.

KRYESUESI: Faleminderit, Gani! Deputetja Hulaj e ka fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E mora fjalën meqenëse është një segment i veçantë dhe dëshiroj të kontribuoj në këtë drejtim- mjedisi dhe shëndeti është një segment shumë i rëndësishëm, që kërkon edhe përkrahje të zhvillimit të strategjive të saj për një mjedis më të mirë dhe më të shëndoshë me qëllim që qytetarët të kenë një shëndet më të avancuar. Këtu përpara kemi një tabelë të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse në Kosovë. Është një tabelë, mund të them me të dhëna relative, meqenëse paraqitja e sëmundjeve ngjitëse bazohet në bazë të standardeve dhe kriterëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë sipas formularit 1 dhe 2 dhe këto të dhëna konsideroj se janë të dhëna relative të paraqitura, meqenëse janë të paraqitura, konsideroj, vetëm nga institucionet publike shëndetësore nga se mungojnë të dhënat e paraqitjes së institucioneve private dhe për këtë ekziston edhe legjislatura, është Ligji për praksën private dhe në këtë segment dua të ceku edhe disa ligje tjera të cilat nuk janë cekur komplet këto ligje edhe pse ekziston Ligji i përgjithshëm për shëndetësi, mirëpo ekzistojnë edhe ligjet specifike për shëndetësi siç është Ligji për shëndet publik, Ligji për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, Ligji i praksës private, Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarit në kujdesje shëndetësore dhe Ligji, kisha me thënë, Ligji kundër duhanit, që ndikon shumë në mjedis dhe ndikon në mënyrë direkte dhe indirekte në shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Këtu shkruhet se është vërejtur një rënie e ndjeshme e numrit të rasteve të sëmundjeve ngjitëse. Nuk është rënie e rasteve të sëmundjeve ngjitëse, por nuk janë paraqitur në tërësi rastet e sëmundjeve ngjitëse. Sikurse ne të kishim një sistem informativ shëndetësor të përkryer ne do të kishim mbledhur të gjitha të dhënat edhe nga praksa private edhe nga organizatat publike shëndetësore dhe do të kishim një gjendje reale të paraqitjes së rasteve të sëmundjeve ngjitëse. Do të thotë kërkohet punë dhe angazhim në këtë drejtim dhe të përkrahet sepse ekziston strategjia 2005-2015 për shëndetësi dhe ekzistojnë ligjet por mund të them se në baza reale është një raport bazik që na jep të kuptojmë që institucionet duhet ta përkrahin dhe të zhvillojnë politikat strategjike, do të thotë t'i përkrahin strategjitë dhe në mënyrë më të avancuar me qëllim që të kemi një gjendje më të korrigjuar dhe të dhëna më reale për një analizë më të thuktë për mjedisin dhe shumë e rëndësishme është për mjedisin sepse ndikon në mënyrë direkte dhe indirekte në shëndet, janë 3 indikatorë të rëndësishëm, është shtëpiaku, është mesi socio-ekonomik dhe është agjenci. Do të thotë një çrregullim në mes të këtyre 3 indikatorëve paraqitet edhe sëmundja. Ne në njëfarë forme e kemi këtë çrregullim, besoj se në të ardhmen me zhvillimin më të avancuar dhe përkrahjen e strategjive për shëndetësi dhe zbatueshmërinë e ligjeve në Kosovë do të kemi një gjendje më të mirë shëndetësore në të ardhmen në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Hetemi, e fundit.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, falënderoj Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor por megjithatë a është njëfarë raport apo identifikim nëse në bazë të analizës që kemi për faktorët që ndikojnë në ndotjen e mjedisit, por nuk mund ta quajmë raport i gjendjes mjedisore e arsyeshme sipas mendimit tim, duke pasur parasysh edhe mandatin që e ka marrë Ministria dhe kohën kur ka vendosur për ta bërë një raport të gjendjes mjedisore.

U përmend këtu se nuk është paraqitur gjendja e vitit 2008, por pavarësisht që jemi laik ose nuk jemi profesional, nuk është konferencë shkencore kjo, mund të themi se raporti nuk mund të bëhet në vitin 2008 për 2008-ën, sepse e bën një analizë dhe një përkushtim vërtet studioz në vlerësimin e gjendjes mjedisore.

Ajo çka mendoj unë, për të ardhmen që duhet të paraqitet, duke i përkrahur edhe disa kolegë të mi deputet që e potencuan, është krahasimi i gjendjes mjedisore të tanishmes dhe krahasimi me normat apo standardet e lejuara evropiane duke pasur parasysh faktin

se ne nuk kemi obligim vetëm ndaj qytetarëve të Kosovës, por kemi obligime edhe ndërkombëtare për gjendjen mjedisore, sepse shpeshherë ndikojnë edhe në vendet që na rrethojnë apo shtetet që i kemi përreth. Në raport duhet të paraqiten edhe masat që i ka ndërmarrë Ministria përkatësisht Qeveria për të ndikuar në përmirësimin e gjendjes mjedisore. Pra, mund të themi që Ministria, në bazë të atyre analizave dhe në bazë të atij raporti mund të hartojë plane dhe programe që do ta kërkonte edhe mbështetjen e Kuvendit, mbështetjen financiare nga Qeveria për ta përmirësuar gjendjen mjedisore në Kosovë. Gjithashtu duhet të paraqitet edhe një zotim i Qeverisë për afatet ose kohën – periudhat se në cilët sektorë, kur dhe sa mund të ndikojë në përmirësimin e gjendjes mjedisore te aktorët që shkaktojnë ndotjen e mjedisit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetët është mirë të kthehen në sallë. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë falënderoj të gjithë deputetët për kontributin, sepse vërtet duhet një angazhim maksimal i të gjithëve për përmirësimin e gjendjes.

Ky është një raport përshkrues për vitet 2005-2006, i cili është një obligim ligjor. Është herë e parë dhe ne besojmë se raportin tjetër do të jetë më i mirë dhe nuk do të ketë nevoja për përshkrime tjera. Por, për hir të çështjes se është herë e parë, është menduar ashtu të bëhet. Mirëpo, ekzistojnë probleme edhe njerëzore, ekzistojnë probleme edhe infrastrukturore. AMM-ja ose Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit vepron që dy vjet ndoshta me 20 persona. Janë ekspertë, por, ndoshta, ka jashtë ka edhe ekspertë edhe më të mirë, por ne jemi duke munduar me këto kapacitete të bëjmë diçka. Gjithashtu, nga aspekti i infrastrukturë teknike, ka shumë mangësi, sepse nuk ekziston sistemi i monitorimit të ajrit ende. Nuk ekzistojnë sistemet monitoruese tjera, kështu që ne dëshiroam të bëjmë një raport si për fillim dhe ta përmbushim një obligim ligjor. Ekziston mungesa e sistemit të monitorimit. Është folur edhe për ujin e pijshëm dhe kualitetin e tij, por këtu ekzistojnë edhe kompetenca tjera. Për shembull Instituti i Shëndetit Publik është përgjegjës për kualitetin e ujit. Ne mund ta monitorojmë, mund të raportojmë, por është Instituti i Shëndetit Publik, mirëpo në Kosovë ekziston mungesa e sistemit informativ mjedisor, sepse kjo çështje nuk është vetëm e Ministrisë së Mjedisit. Kemi folur për pyjet. Agjencioni i Pyjeve është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, si shembull, kështu që ekzistojnë shumë çështje tjera dhe ku duhet të kryejmë një sistem informativ mjedisor.

Po ashtu, të martën do të kemi buxhetin. Do të parashihen që në Buxhetin e Kosovës Ministria e Mjedisit do t'i ketë 12,5 milion, por për mbrojtjen e mjedisit dot ë jenë vetëm 3,5 milion. Unë po e marr shembull, është folur për Prizrenin, e po ashtu edhe këtyre ditëve por sidomos për ditët e verës, ka qenë kanalizimi në Lumbardh, por për realizimin e projektit nevojiten mbi 50 milion euro. Prandaj, këto janë projekte shumë madhore dhe të shtrenjta dhe unë kërkoj prej juve një përkrahje. Ky është një raport kur unë nuk kam qenë, ndoshta, edhe si ministër, por, ndoshta, raporti tjetër do të jetë atëherë kur do të jetë një ministër tjetër, por për mjedisin është e nevojshme një përkrahje. Në qoftë se mundem t'i ngremë këto çështje, në raport ekzistojnë problematikat kryesore mjedisore që identifikohen, por me realizimin projekteve dhe me përkrahjen nga ju, të nderuar deputetë, besojmë se mund të përmirësohet. Por, aspekti tjetër për gjendjen e mjedisit të tanishëm ose çështjeve tjera, ne jemi të gatshëm të bisedojmë prapë dhe të raportojmë. Ju faleminderit edhe një herë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani, meqenëse edhe kjo pikë po përfundohet, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për ta votuar raportin me vërejtjet që u dhanë gjatë debatit.

(Ndërhyrje)

Nuk di. Unë me Rregullore jam duke punuar, jo me ligj. Atëherë, ju ftoj të votojmë për raportin, së bashku me vërejtjet që u dhanë dhe mund të votojnë “kundër” ose “për”.

Votojmë tash:

Atëherë, konstatoj se raporti miratohet me 42 vota “për”, 16 vota “kundër” dhe 4 “abstenime”. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, që është e fundit dhe është vetëm njoftim.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se Grupi Parlamentar i PDK-së ka vendosur që anëtar i Komisionit për Arsim, në vend të deputetes Vlora Çitaku, emërohet deputeti Gani Buçinca.

Anëtar i Komisionit për Shërbime Publike, në vend të deputetit Gani Buçinca, emërohet deputeti Hajredin Hyseni.

Dhe deputeti Emrush Xhemajli, emërohet nënkryetar i Komisionit për Shërbime Publike, në vend të deputetit Fehmi Mujota.

Faleminderit, të nderuar deputetë!
Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.
Mirë u pafshim!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve